

# INTEGRITETI GJYQËSOR

---

## Guidë monitorimi për shoqërinë civile

Kjo Guidë ka për qëllim dhënien e kontributit të shoqërisë civile në forcimin e kapaciteteve të vetë gjyqësorit nga një anë lidhur me integritetin dhe atë të shoqërisë civile si ushtruese e një roli parësor në demokraci, atë të kontrollit nga institucionet.

Maj 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by  
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361387

## SHKURTIME

<b>GjK</b>	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KL Gj</b>	Këshilli i Lartë Gjyqësor
<b>NjABGj</b>	Njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor, pranë KL Gj-së
<b>ILD</b>	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
<b>ShM</b>	Shkolla e Magjistraturës
<b>ENCJ/RREKGj</b>	Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë
<b>GJIN/RRBIGj</b>	Rrjeti Botëror i Integritetit Gjyqësor (Global Judicial Integrity Network)
<b>CCJE</b>	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë
<b>UNCAC</b>	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
<b>UNODC</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin e Organizuar
<b>GRECO</b>	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit i Këshilli të Evropës
<b>KPC</b>	Kodi i Procedurës Civile
<b>KPP</b>	Kodi i Procedurës Penale



## Pasqyra e lëndës

SHKURTIME.....	3
PËRMBLEDHJE.....	11
HYRJE.....	13
1.1. Konteksti i Guidës: projekti “Gjyqësori në fokus”, propozuar dhe zbatuar nga ISPL dhe financuar nga BE në kuadër të Programit për Shoqërinë Civile dhe Mediet .....	13
1.2. Qëllimi (monitorimi i respektimit të standardeve të integritetit në veprimtarinë gjyqësore) dhe destinacioni (grupet e shënjestruara-organizatat e shoqërisë civile, studentët e drejtësisë dhe gazetarët) i Guidës .....	15
1.3. Përkufizimi i integritetit gjyqësor.....	16
1.4. Struktura e guidës (kapitujt, seksionet).....	16
Pjesa 1	
STANDARDET NDËRKOMBËTARE .....	19
Pjesa 2	
KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJIK NË FUQI NË R.SH.....	22
Pjesa 3	
PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA .....	23
Pse duhet vlerësuar/matur pavarësia dhe paanshmëria .....	23
Faktori 1.1 Pavarësia institucionale e gjyqësorit.....	23
1.1.1. Standardet e Performancës .....	23
1.1.2 Treguesit e Realizimit .....	24
1.1.3 Metoda e matjes .....	25
Faktori 1.2 Pavarësia personale dhe paaensia e gjyqtarëve .....	26
1.2.1 Standardet e Performancës .....	26
1.2.2 Treguesit e realizimit .....	27
1.2.3 Metoda e matjes .....	28
Faktori 1.3 “Imunizimi” socio - politik i gjyqësorit .....	28
1.3.1 Standardet e performancës .....	28
1.3.2 Treguesit e realizimit .....	29
1.3.3 Metoda e matjes .....	30
Faktori 1.4 Mbrojtja e gjyqtarëve .....	30
1.4.1 Standardet e Performancës .....	30
1.4.2 Treguesit e realizimit .....	31
1.4.3 Metoda e matjes .....	31

Faktori 1.5 Meritokracia në karrierën gjyqësore .....	31
1.5.1 Standardet e Performancës .....	31
1.5.2 Treguesit e realizimit .....	32
1.5.3 Metoda e Matjes .....	32

#### Pjesa 4

PËRGJEGJSHMËRIA DHE LLOGARIDHËNIA .....	33
Pse duhet vlerësuar/matur: .....	33
Faktori 2.1 Regjimi disiplinor .....	33
2.1.1 Standardet e performancës .....	33
2.1.2 Treguesit e realizimit .....	35
2.1.3 Metoda e matjes .....	36
Faktori 2.2 Parimet deontologjike që udhëheqin sjelljen gjyqësore të gjyqtarëve .....	36
2.2.1 Standardet e performancës .....	36
2.2.2 Treguesit e realizimit .....	37
2.2.3 Metoda e matjes .....	37
Faktori 2.3 Parashikueshmëria e vendimeve gjyqësore, siguria juridike dhe standardet e të gjykuarit. ....	37
2.3.1 Standardet e performancës .....	37
2.3.2 Treguesit e realizimit .....	38
2.3.3 Metodatat e matjes .....	39
Faktori 2.4 Përgjegjësia ligjore (penale dhe civile) e gjyqtarëve .....	39
2.4.1 Standardet e performancës .....	39
2.4.2 Treguesit e realizimit .....	40
2.4.3 Metoda e matjes .....	40
Faktori 2.5 Integriteti në vendimmarrje dhe ndershmëria e drejtimit të procedurave .....	40
2.5.1 Standardet e performancës .....	40
2.5.2 Treguesit e realizimit .....	41
2.5.3 Metoda e matjes .....	41

#### Pjesa 5

TRANSPARENCA DHE Pjesëmarrja Aktive .....	43
Pse duhet vlerësuar/matur: .....	43
Faktori 3.1 Aksesi në një drejtësi cilësore, komunikimi me përdoruesit e gjykatave dhe publikun .....	43
3.1.1 Standardet e performancës .....	43
3.1.2 Treguesit e realizimit .....	44
3.1.3 Metoda e matjes .....	45
Faktori 3.2 Aksesi i publikut dhe shtypit/medieve në procedurën gjyqësore dhe në sallat/ambientet gjyqësore .....	45
3.2.1 Standardet e performancës .....	45
3.2.2 Treguesit e realizimit .....	45
3.2.3 Metoda e matjes .....	46

Faktori 3.3 Aksesi në vendimet gjyqësore (arkivat, data-base) dhe informacione të tjera të lidhura me gjykatën .....	46
3.3.1 Standardet e performancës .....	46
3.3.2 Treguesit e realizimit .....	47
3.3.3 Metoda e matjes .....	47
Faktori 3.4 Arsytimi i vendimeve gjyqësore .....	47
3.4.1 Standardet e performancës .....	47
3.4.2 Treguesit e realizimit .....	48
3.4.3 Metoda e matjes .....	48
Faktori 3.5 Gjenerimi i informacioneve dhe zgjidhja efektive e problemeve të pjesëmarrjes, për palët, publikun dhe shtypin.....	49
3.5.1 Standardet e performancës .....	51
3.5.2 Treguesit e realizimit .....	52
3.5.3 Metoda e matjes .....	53

## Pjesa 6

EficientA NË DHËNIEN E DREJTËSISË .....	54
Pse duhet vlerësuar/matur.....	54
Faktori 4.1 Efektiviteti i ushtrimit të së drejtës për fillimin e procedurave gjyqësore dhe kohëzgjatja deri në vendimmarrje .....	54
4.1.1 Standardet e performancës .....	54
4.1.2 Treguesit e realizimit .....	55
4.1.3 Metoda e matjes .....	55
Faktori 4.2 Impakti i menaxhimit të çështjeve, si rrjedhojë e rolit të vetë gjyqtarit mbi kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore .....	56
4.2.1 Standardet e performancës .....	56
4.2.2 Treguesit e realizimit .....	57
4.2.3 Metoda e matjes .....	57
Faktori 4.3 Ngarkesa në punë e gjyqësorit .....	58
4.3.1 Standardet e performancës .....	58
4.3.2 Treguesit e realizimit .....	58
4.3.3 Metoda e matjes .....	59
Faktori 4.4 Njohuritë profesionale dhe mbështetja për gjyqësorin në juridiksionin e specializuar, dhe në çështjet me elemente ndërkombëtare .....	59
4.4.1 Standardet e performancës .....	59
4.4.2 Treguesit e realizimit .....	60
4.4.3 Metoda e matjes .....	60
Faktori 4.5 Kostot e procesit, shpenzimet proceduriale dhe mjaftueshmëria me personel e trupës gjyqësore, si dhe me personel mbështetës administrativ-jogjyqësor. ....	60
4.5.1 Standardet e performancës .....	60
4.5.2 Treguesit e realizimit .....	62
4.5.3 Metoda e matjes .....	62

## Pjesa 7

KOMPETENCA DHE PËRKUSHTIMI PROFESIONAL .....	63
Pse duhet vlerësuar/matur .....	63
Faktori 5.1 Përshatshmëria e arsimit juridik (kurrikulat) në fakultet dhe magjistraturë, me nevojat dhe stadin e zhvillimit të gjyqësorit.....	64
5.1.1 Standardet e performancës .....	64
5.1.2 Treguesit e realizimit .....	64
5.1.3 Metoda e matjes .....	64
Faktori 5.2 Procesi përzgjedhës dhe emërimi / promovimi .....	65
5.2.1 Standardet e performancës .....	65
5.2.2 Treguesit e realizimit .....	66
5.2.3 Metoda e matjes .....	66
Faktori 5.3 Sistemi/et i/e vlerësimit të gjyqtarëve të emëruar në detyrë .....	67
5.3.1 Standardet e performancës .....	67
5.3.2 Treguesit e realizimit .....	68
5.3.3 Metoda e matjes .....	69
Faktori 5.4 Trajnimi dhe formimi i vazhdueshëm .....	69
5.4.1 Standardet e performancës .....	69
5.4.2 Treguesit e realizimit .....	70
5.4.3 Metoda e matjes .....	70
Faktori 5.5 Ndershmëria e procedurave dhe metodave përzgjedhëse për përparimin në karrierë/promovimi .....	71
5.5.1 Standardet e performancës - të përbashkëta .....	71
5.5.2 Treguesit e realizimit .....	71
5.5.3 Metoda e matjes .....	72
Faktori 5.5/1: Transferimi, komandimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve .....	72
5.5/1.1 Standardet e performancës.....	72
5.5/1.2 Treguesit e realizimit.....	73
5.5/1.3 Metoda e matjes .....	73
Faktori 5.5/2 Transferimet .....	74
5.5/2.1 Standardet e performancës.....	74
5.5/2.2 Treguesit e realizimit .....	75
5.5/2.3 Metoda e matjes.....	75
Faktori 5.5/3 Përfshirja në skemën e delegimit dhe komandimi .....	75
5.5/3.1 Standardet e performancës.....	75
5.5/3.2 Treguesit e realizimit.....	76
5.5/3.3 Metoda e matjes.....	76
Faktori 5.5/4 Ngritja në detyrë .....	77
5.5/4.1 Standardet e performancës.....	77
5.5/4.2 Treguesit e realizimit.....	77
5.5/4.3 Metoda e matjes.....	78



## Pjesa 8

MENAXHIMI I BRENDSHËM I GJYKATAVE DHE PERSONELI JOGJYQËSOR.....	79
Pse duhet vlerësuar/matur: .....	79
Faktori 6.1 Burimet njerëzore në gjykata, mjaftueshmëria dhe cilësia e tyre.....	80
6.1.1 Standardet e performancës .....	80
6.1.2 Treguesit e realizimit .....	81
6.1.3 Metoda e matjes .....	82
Faktori 6.2 Roli i vetë gjyqtarëve në administrimin e gjykatës.....	82
6.2.1 Standardet e performancës .....	82
6.2.2 Treguesit e realizimit .....	83
6.2.3 Metoda e matjes .....	83
Faktori 6.3 Menaxhimi i të dhënave gjyqësore.....	83
6.3.1 Standardet e performancës .....	83
6.3.2 Treguesit e realizimit .....	84
6.3.3 Metoda e matjes .....	84
Faktori 6.3 Kultura menaxheriale e drejtimit administrativ të Gjykatës dhe standardet e performancës së personelit jogjyqësor .....	84
6.3.1 Standardet e performancës .....	84
6.3.2 Treguesit e realizimit .....	87
6.3.3 Metoda e matjes .....	88
Faktori 6.4 Efektiviteti i praktikave të punës së gjykatave, në raport me objektivat specifikë të përmendur në faktorin 6.3 .....	89
6.4.1 Standardet e performancës .....	89
6.4.2 Treguesit e realizimit .....	89
6.4.3 Metoda e matjes .....	90
Faktori 6.5 Arsimimi profesional, statusi, trajnimet dhe regjimi disiplinor për personelin jogjyqësor .....	90
6.5.1 Standardet e performancës .....	90
6.5.2 Treguesit e realizimit .....	91
6.5.3 Metoda e matjes .....	92

## Pjesa 9

BURIMET FINANCIARE/NJERËZORE TË GJYQËSORIT DHE MENAXHIMI I TYRE.....	93
Pse duhet vlerësuar/matur: .....	93
Faktori 7.1 Buxheti dhe procedurat e caktimit të tij.....	93
7.1.1 Standardet e performancës .....	93
7.1.2 Treguesit e realizimit .....	95
7.1.3 Metoda e matjes .....	96
Faktori 7.2 Burimet njerëzore, mjaftueshmëria dhe cilësia e tyre.....	97
7.2.1 Standardet e performancës .....	97
7.2.2 Treguesit e realizimit .....	98
7.2.3 Metoda e matjes .....	99

Faktori 7.3 Trajnimet, sasia, cilësia dhe efektiviteti i tyre .....	99
7.3.1 Standardet e performancës .....	99
7.3.2 Treguesit e realizimit .....	99
7.3.3 Metoda e matjes .....	100
Faktori 7.4 Aksesi në Literaturë, zhvillimet e doktrinës dhe praktikës gjyqësore, si dhe botimet profesionale .....	100
7.4.1 Standardet e performancës .....	100
7.4.2 Treguesit e realizimit .....	100
7.4.3 Metoda e matjes .....	100
Faktori 7.5 Disponueshmëria e ekspertizës teknike dhe roli ndërveprues i gjyqësorit me aktorë dhe faktorë të tjerë të jashtëm, me ndikim në performancën e tij .....	101
7.5.1 Standardet e performancës .....	101
7.5.2 Treguesit e realizimit .....	101
7.5.3 Metoda e matjes .....	102
 BIBLIOGRAFIA .....	 103

## PËRMBLEDHJE

Integriteti i Gjyqësorit është një koncept gjithëpërfshirës që i referohet aftësisë së sistemit gjyqësor ose të anëtarëve të veçantë të tij, për t'i bërë rezistencë korrupsionit, sipas përcaktimit të nenit 11 të Konventës së OKB-së kundër korrupsionit, duke ruajtur dhe respektuar vlerat kryesore të shprehura në parimet e Bangalores, si pavarësia, paanësia, barazia, sjellja e duhur, integriteti personal, kompetenca dhe përkushtimi/zelli profesional (Deklarata e Dohës).

Me qëllim dhënien e kontributit të shoqërisë civile në forcimin e kapaciteteve të vetë gjyqësorit nga një anë lidhur me integritetin dhe atë të shoqërisë civile si ushtruese e një roli parësor në demokraci, atë të kontrollit të institucioneve, hartohet kjo Guidë për monitorimin e integritetit gjyqësor në vendin tonë. Rëndësia që ka forcimi dhe konsolidimi i një gjyqësori të pavarur, të paanshëm dhe me integritet është shpalosur gjerësisht në vend në kuadër të politikave që janë përqafuar në nivel kushtetues dhe ligjor, dhe edhe në kuadër të procesit të integrimit evropian. Forcimi i shtetit të së drejtës është pjesë e standardeve themelore që duhen vendosur dhe ndjekur nga vendi në kuadër të këtij procesi. Guida është hartuar në mënyrë të tillë që t'i shërbejë procesit të monitorimit të zbatimit të kërkesave të integritetit gjyqësor në vend. Ajo është hartuar me qëllim që organizatat e shoqërisë civile, studentë të drejtësisë apo gazetarë të interesuar të mund ta përdorin me qëllim monitorimin e integritetit në veprimtarinë gjyqësore

Kjo Guidë është hartuar në kuadër të projektit “Judiciary under spotlight” i zbatuar nga konsorciumi prej tre partnerësh, IPLS, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe endra për Fuqizimin Ligjor (CLE) me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021” nën IPA III/2022/441-466. Projekti synon të fuqizojë shoqërinë civile të Shqipërisë dhe aktorët e tjerë për të zhvilluar monitorimin dhe vlerësimin e gjyqësorit dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Guida është hartuar me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për procesin e ushtrimit të veprimtarisë nga gjyqësori, si një prej tri pushteteve të pavarura, konsolidimi i të cilit është kusht i domosdoshëm për forcimin e shtetit të së drejtës.<sup>1</sup> Respektimi i demokracisë dhe i sundimit të shtetit të së drejtës ka në themel të vetin edhe theksimin e rolit të gjyqësorit dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij me integritet, në mënyrë të pavarur, efektive dhe të paanshme.<sup>2</sup>

Forcimi i demokracisë politike kërkon që mekanizmat e pjesëmarrjes dhe kontrollit të

1. L. Hilbnik, *Judges beyond Politics in Democracy and Dictatorship: Lessons from Chile* (2007).

2. C.M. Larkins, *Judicial Independence, and Democratization: A Theoretical and Conceptual Analysis*. 44 Am.

jashtëm të jenë po aq të pranishme sa edhe ato të kontrollit të brendshëm. Të tillë mekanizma shërbejnë si mjete parandalimi dhe vetëfrenimi nga shkeljet e ligjit dhe forcimi i integritetit institucional. Gjyqësori nuk është i përjashtuar nga një qasje e tillë.

Guida ka karakter praktik. Në të janë trajtuar të gjithë treguesit të cilët pasqyrojnë gjendjen e integritetit në veprimtarinë gjyqësore. Për këtë qëllim, është përdorur një metodë matje, e përshtatur për tipin e indikatorit dhe përfshin elementë, si p.sh. përqindja, shifra absolute, konstatimi me Po/Jo, etj. Mënyra e llogaritjes për secilën prej tyre është dhënë në Guidë. Për secilën prej treguesve është pasqyruar tërësia e të dhënave për të cilët mblidhet informacion, sikurse edhe mënyra e mbledhjes së të dhënave. Kjo e fundit përfshin, për shembull, konsultimin e regjistrave, statistikave zyrtare, ose edhe të tjera mënyra si vëzhgimi i proceseve gjyqësore, sondazhe me përdorues të gjykatave, sondazhe opinion me qytetarë. Për secilën prej të dhënave jepet edhe burimi i informacionit që mund të jetë regjistri i gjykatës, statistika të KLGj-së, etj.

Materiali i hartuar u konsultua me KLGj-në. Falënderojmë përfaqësuesit e këtij institucioni për mendimet dhe sugjerimet e dhëna për përmirësimin e këtij manuali trajnimi.

Urojmë që kjo Guidë të shërbejë si një nga instrumentet për forcimin e aktorëve dhe të procesve që synojnë fuqizimin e shtetit të së drejtës në vend.

## HYRJE

### **1.1. Konteksti i Guidës: projekti “Gjyqësori në fokus”, propozuar dhe zbatuar nga ISPL dhe financiar nga BE në kuadër të Programit për Shoqërinë Civile dhe Mediet**

Sistemi gjyqësor i bazuar në parimet e pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit janë kyçe për sundimin e ligjit, për ruajtjen e besimit të publikut dhe për sigurimin e dhënies efektive të drejtësisë. Integriteti i gjyqësorit është aspekt themelor për zhvillimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në një vend. Ai është koncept gjithëpërfshirës që i referohet **aftësisë së sistemit gjyqësor ose të anëtarëve të veçantë të tij, për t'i bërë rezistencë korrupsionit**, sipas përcaktimit të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit, **duke ruajtur dhe respektuar vlerat kryesore të shprehura në parimet e Bangalores, si pavarësia, paanësia, barazia, sjellja e duhur, integriteti personal, kompetenca dhe përkushtimi/zelli profesional.**

Integriteti është thelbësor për ushtrimin e duhur të detyrës nga gjyqësori.

Në gusht 2016 u miratua Paketa Kushtetuese dhe Ligjore, pjesë e Reformës në Drejtësi, një sërë strukturash të reja, dhe reformim i organeve ekzistuese, ashtu si dhe një ndryshim rrënjësor i legjisllacionit, me të cilin organizohet dhe funksionon sistemi i drejtësisë.

Fryma dhe qëllimi i kësaj reforme, është rritja e pavarësisë, efikasitetit dhe integritetit të sistemit gjyqësor dhe, për rrjedhojë, përmirësimi i cilësisë së dhënies së drejtësisë dhe forcimi i besimit të publikut te drejtësia. Gjykatat dhe gjyqtarët kanë rol kyç në luftën kundër korrupsionit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe në respektimin e të drejtave themelore të njeriut, prandaj është e domosdoshme që ky sistem të ruajë pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.

Shfaqja e sjelljeve korruptive në sistemin e drejtësisë dëmton sundimin e ligjit dhe shkakton humbjen e besimit të qytetarëve tek institucionet publike dhe aftësisë së tyre për të ofruar shërbime. Nga ana tjetër, niveli i lartë i korrupsionit gjyqësor në një vend pamundëson luftimin e kësaj dukurie negative në degët e tjera të sistemit qeverisës. Prandaj, monitorimi i integritetit gjyqësor, si në nivel institucional ashtu dhe personal, është i domosdoshëm, dhe duhet të realizohet në vazhdimësi. Ky monitorim synon kalimin nga një **sistem llogaridhënie/kontrolli**, drejt një **sistemi përmirësues, kultivues dhe funksional** të gjyqësorit, duke krijuar kulturën e ushtrimit të profesionit të gjyqtarit, *pro - integritet*.

Faktorët që shkaktojnë korrupsionin gjyqësor, por edhe më gjerë problematikat anti-integritetet, janë të shumëfishta. Shumica e tyre janë trajtuar në nivel rregullator nga reforma gjyqësore. Sidoqoftë, efektiviteti i masave të reformës në këtë aspekt të veçantë (*integriteti gjyqësor*) dhe qëndrueshmëria e tyre, duhet të monitorohen. Prandaj, është e nevojshme të zhvillohet dhe të prezantohet një plan masash për të monitoruar integritetin gjyqësor në vazhdimësi.

Për më tepër, një kornizë e tillë monitorimi duhet të jetë e paanshme dhe profesionale, për të qenë e besueshme dhe e aftë për të siguruar informacionin e nevojshëm empirik dhe cilësor për hartuesit e politikave dhe menaxherët e gjykatave, për të kryer rregullimet dhe përshtatjet e nevojshme.

Për arsytet e lartpërmendura, është hartuar ky dokument i titulluar “Monitorimi i Integritetit Gjyqësor”, që në thelb mbart filozofinë e një Plani Integriteti për Gjyqësorin Shqiptar, i cili evidenton standardet e kërkuara të performancës së gjyqësorit shqiptar, sipas parashikimeve kushtetuese, ligjore, ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe ofron treguesit e realizimit të këtyre standardeve dhe metodologjinë diagnostikuese për matjen e standardeve të kërkuara në dhënien e drejtësisë.

Duhet patur parasysh që faktorët e parashikuar, për çdo standard të kërkuar, të lidhur me integritetin e gjyqësorit, ndërhyjnë te njeri-tjetri, dhe për të matur realizimin e tyre duhet ndjekur një metodologji matje e kryqëzuar, p.sh. *transparenca* dhe *llogaridhënia*, kanë indikatorë dhe tregues matjeje të njëjtë dhe që mund të kombinohen me njëri-tjetrin, për të dalë në konkluzionin e masës së realizimit të tyre, ose kohëzgjatja e paarsyeshme e procesit mund të tregojë inefficencë, por që është e lidhur dhe me cilësinë e dobët të dhënies së drejtësisë.

Po kështu, duhet pasur parasysh që, mjetet matëse të cilësisë së shërbimeve gjyqësore, që përdoren ndërkombëtarisht janë kryesisht tre: - përdorimi dhe analizimi i **statistikave të gjykatës**, - rezultatet e **auditeve dhe kontroleve** nga institucione apo profesionistë të specializuar; - **anketimet dhe sondazhet** mes gurpeve të ndryshme, brenda dhe jashtë gjyqësorit, përdorues të shërbimit, ose ndikues në shërbim. Këto mjete janë sugjeruar për përdorim për matje të disa faktorëve në MIGJ, të cilat janë të lidhura me cilësinë e shërbimeve gjyqësore, si p.sh. të gjithë faktorët e parashikuar te KAPITULLI III - Transparenca dhe pjesëmarrja aktive, si aksesin në drejtësi, aksesin në informacion, si dhe te KAPITULLI IV - Eficenca në dhënien e drejtësisë, faktorë të lidhur me menaxhimin e gjykatave, me rolin e gjyqtarëve, me ngarkesën në punë, me standardet e performancës së stafit jogjyqësor.

## 1.2. Qëllimi (monitorimi i respektimit të standardeve të integritetit në veprimtarinë gjyqësore) dhe destinacioni (grupet e shënjestruara-organizatat e shoqërisë civile, studentët e drejtësisë dhe gazetarët) i Guidës

Kjo Guidë prezanton:

- Standardet kushtetuese dhe ligjore kombëtare, referuar legjislacionit dhe interpretimeve gjyqësore nga burime autoritative të këtyre standardeve (GjK, GjEDNj);
- Standardet ndërkombëtare dhe treguesit për cilësinë e drejtësisë, duke marrë parasysh ekspertizën e organizatave ndërkombëtare dhe evropiane (KiE, CCJE, ENCJ, CEPEJ, UNODC, OECD);
- Përcaktimi i trasesë/rrugëtimit për monitorimin e cilësisë së drejtësisë, strukturat dhe standardet e nevojshme institucionale për të informuar, lehtësuar qasjen dhe komunikimin me përdoruesit e gjykatave;
- Faktorët dhe aktorët ndikues për menaxhimin e cilësisë së proceseve gjyqësore, vendimeve dhe shërbimeve gjyqësore<sup>3</sup> (drejtësisë), mjetet e matjes (*court tools*), së performancës gjyqësore, vetëdiagnoza dhe vetëvlerësimi, dhe mekanizmat korigjuese dhe përmirësuese;
- Treguesit e nivelit të realizimit të standardeve të kërkuara në dhënien e drejtësisë, të lidhura me pavarësinë, llogaridhënien, transparencën, eficientësinë dhe efikasitetin;
- Matjet për realizimin e cilësisë së drejtësisë dhe përpjekjet për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e përdoruesve të gjykatave.

Metodologjia e Integritetit në gjyqësor mbështetet në disa parime kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e vetëqeverisjes së gjyqësorit, zbatimin e cilave ndikon në parandalimin e shkeljeve që cenojnë integritetin e gjykatës. Këto parime përfshijnë:

- Qartësi në përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe standardeve për procesin e vendimmarrjes.
- Rritje e transparencës, pasi minimizon risqet apo mundësitë për risqe që dëmtojnë integritetin e KLGj/Gjykatës.
- Rritja e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë si garanci për zbatimin e ligjshmërisë në KLGj/Gjykata.
- Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

Në thelb, monitorimi i integritetit gjyqësor, kërkon zhvillimin e një konsensusi të gjerë midis grupeve të synuara (aktorët institucionalë dhe komuniteti) në lidhje me objektivat e performancës (në nivelin e gjyqësorit si pushtet, gjykatave si institucion, dhe gjyqtarëve si funksionarë), që janë të favorshme për integritetin gjyqësor dhe treguesit e arritjes së objektivave të tilla. Palët e interesit duhet të bien dakord se çka saktësisht duhet të monitorohet, në mënyrë që të kuptohet nga gjyqësori në përgjithësi, dhe të facilitohet kontrolli dhe

---

3. CEPEJ, 2016 (12), "Measuring the quality of justice", miratuar më 7 Dhjetor 2016, CEPEJ website: <https://rm.coe.int/european-commission-for-the-efficiency-of-justice-cepej-measuring-the-/1680747548>

monitorimi i masave mbrojtëse kundër korrupsionit dhe pro-integritetit.

Grupet e synuara autorizohen të përdorin **Listën e Kontrollit të Masave Mbrojtëse për Përmirësimin e Integritetit Gjyqësor**<sup>4</sup>, me 35 faktorë të identifikuar, dhe të personalizuar për Gjyqësorin Shqiptar, në vendimet e politikave dhe të menaxhimit, që synojnë nxitjen e përmirësimit të integritetit (ose reduktimin e mundësive për korrupsion dhe sjellje anti-integritet). Ky dokument përveç se konsultimit paraprak para miratimit, sigurisht do të jetë pjesë e ndryshimeve pas testimit në praktikë, si dhe subjekt i përmirësimeve në vazhdimësi, ku gjykatat janë të inkurajuar të shtojnë faktorë ndikues në integritetin e gjykatës përkatëse.

### 1.3. Përkufizimi i integritetit gjyqësor

Integriteti është atributi i ndershmërisë dhe i drejtësisë. Komponentët e integritetit janë ndershmëria dhe morali gjyqësor. Një gjyqtar duhet gjithmonë, jo vetëm të veprojë me nder në kryerjen e detyrave zyrtare dhe të jetë i lirë nga mashtrimi dhe gënjeshtria në mënyrën që i përshtatet funksionit gjyqësor, por edhe të jetë i mirë dhe i virtytshëm në sjellje dhe në karakter.<sup>5</sup>

Nuk ka shkallë integriteti. Ai është absolut. Në gjyqësor, integriteti është më shumë se një virtyt, është një domosdoshmëri.<sup>6</sup>

### 1.4. Struktura e guidës (kapitujt, seksionet)

Guida i referohet standardeve vendase, referuar zbatimit të ligjit për statusin e gjyqtarit, parametrave ligjore, ekonomike dhe sociale vendas, garantues të imunitetit të gjyqtarëve, por edhe atyre ndërkombëtare të zhvilluara për monitorimin e integritetit të gjyqësorit. Kështu, tregues të zhvilluar nga UNDP-ja, apo Indeksi i GRECO-s janë në referim të materialit të hartuar. Konkretisht, Guida përfshin edhe Listën e Kontrollit të Masave Mbrojtëse për Përmirësimin e Integritetit Gjyqësor.<sup>7</sup>

4. Judicial Integrity Self- Assessment Checklist është zhvilluar nga UNDP, ff.5-10, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, 2018. Kjo listë (*Integrity Checklist*) identifikon 20 fusha, thelbësore për sigurimin e një niveli të lartë të integritetit gjyqësor, por ka fusha të tjera bazuar mbi praktikën e punës së gjykatave, që gjithashtu ndikojnë në integritetin e gjykatës dhe besimin e publikut në të. Lista e Kontrollit të Integritetit është hartuar mbi Kuadrin Ndërkombëtar për Përsosmëri në Gjykatë, si një sistem i menaxhimit të cilësisë për të përmirësuar performancën e gjykatës, IFCE - International Framework on Court Excellence

Website: <http://www.summitofhighcourts2018.com/docs/prezantime/GJYQËSOR%20INTEGRITY%20SELF-VLERËSIMI%20CHECKLIST.pdf>.

Megjithatë e lidhur me Listën e Kontrollit të Integritetit Gjyqësor sipas UNDP, është dhe Lista e Kontrollit të Cilësisë së Drejtësisë sipas CEPEJ, dhe Lista e Kontrollit për Shtetin e së Drejtës sipas Komisionit të Venecias.

5. Parimet e Bangladorit, fq. 63. Shih në: [https://www.unodc.org/res/ji/import/international\\_standards/commentary\\_on\\_the\\_bangalore\\_principles\\_of\\_judicial\\_conduct/bangalore\\_principles\\_english.pdf](https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf) (aksesuar në maj 2023)

6. Po aty.

7. Kjo listë është zhvilluar nga UNDP, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, 2018, ff.5-10. Ajo përfshin 20 fusha thelbësore për sigurimin e një niveli të lartë të integritetit gjyqësor, si aspekte të lidhura me praktikën e punës së gjykatave, që gjithashtu ndikojnë në integritetin e gjykatës dhe besimin e publikut në të. Lista e Kontrollit të Integritetit është hartuar mbi Kuadrin Ndërkombëtar për Përsosmëri në Gjykatë, si një sistem i menaxhimit të cilësisë



Guida organizohet në nëntë pjesë. Pjesa e parë trajton standardet ndërkombëtare, sipas dokumenteve kryesore të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, OSBE-së, ashtu edhe të literaturës dhe të jurisprudencës, ku rol themelor luan ajo e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në interpretim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në këtë pjesë vëmendja përqendrohet edhe në rëndësinë e integritetit gjyqësor për mbarëvajtjen e të gjithë sistemit gjyqësor.

Pjesa e dytë trajton natyrshëm kuadrin ligjor dhe strategjik në fuqi në vend, duke filluar nga Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore, strategjia e Drejtësisë në fuqi dhe dokumente të tjera sipas rastit.

Pjesa e tretë përqendrohet në monitorimin e pavarësisë dhe paanshmërisë të sanksionuara nga Kushtetuta e Shqipërisë si parime themelore atë të ndarjes dhe balancës së pushteteve, duke qartësuar se pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është një qëllim në vetvete, por është e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Pjesa e katërt trajton monitorimin e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies, si kërkesa formale që duhen plotësuar të kërkuara nga ligji, por edhe nga publiku që duhet ta perceptojë gjyqësorin si llogaridhënës. Matja e të dy niveleve të llogaridhënies, asaj objektive dhe subjective, është me rëndësi në këtë drejtim.

Pjesa e pestë trajton monitorimin e transparencës administrative si një aspekt që u mundëson qytetarëve të marrin pjesë dhe të mbikëqyrin procesin e vendimmarrjes gjyqësore dhe administrimit të gjykatave, si një nga pushtetet publike kushtetuese; rrit eficientë në dhënien e drejtësisë, forcon kontrollin e qytetarëve mbi pushtetin gjyqësor dhe kontribuon në rritjen e besimit të publikut (legjitimitetit) të pushtetit gjyqësor.

Pjesa e gjashtë trajton monitorimin e eficientës së gjyqësorit si një nga komponentët e integritetit të gjyqësorit. Vonesat në ekzekutimin e urdhrave/vendimeve të gjykatës, lëshimi i pajustificuar i fletëthirrjeve për gjyq dhe i nxjerrjes në liri me kusht, ndryshueshmëria e dhënies së dënimeve e pajustificuara, mosjellja e të burgosurve/atyre nën masa sigurie para gjykatës, vonesat në dhënien dhe zbardhjen e vendimeve, treguesit e lartë të dhënies së dënimeve me pafajësi, konfliktet e interesave, qëndrimi i zgjatur si gjyqtar në një gjykatë të caktuar ose një karrierë jomeritore, shoqëria e tepruar me disa anëtarë të caktuar të gjyqësorit, punësimi para dhe pas humbjes së statusit të magjistratit, janë tregues që lidhen me eficientë.

Pjesa e shtatë trajton monitorimin e kompetencës dhe të përkushtimit profesional të gjyqtarëve. Shteti i të drejtës nënkupton jo vetëm pavarësinë e gjyqësorit, por edhe gjykata

---

për të përmirësuar performancën e gjykatës, IFCE - International Framework on Court Excellence. Shih në: <http://www.summitofhighcourts2018.com/docs/prezantime/GJYQËSOR%20INTEGRITY%20SELF-VLERËSIMI%20CHECKLIST.pdf> (aksesuar

Megjithatë e lidhur me Listën e Kontrollit të Integritetit Gjyqësor sipas UNDP, është dhe Lista e Kontrollit të Cilësisë së Drejtësisë sipas CEPEJ, dhe Lista e Kontrollit për Shtetin e së Drejtës sipas Komisionit të Venecias.

kompetente që janë në gjendje të vënë në zbatim një drejtësi cilësore. Pavarësia, kompetenca dhe përkushtimi ndaj vlerave profesionale janë parakushte që gjyqësori të performojë me standardet e duhura në përmbushjen e funksionit të tij gjykues, si mbrojtës i lirisë dhe vendosës i drejtësisë në një shoqëri demokratike.

Pjesa e tetë përfshin monitorimin e menaxhimit të gjykatave dhe të personelit jogjyqësor. Burimet njerëzore, menaxhimi i brendshëm i tyre passjellin standarde eficece dhe efikasiteti në gjykata, prandaj dhe duhen matur në nivelin e realizimit.

Pjesa e nëntë dhe e fundit trajton monitorimin e financimit të gjyqësorit. Buxheti i nevojshëm financiar, burimet njerëzore dhe infrastrukurore sjellin standarde pavarësie, eficece dhe efikasiteti në sistemin gjyqësor (si pushtet dhe si gjykata), prandaj dhe duhen vlerësuar dhe matur.

Qasja në të gjitha pjesët që trajtojnë monitorimin është e njejtë: trajtohet monitorimi i standardeve të performanceës, treguesit e realizimit për secilin nga standardet, metoda e matjes së realizimit të tyre duke përfshirë të dhënat që duhen mbledhur; indikatorët sasiorë dhe/ose cilësorë duke u përqendruar në ato thelbësorët, burimin e të dhënave dhe mënyrën e mbledhjes së tyre.

Së fundi, Guida përfshin bibliografinë e përdorur për hartimin e saj, me qëllim që të shërbejë edhe si material referues në literaturën e duhur, për çdo rast që organizatat e shoqërisë civile apo cilido që do të përfshihet në proceset e monitorimit të integritetit të gjyqësorit, të mund ta përdorë sipas nevojave.

## Pjesa 1

# STANDARDET NDËRKOMBËTARE

### 1. *Standardet ndërkombëtare sipas dokumenteve madhore (OKB, KE, OSBE), literaturës dhe jurisprudencës (KEDNJ)*

Ka shumë parime dhe standarde të pranuar dhe të zbatuara ndërkombëtarisht që mbështesin integritetin gjyqësor dhe parandalimin e korrupsionit. Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm thekson rolin qendror të institucioneve transparente, efektive dhe të përgjegjshme në promovimin e shoqërive paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse dhe rëndësinë e dhënies së drejtësisë për të gjithë.

Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit kërkon që shtetet palë të marrin masa për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar mundësitë për korrupsion midis anëtarëve të gjyqësorit. Një grup i gjerë parimesh dhe masash, të përfshira në Udhëzuesin e Zbatimit dhe Kornizën Vlerësuese për nenin 11 të kësaj Konvente, kanë formuar bazën e shumë prej artikujve të listës së kontrollit. Neni 11 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit njeh rolin vendimtar të gjyqësorit në luftën kundër korrupsionit dhe kërkon që shtetet palë, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor dhe pa cenuar pavarësinë e gjyqësorit, të marrin masa për forcimin e integritetit dhe parandalimin e mundësive për korrupsion midis anëtarëve të gjyqësorit, duke përfshirë rregullat në lidhje me sjelljen e anëtarëve të gjyqësorit.<sup>8</sup>

*Duke pasur parasysh pavarësinë e gjyqësorit dhe rolin e saj të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të sistemit të saj ligjor dhe pa paragjykuar pavarësinë e gjyqësorit, merr masa për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar mundësitë për korrupsion mes anëtarëve të gjyqësorit. Masa të tilla mund të përfshijnë rregulla në lidhje me sjelljen e anëtarëve të gjyqësorit.*

Neni 11 i Konventës së OKB kundër Korrupsionit

Deklarata e Dohas e vitit 2015, e miratuar nga Kongresi i Trembëdhjetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe të Drejtësisë Penale, riafirmoi përkushtimin

8. Shih tekstin në: [https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026\\_E.pdf](https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf) (aksesuar në prill 2023)

dhe vullnetin e fortë politik të shteteve në mbështetje të sistemeve të efektshme, të drejta, njerëzore dhe të përgjegjshme të drejtësisë penale dhe institucioneve që i përbëjnë ato.

Parimet e Sjelljes Gjyqësore të miratuara nga ECOSOC, Res. 2006/23, Bangalore, njohur si Parimet e Bangalorit, po ashtu janë një instrument me vlerë të madhe si për gjyqësorin ashtu edhe për publikun e gjerë dhe për të gjithë ata që janë të interesuar të vendosin një themel të fortë për një gjyqësor global me integritet të paprekshëm.<sup>9</sup>

#### 1.1. Lista e akteve ndërkombëtare<sup>10</sup>

- Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit. Miratuar në Kongresin e Shtatë të OKB-së, Milano, 1985;
- Deklarata e Pekinit për Parimet e Pavarësisë së Gjyqësorit në Rajonin LAWASIA. Pekin, 19 gusht 1995;
- Parimet e Commonwealth (Latimer House) mbi Tri Degët e Qeverisë;
- Projekt Parimet për Pavarësinë e Gjyqësorit - "Parimet e Sirakuzës";
- ECOSOC, Forcimi i Parimeve Bazë të Sjelljes Gjyqësore, 2006/23;
- Programi Global Kundër Korrupsionit, Forcimi i Integritetit Gjyqësor kundër Korrupsionit, 2001 Samiti Ibero-Amerikan i Presidentëve të Tribunaleve të Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatave Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve;
- Parimet Ndërkombëtare për Pavarësinë dhe Përgjegjshmërinë e Gjyqtarëve, Avokatëve dhe Prokurorëve. Udhëzuesi i praktikuesve nr. 1, 2007;
- Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve, Përgjegjshmëria Gjyqësore - Udhëzues për praktikuesit, 2016;
- Masat për zbatimin efektiv të Parimeve Bangalore të Sjelljes Gjyqësore;
- Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE). Strasburg, 19 nëntor 2002;
- Plani i Veprimtimit për Afrikën mbi Parimet e Komonuelthit mbi Përgjegjshmërinë dhe Marrëdhëniet Midis Tri Degëve të Qeverisë;
- Rekomandimi Nr. R (94) 12 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare të Pavarësisë, Eficencës dhe Rolit të Gjyqtarëve. Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 13 tetor 1994 në mbledhjen e 518-të të Zëvendësministrave;
- Deklarata e Kajros për Pavarësinë Gjyqësore;
- Komentari mbi Parimet e Bangalore të Sjelljes Gjyqësore;
- Deklarata e Stambollit mbi Transparencën në Procesin Gjyqësor;
- Karta Universale e Gjykatësit Transparency International, Raporti Global i Korrupsionit 2007: Korrupsioni në Sistemin Gjyqësor, 2007;
- Transparency International Rumania, Rritja e Aftësisë së Gjyqësorit për të frenuar kor-

9. Shih tesktin në: [https://www.unodc.org/res/ji/import/international\\_standards/commentary\\_on\\_the\\_bangalore\\_principles\\_of\\_judicial\\_conduct/bangalore\\_principles\\_english.pdf](https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf) (aksesuar në prill 2023)

10. Kjo listë është hartuar sipas Aneksit në "Judicial Integrity Self- Assessment Checklist" e zhvilluar nga UNDP, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, 2018, ff. 5-10.

- rupSIONIN – Një udhëzues praktik, 2015;
- U4 dhe UNDP, një gjyqësor transparent dhe i përgjegjshëm për të ofruar drejtësi për të gjithë, 2016 UNODC, Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit - Udhëzuesi i Zbatimit dhe Korniza Vlerësuese për Nenin 11, 2015;
- UNODC, Udhëzuesi i Burimeve për Forcimin e Integritetit dhe Kapacitetit Gjyqësor, 2011;

Një listë e këtyre akteve, organizuar sipas fushave të veprimit, pasqyrohet më poshtë:

### **Pavarësia**

- Rekomandimi i Këshillit të Evropës për Pavarësinë e Gjyqtarëve, Parimi 2 (b)
- Deklarata e Pekinit e Parimeve të Pavarësisë së Gjyqësorit në Rajonin LAWASIA (Parimet e Pekinit), nr. 3.a
- Karta Universale e Gjyqtarit, neni 1

### **Kushtet e Shërbimit Gjyqësor:**

- Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve, nr. 1.6, 2.1 – 2.2
- Deklarata e Pekinit për Parimet e Pavarësisë së Gjyqësorit në Rajonin LAWASIA (Parimet e Pekinit), nr. 13, 17 – 21, 41 - 42
- Udhëzimet e Latimer House, nr. II.1, II.2
- Karta Universale e Gjyqtarit, nr. 8 – 9
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. (94) 12, parimi I.2; I.3
- Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve, nr. 1-3, 4.1

### **Kodi i Sjelljes:**

- UNCAC - Udhëzues teknik; I fq.19
- Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore; Vlera 3.1
- Procedurat për Parimet Bazë; Procedura 1 dhe 3
- Vlerësimi GRECO; R2: Pjesa 2: 6.1 R4: 14.1; R2: Pjesa 2: GPC10; 5; R4: 12.2
- Deklarata e Kajros; fq. 2
- Plani i Veprimit për Afrikën mbi Parimet e Komonuelthit mbi Përgjegjshmërinë dhe Marrëdhëniet Midis Tri Degëve të Qeverisë; P. 3,2.2.2; P. 4,2.3.2

### **Konflikti i interesave:**

- UNCAC - Udhëzues teknik; II.7.fq. 18, 201; IV fq.25
- Vlerësimi GRECO; R1: Pjesa 2:GPC3 R2:Pjesa 2: 4.4; R4:13.2
- Deklarata e Montrealit; 2.02; 2.31
- Opinioni nr. 3 të KKGJE-së; F. 4, f. 17; F. 6, f. 37; F. 7, f. 39
- Parimet e Sirakuzës; A.23, A.28
- Karta Universale e Gjykatësit; F. 1, a.4

## Pjesa 2

### KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJIK NË FUQI NË R.SH.

Shqipëria gjatë viteve të fundit ka përqafuar një proces të jashtëzakonshëm të reformës në drejtësi, përfshirë edhe gjyqësorin dhe integritetin në gjyqësor. Kuvendi i Shqipërisë, pas një vlerësimi analitik të problemeve të shumta në sistemin gjyqësor, duke vënë në themel të tij domosdoshmërinë për ndryshime ligjore për funksionimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës<sup>11</sup> dhe si rrjedhojë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ndërmoi reformimin e sistemit gjyqësor si një nga kushtet thelbësore për t'u përmbushur.<sup>12</sup>

Në korrik të 2016, unanimisht, anëtarët e Kuvendit miratuan ndryshimet e Kushtetutës për të pasqyruar këtë reformë<sup>13</sup> të cilat prekën thellësisht pushtetin gjyqësor. U miratua sistemi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.<sup>14</sup> Në vijim u miratua ligji i rivlerësimit të përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, i njohur si “ligji i vettingut”, i cili ka gjithashtu rëndësi për faktin se vendos një standard të lartë për aktorët e sistemit të drejtësisë në vijimësi.<sup>15</sup>

Kuadri i ri ligjor, i cili përfshin edhe një tërësi institucionesh të reja të qeverisjes së sistemit gjyqësor, mundëson një sistem të bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni.

Një listë e akteve pasqyrohet më poshtë:

- Kushtetuta
- Ligje
- Akte të organeve drejtuese të gjyqësorit

---

11. <https://ba.boell.org/en/2018/08/01/vetting-judges-and-prosecutors-albanian-experience>

1 August 2018 by Ina Xhepa, “*The vetting of judges and prosecutors: An Albanian experience*”

12. Maxhuni B., Cucchi U., Analizë e Procesit të Vettingut në Shqipëri, Analizë e Politikave [*An Analysis of the Vetting Process in Albania, Policy Analysis*], No. 01/2017, fq.5.

13. Ligji nr.76/2016, dt. 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, Datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

14. Neni 179/b i ligjit nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.

15. Maxhuni B., Cucchi U., Analizë e Procesit të Vettingut në Shqipëri, Analizë e Politikave [*An Analysis of the Vetting Process in Albania, Policy Analysis*], fq.6.

## Pjesa 3

# PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA

### **Pse duhet vlerësuar/matur pavarësia dhe paanshmëria**

Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon si parim themelor atë të ndarjes dhe të balancës së pushteteve. Neni 7 i Kushtetutës parashikon se: “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore”<sup>16</sup>.

Ky parim themelor është garanci për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Pjesë thelbësore e tij është autonomia dhe pavarësia e gjyqtarëve, të cilat *përbëjnë garanci efektive për të drejtat e qytetarëve*. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në paragrafin e dytë të nenit 42 të Kushtetutës parashikohet se: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. *Në këtë kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta*. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave<sup>17</sup>.

### **Faktori 1.1 Pavarësia institucionale e gjyqësorit**

#### ***1.1.1. Standardet e Performancës***

Pavarësia e gjyqësorit duhet kuptuar si *pavarësi thelbësore* (tagër e gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit) dhe si *pavarësi strukturore*. Si pjesë të pavarësisë strukturore konsiderohen njëkohësisht edhe *pavarësia organizative dhe financiare*<sup>18</sup>.

Kushtetuta ka sanksionuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, përmes Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në

---

16. Neni 7

17. Vendimi nr.11, datë 02.04.2008; vendimi nr.25, datë 05.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

18. Vendimi nr.25, datë 05.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese.



Republikën e Shqipërisë<sup>19</sup>.

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj<sup>20</sup>. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi<sup>21</sup>. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit<sup>22</sup>.

**Këshilli i Lartë Gjyqësor** propozon numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë bashkë me propozimin për buxhetin e sistemit gjyqësor, sipas procedurës së caktuar me ligj<sup>23</sup>.

Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:

- a) harton dhe ndjek zbatimin e politikave për administrimin gjyqësor;
- b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mblendhura, përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë;
- c) miraton rregullat e brendshme standarde të gjykatës<sup>24</sup>.

### **1.1.2 Treguesit e Realizimit**

Pavarësia e gjyqësorit mund të jetë objektive dhe subjektive dhe për të matur standardin e realizimit të pavarësisë ka dhe tregues dhe nëntregues të ndryshëm<sup>25</sup>. Do duhej që për treguesit e realizimit për standardet e pavarësisë thelbësore, organizative dhe financiare të shtroheshin pyetje, si:

- Sa i ka mekanizmat e duhur dhe efektivë të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit, Këshilli i Lartë Gjyqësor?
- Sa buxhet kërkon gjyqësori për vetëmenaxhim dhe vetëqeverisje financiare dhe sa i miratohet nga Kuvendi çdo vit?
- Sa struktura dhe organike kërkojnë institucionet e qeverisjes së gjyqësorit, dhe sa u miratohet nga Kuvendi?
- Sa shtesa vjetore në lidhje me stafin dhe numrin e punonjësve kërkohet, dhe a

19. Neni 147/1 i Kushtetutës.

20. Neni 135/1 i Kushtetutës.

21. Neni 136/1.

22. Ibid, neni 136/a.

23. Neni 21/1 i ligjit nr. 98/2016.

24. Neni 89 i ligjit nr. 115/2016.

25. ENCJ, Raport për Pavarësinë, Përgjegjshmërinë dhe Cilësinë e Gjyqësorit – Treguesit e Performancës [*Report on Independence, Accountability and Quality of the Judiciary – performance indicators*], miratuar nga Asambleja e Përgjithshme Paris, 9 qershor 2017, 2017, fq.15 -17.



miratohen, shkurtohen (...)?

- Sa kërkesa paraqiten në Gjykatë Kushtetuese nga subjekte të legjitimuara në mbrojtje të interesave të gjyqësorit, dhe a/sa pranohen ato nga kjo gjykatë?
- Sa është numri i vendimeve kundër ekzekutivit apo legjislativit, si tregues i fortë i pavarësisë së gjyqësorit dhe parimit të check & balance?
- Sa mendojnë vetë gjyqtarët që janë të pavarur në aktivitetet gjyqësore?
- Sa mendojnë qytetarët që gjyqësori është dhe vepron si i pavarur?

Pavarësia objektive është e lidhur me funksionimin struktural të gjyqësorit dhe ka këta nëntregues:

- garancitë formale të pavarësisë, të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj;
- garancitë formale, që gjyqtarët i binden vetëm ligjit;
- metodat formale mbi caktimin e pagave të gjyqtarëve;
- mekanizmat formalë për përshtatjen e pagave të gjyqtarëve;
- garancitë formale për përfshirjen e gjyqtarëve në zhvillimin e reformave ligjore dhe gjyqësore.

Autonomia organizative dhe financiare ka këta nëntregues:

- pozita formale e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- përputhshmëria me udhëzimet e Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësorë;
- përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- ndikimi i gjyqtarëve në vendimet e Këshillit;
- buxheti i Gjyqësorit, amendimet e tij dhe zgjidhja e konflikteve mbi buxhetin.<sup>26</sup>

### **1.1.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes për standardet e realizimit të pavarësisë objektive dhe subjektive, duhet të fokusohet në:

- Analizimin e kuadrit juridik mbi pavarësinë organizative dhe financiare në raport me situatën faktike, organizative dhe financiare, që rezulton për zbatimin e kuadrit juridik të financimit të gjyqësorit nga Kuvendi.
- Krahasim mes buxheteve vjetore të miratuara dhe atyre të kërkuara sipas nevojave. Statistika dhe analiza mbi kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet e legjitimuara dhe pranimi apo refuzimi i këtyre kërkesave, me pretendime të lidhura me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, me pavarësinë e gjykatave, me pavarësinë e gjyqësorit.
- Sondazhe të opinionit publik mbi perceptimin që ata kanë mbi pavarësinë e gjyqësorit, sipas standardeve të CEPEJ<sup>27</sup>. Perceptimi i pavarësisë në sistemin kombëtar

26. Ibid, Raporti i RREKJGJ “Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës”, 2017, fq.15.

27. Grupi i Punës për Cilësinë e Drejtësisë i Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë të Këshillit të Evropës (CEPEJ-GT-QUAL), Raporti “Si të zhvillojmë sondazhe mbi nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve të gjykatave në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës”, (CEPEJ 2010-2).

sipas opinionit publik, bazuar në Indeksin Global të Shtetit të së Drejtës, 2016.

- Raporte të autoriteteve ndërkombëtare mbi pavarësinë dhe korrupsionin (politik, financiar) si element varësie<sup>28</sup>, si; (Progres)Raportet e Komisionit Evropian, sondazhe të ndryshme kombëtare mbi korrupsionin dhe besimin e qytetarëve tek institucionet e shtetit, përfshirë pushtetin gjyqësor<sup>29</sup>.

## **Faktori 1.2 Pavarësia personale dhe paanësia e gjyqtarëve**

### **1.2.1 Standardet e Performancës**

Gjyqtarët u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku dhe, mbi të gjitha, te palët në proces. Për këtë qëllim, neni 42 i Kushtetutës kërkon që një gjykatë, e cila përfshihet në sferën e veprimit të tij, të jetë e paanshme. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme, jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet.

Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet, duke zbatuar **testin objektiv**, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë dhe **testin subjektiv**, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar. Nga pikëpamja e testit objektiv të paanshmërisë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm<sup>30</sup>.

GJEDNJ-ja ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit, nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm”, si dhe “fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve, që kryen ai gjatë procesit gjyqësor”<sup>31</sup>.

Pavarësia e gjyqtarit ka aspektin e saj:

- *të brendshëm*, që lidhet me pavarësinë e gjyqtarit, që të vendosë për çështjen pa u

28. CM/Res (97) 24 Mbi njëzet parimet udhëzuese për luftën kundër korrupsionit. Shih: <https://rm.coe.int/16806cc17c>

29. GRECO, Parandalimi i Korrupsionit, përfundime dhe tendenca, 4th Evaluation Round, ff.17-25.

30. Vendimet: nr.7, datë 11.03.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

31. Vendimi i GJEDNJ, *Gjonboçari kundër Shqipërisë*, datë 31 mars 2005.

ndikuar nga vetë struktura e gjyqësorit që i përket, pra marrëdhënia e gjyqtarit e ndërlidhur me kolegët, kryetarin e gjykatës, apo KLGj-në, dhe

- të jashtëm, që është pavarësia e gjyqtarit në ushtrimin e detyrës, pa u ndikuar nga politika, legjislativi, ekzekutivi, partitë politike, qarqet ekonomike, etj<sup>32</sup>.

### **1.2.2 Treguesit e realizimit**

Pavarësia e gjyqtarit, ashtu si e gjyqësorit, mund të jetë objektive dhe subjektive dhe për të matur standardin e pavarësisë ka dhe tregues dhe nëntregues të ndryshëm<sup>33</sup>. Si tregues të realizimit të këtij standardi, kontrolli i brendshëm dhe korrigjues brenda sistemit gjyqësor sipas procedurave ligjore është më i rëndësishmi. Për pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarit, KPC dhe KPP, ashtu si dhe kontrolli kushtetues i procesit të rregullt ligjor, konkretisht elementi i paanësisë objektive dhe subjektive, janë tregues të realizimit së këtij standardi.

Tregues të tjerë janë:

- përzgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve;
- përputhshmëria e udhëzimeve të Rrjetit Evropian të Gjyqtarëve mbi emërimin e gjyqtarëve;
- vlerësimi, promovimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve.

Masat disiplinore me këto tregues:

- përputhshmëria e standardeve të ENCJ-së lidhur me masat disiplinore ndaj gjyqtarëve;
- organi kompetent për marrjen e vendimeve ndaj masave disiplinore;
- mostransferimi i gjyqtarëve me këta nëntregues:
- garanci formale për mostransferimin; parashikime mbi transferimin pa pëlqimin e tyre.

Pavarësi e brendshme, sipas këtyre nëntreguesve:

- ndikim nga gjyqtarët më të lartë;
- mundësia efektive e përdorimit të udhëzimeve;
- ndikimi nga administratorët/drejtuesit e gjykatës.<sup>34</sup>

Pavarësia subjektive është e lidhur me perceptimin që gjyqtarët, grupet e interesit, përdoruesit e shërbimeve të drejtësisë, kanë në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit.

32. CCJE, 2001, Opinion nr. 1. Shih:

<https://www.coe.int/en/web/ccje/opinion-n-1-on-independence-of-judges-and-opinion-n-2-on-funding-of-courts>; Rekomandim i Komitetit të Ministrave, Këshilli i Evropës CM/Rec (2010)12 në

[https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78); Raport i Komisionit të Venecias në: [www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD\(2010\)004-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD(2010)004-e.pdf)

33. Raporti i ENCJ, Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës, 2017, ff.15 -17.

34. *Ibid*, fq.16.

### 1.2.3 Metoda e matjes

Metoda për matjen e respektimit të këtij standardi, pra pavarësia personale dhe paanësia objektive dhe subjektive të gjyqtarëve, janë:

- Analiza e vendimmarrjeve gjyqësore nga gjykata më e lartë për më të ultën, sipas pretendimeve procedurale të palëve mbi paanësinë objektive dhe subjektive të gjyqtarit;
- Statistikat gjyqësore, me një zë të veçantë, “shfuqizim të vendimeve gjyqësore për shkelje të rënda procedurale lidhur me paanësinë e gjyqtarit në gjykim”;
- Analiza e GJEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë me objekt nenin 6 të KEDNj-së dhe standardin e paanësisë;
- Vendimet e KLGj-së për shkarkimin e gjyqtarëve dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, pas ankimit të gjyqtarëve;
- Sondazhe sipas standardeve të CEPEJ-së, lidhur me vetëvlerësimin që i bëjnë gjyqtarët pavarësisë së tyre<sup>35</sup>;
- Sondazhe të opinionit publik mbi perceptimin, që ata kanë mbi pavarësinë e gjyqtarëve si individë, sipas standardeve të CEPEJ-së.

## Faktori 1.3 “Imunizimi” socio-politik i gjyqësorit

### 1.3.1 Standardet e performancës

Imunizimi “socio-politik” është i lidhur me pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit si pushtet, por dhe të gjyqtarit si funksionar publik. Imunizimi struktural i gjyqësorit është kusht i rëndësishëm për pavarësinë e gjyqësorit. Imunizimi i gjyqtarit duhet konsideruar si *kusht sine qua non në këtë drejtim*. Një gjyqtar mund të ndikohet gjatë punës së tij nga aktorë të jashtëm si organizata dhe grupe të ndryshme interesi, por edhe nga brenda sistemit, nga kolegë ose nga gjyqtarë me karrierë më të sukseshme, në pozicion gjyqtari në gjykatat më të larta. Gjyqtari nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Gjyqtari duhet të marrë çdo masë për të qenë, dhe të duket se është, jashtë çdo ndikimi prej tyre. Gjyqtari njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij<sup>36</sup>. Në çështjen *Filippini v. San Marino*, GJEDNj-ja u shpreh se, megjithëse simpatitë politike luajnë rol në procesin e emërimit, kjo është e pamjaftueshme për të ngritur dyshime lidhur me pavarësinë dhe me paanshmërinë e gjyqtarëve. Ajo që ka rëndësi për GJEDNj-në është fakti, se nuk duhet të ketë orvatje për të influencuar gjyqtarët pas emërimit të tyre. Në çështjen *Sacilor-Lormines*, GJEDNj-ja konkludoi se: “emërimi i gjyqtarëve nga një anëtar i ekzekutivit, apo Parlamenti, në vetvete nuk krijon lidhje vartësie, me kusht që pas emërimit të tyre, mbi ta nuk ushtrohet presion në ushtrimin e funksioneve të tyre gjyqësore”.

35. *Ibid*: Periodiciteti i matjes së treguesve dhe realizimi i sondazheve mbi pavarësinë dhe llogaridhënie, rekomandohet në çdo dy vjet. Kjo sugjerohet pasi në më shumë se 2 vjet mund të nxiste apatinë e gjyqtarëve për të qenë pjesmarrës, ose në më pak kohë do të rrishte domosdoshmërinë e pyetësorit, fq.7.

36. Neni 3, pika 3, i ligjit nr. 96/2016.

Imunizimi ka lidhje me parakushtet formale dhe substanciale, institucionale dhe personale të natyrës ligjore, ekonomike, sociale dhe familjare, që i mundësojnë gjyqtarit të ushtrojë detyrën, dhënien e drejtësisë i pandikuar, i pavarur dhe jo në konflikt interesi, sipas standardeve të Kartës Evropiane të Statusit të Gjyqtarit, të Këshillit të Evropës, 1998, si dhe Memorandumit Shpjegues të Kartës<sup>37</sup>.

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit<sup>38</sup>. Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi. Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur:

- a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare;
- b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;
- c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit<sup>39</sup>.

Ligji nr. 96/2016, ka parashikuar një sërë të drejtash lidhur me pagën e gjyqtarit dhe përfitimeve financiare, kredi për shtëpi, paprekshmëria e pagës dhe përfitimeve të tjera, pushimet vjetore, kushtet e punës, etj.<sup>40</sup>

### **1.3.2 Treguesit e realizimit**

Treguesit e realizimit për këtë faktor janë:

- Garantimi formal i imunizimit të gjyqtarit, përmes parametrave ligjorë, të infrastrukturës organizative të ushtrimit të funksionit, lëvizjes, karrierës së gjyqtarit. Ky tregues është i lidhur me pavarësinë dhe llogaridhënien.
- Garantimi i kushteve ekonomike-sociale të gjyqtarit sipas ligjit për statutin e magjistratëve.
- Garantimi i kushteve të përshtatshme të punës, që i krijojnë komoditet në ushtrimin e funksionit.
- Garantimi i kushteve dhe kritereve ligjore për të realizuar me efikasitet shqyrtimin e çështjeve gjyqësore.

Për treguesit e realizimit të imunizimit socio-politik të gjyqtarit mund të bëhen pyetje të tilla, si:

- Sa garantues është Kushtetuta dhe ligji për statusin e gjyqtarit, por edhe ligje të tjera procedurale dhe materiale, ndaj pavarësisë dhe panësisë së gjyqtarit?

37. Shih: <https://rm.coe.int/16807473ef>

38. Neni 143 i Kushtetutës.

39. Ibid, Neni 137-138 i Kushtetutës.

40. Nenet 11-27 të ligjit nr. 96/2016.

- Sa garantues është statusi i gjyqtarit për garantimin e profesionit, palëvizshmërinë në detyrë dhe e vazhdimësisë së karrierës së tij?
- Sa garantuese është paketa sociale dhe ekonomike e gjyqtarit ndaj ndërhyrjeve?
- Sa të duhura dhe të përshtatshme janë kushtet e punës së gjyqtarit?
- Sa miqësor/armiqësor është ambjenti politik ndaj gjyqësorit/ndaj gjyqtarit?
- Sa vulnerabël është gjyqësori/gjyqtari ndaj presionit politik?
- Sa vulnerabël është gjyqtari ndaj medietizimit të punës dhe rolit të tij në një çështje konkrete?

### 1.3.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes për këto tregues përfshin:

- Analizë të statusit të gjyqtarit shqiptar me standardet ndërkombëtare të kërkuara<sup>41</sup>.
- Hulumtim të situatës faktike dhe nivelit të zbatimit të ligjit për statusin e gjyqtarit, mbi parametrat ligjore, ekonomike dhe sociale, garantues të këtij imuniteti.
- Vlerësim të vulnerabilitetit të gjyqtarit ndaj ndërhyrjeve dhe korrupsionit, sipas Indekseve të GRECO<sup>42</sup>.

## Faktori 1.4 Mbrojtja e gjyqtarëve

### 1.4.1 Standardet e Performancës

Garancitë mbrojtëse të gjyqtarëve të sanksionura në Kushtetutë ofrojnë më tepër mbrojtje se sa ato të ofruara në legjislacion. Kushtetuta ka sanksionuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, përmes Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë<sup>43</sup>. Kushtetuta ka parashikuar garanci mbrojtëse ndaj ndërhyrjeve në nivel gjyqësori dhe gjyqtari. Kështu, ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit<sup>44</sup>. Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi<sup>45</sup>. Po kështu, Kushtetuta ka parashikuar garancitë mbrojtëse ndaj shkarkimit të gjyqtarit, duke parashikuar arsyet/shkaqet dhe organin kompetent për vendimin përfundimtar të ankimit, Gjykatën Kushtetuese. Kundër vendimit të shkarkimit mund të

41. Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, vlerësohet se i plotëson këto standarde *de jure*. Gjithsesi vendimi i GJK nr.41, datë 16.05.2017 ka shfuqizuar disa nene; 5, 61, 103, 159 dhe 169, pika 5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nën dritën e standardeve ndërkombëtare të garancive të magjistratit, për shkaqet dhe ankim ndaj masave disiplinore.

42. Shih: [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/index\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/index_en.asp). dhe <https://rm.coe.int/greco-rc4-2018-4-raundi-i-katert-i-vleresimit-parandalimi-i-krimet-ne-/16808c439b>

43. Neni 147/1 i Kushtetutës.

44. Neni 145/3 i Kushtetutës.

45. Neni 137/4 i Kushtetutës.

bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.<sup>46</sup>

Nga ana tjetër, ka parashikime dhe mbrojtje të nivelit personal; si, paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur:

- a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare;
- b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;
- c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.<sup>47</sup>

Në çështjen *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, GJEDNj u shpreh për rëndësinë dhe garancitë e një procesi të rregullt ligjor ndaj kategorisë së gjyqtarëve, si dhe garancitë mbi kohëzgjatjen e procedurave bazuar në natyrën e konfliktit të lidhur me dinjitetin njerëzor dhe marrëdhëniet e punës së ankueses, si gjyqtare e shkarkuar nga detyra.<sup>48</sup>

#### **1.4.2 Treguesit e realizimit**

Treguesit e realizimit të këtij standardi janë të njëjtë me treguesit e realizimit të standardit të pavarësisë institucionale dhe personale. Shih më lart 1.1.2 dhe 1.2.2.

#### **1.4.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes përfshin:

- Prodhim të statistikave dhe të dhëna mbi garancitë substanciale dhe procedurale të gjyqtarëve, gjatë proceseve disiplinore ndaj tyre.
- Raportime të ndryshme të autoriteteve përgjegjëse, për masën e realizimit të ligjit të statusit të magjistratit/gjyqtarit.

### **Faktori 1.5 Meritokracia në karrierën gjyqësore**

#### **1.5.1 Standardet e Performancës**

Për ngritjen në detyrë, gjyqtari duhet të plotësojë kriteret minimale për përvojën profesionale, por edhe kushte të tjera të lidhura me sigurinë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, apo me përvojën e veçantë të fushës të së drejtës për vendin e lirë. Parashikimet ligjore tregojnë dhe standardet e kërkuara të performancës dhe kriterizimin për karrierën e gjyqtarit<sup>49</sup>.

46. Neni 140 i Kushtetutës.

47. Neni 138 i Kushtetutës.

48. Shih: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2010/12/07/18381-05>

49. Neni 47-52 të ligjit nr. 96/2016.



Sistemi i vlerësimit bazohet dhe zbatohet nëpërmjet këtyre parimeve:

- a) **parimi i pavarësisë**, sipas të cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e magjistratit;
- b) **parimi i meritokracisë** dhe i zhvillimit të karrierës, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së magjistratit kryhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale;
- c) **parimi i efikasitetit**, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme për të siguruar të dhëna në kohën e duhur për karrierën e magjistratit;
- ç) **parimi i procesit të rregullt ligjor**, sipas të cilit në procedurën e vlerësimit respektohen standardet e procesit të rregullt ligjor për magjistratin, duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar dhe të drejtën për t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit;
- d) **parimi i konfidencialitetit**, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të magjistratit që vlerësohet, si dhe të dhënat e tij personale, sipas legjislacionit në fuqi<sup>50</sup>.

### ***1.5.2 Treguesit e realizimit***

Treguesit objektivë të realizimit të standardit të meritokracisë kanë lidhje me:

- parametrat ligjore të sanksionuar në ligj dhe
- realizimin e këtyre standardeve ligjore dhe respektimin nga organet emërtuese, KLGj si organ kushtetues për vlerësimin e gjyqtarëve në varësi të aplikimeve të tyre, pritshmërive për karrierë dhe mundësisë së realizimit të saj.

### ***1.5.3 Metoda e Matjes***

Metoda e matjes përfshin:

- Të dhëna dhe statistika të KLGj-së mbi emërimet, vlerësimet dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve.
- Sondazhet mes vetë gjyqtarëve
- Perceptimi i gjyqtarëve për mundësinë reale dhe progresin e karrierës në gjyqësor.

---

50. Neni 69 i ligjit nr. 96/2016.



## Pjesa 4

# PËRGJEGJSHMËRIA DHE LLOGARIDHËNIA

### **Pse duhet vlerësuar/matur:**

Për të qenë llogaridhënës, jo vetëm duhen plotësuar kërkesat formale, por edhe publiku duhet ta perceptojë gjyqësorin si llogaridhënës. Ekzistojnë dy nivele llogaridhënieje: objektive dhe subjektive. Edhe pse ka parashikime për procedurën formale të llogaridhënies, perceptimi subjektiv i qytetarëve mbi llogaridhënien e gjyqësorit apo të gjyqtarit, është i një rëndësie po aq të madhe. Për shembull, gjyqtarët dhe gjyqësori nuk duhet të perceptohen “si dyqan i mbyllur”, të cilët veprojnë për menaxhimin e interesave të tyre, më tepër se sa për interesat e shoqërisë<sup>51</sup>.

### **Faktori 2.1 Regjimi disiplinor**

#### **2.1.1 Standardet e performancës**

Palëvizshmëria dhe qëndrimi në detyrë janë dhe faktorë kyç për pavarësinë e gjyqtarit. Megjithatë, rëndësia e pushtetit gjyqësor dhe pasja besim e publikut në të, detyrojnë përcaktimin e mekanizmave llogaridhënës për anëtarët e gjyqësorit. Kjo qasje përfshin regjimin disiplinor ndaj gjyqtarëve, deri në shkarkimin e tyre, të cilët janë të papërshtatshëm për profesionin që ushtrojnë.<sup>52</sup>

**Të gjithë gjyqtarët**, përfshirë kryetarët e gjykatave janë subjekt i vlerësimit të tyre etik dhe profesional, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj. **Kryetarët** vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar gjykate<sup>53</sup>.

Procedimi disiplinor mund të fillojë nëse gjyqtarët nuk i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe të duhur. Ky procedim duhet të kryhet nga një autoritet i pavarur ose gjykatë me të gjitha garancitë e një gjykimi të drejtë dhe t'i japë gjyqtarit të drejtën të kundërshtojë vendimin dhe masën. Masat disiplinore duhet të jenë proporcionale. Gjyqtarët nuk duhet të mbahen personalisht përgjegjës kur vendimi i tyre rrëzohet ose ndryshohet në shkallë apeli.<sup>54</sup>

51. *Ibid*, fq.11

52. ENCJ, Raporti, Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore [*Development of minimum judicial standards*] V 2014-2015, miratuar në Hagë, më 5 qershor 2015, fq.5.

53. Neni 70, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

54. Rekomandim (2010) 12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me gjyqtarët: pavarësia, efica

Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:

- a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;
- b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:

- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
- b) merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
- c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit<sup>55</sup>.

Këshilli mund të vendosë një ose më shumë nga këto masa disiplinore:

- a) vërejtje konfidenciale;
- b) vërejtje publike;
- c) ulje e përkohshme e pagës:
  - i) deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit;
  - ii) në rastin e magistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës;
- ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;
- d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;
- dh) shkarkim nga detyra<sup>56</sup>.

Ligji ka parashikuar tri kategori shkeljesh disiplinore:

1. *gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor*;<sup>57</sup>
2. *gjatë ose në lidhje me ushtrimin e funksionit, brenda ose jashtë zyrës*;<sup>58</sup>
3. *jashtë ushtrimit të funksionit*.<sup>59</sup>

**KL Gj-ja** përbëhet nga komisione të përhershme të përcaktuara me ligj, përfshirë Komisionin e Disiplinës, i cili përbëhen nga tre anëtarë të Këshillit. Dy nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës

---

dhe përgjegjësitë, Këshilli i Europës, 2010, Kapitulli VII, nenet 69 -70

55. Neni 140 i Kushtetutës.

56. Neni 105 i ligjit nr. 96/2016.

57. *Ibid*, neni 102/1.

58. *Ibid*, neni 102/2.

59. *Ibid*, neni 103.

së KLGj-së janë gjyqtarë dhe njëri është jogjyqtar<sup>60</sup>. Ky komision është vendimmarrës lidhur me çështjet disiplinore ndaj gjyqtarëve.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë** është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve. ILD është i vetmi autoritet përgjegjës për hetimin disiplinor ndaj të gjithë gjyqtarëve, duke filluar nga marrja dhe verifikimi i ankesës, për të vijuar me hetimin disiplinor dhe finalizimin e procesit me fillimin e procedimit disiplinor përpara Këshillit përkatës - KLGj-së për gjyqtarët<sup>61</sup>.

**Kryetari i Gjykatës** mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, si dhe mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre<sup>62</sup>.

### **2.1.2 Treguesit e realizimit**

Ka një mbivendosje mes pavarësisë, llogaridhënies dhe disiplinimit, dhe disa tregues të pavarësisë dhe llogaridhënies mund të jenë dhe tregues të regjimit disiplinor. Ka dy lloj treguesish të realizimit: objektivë dhe subjektivë.

Treguesit objektivë duhet të konsiderohen si ata që janë të lidhur strukturalisht me gjyqësorin, ashtu dhe ata të lidhur individualisht me gjyqtarin. Regjimi disiplinor nuk është i mjaftueshëm për gjyqësorin si i tërë, por edhe për gjyqtarët individualisht. Përgjegjësia është e dyanshme: kolektive dhe individuale:

- **kolektive**, pasi është detyrë e gjyqësorit të përcaktojë përmes rregullave, parimeve dhe procedurave, nivelin e performancës së duhur të gjyqtarëve;
- **individuale**, pasi është përgjegjësi individuale e gjyqtarit t'u bindet atyre rregullave.<sup>63</sup>

Treguesit objektivë të realizimit janë:

- Miratimi i një Kodi të Sjelljes Gjyqësore, i cili e bën llogaridhënës gjyqtarin para opinionit publik për jetën profesionale dhe personale;
- Procedura ankimi ndaj gjyqtarit, në rast se pretendohet mbi shkaqe të pranueshme sjellja e tij joetike dhe profesionale; pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve nga jashtë sistemit, që e bën gjyqtarin llogaridhënës; apelim ndaj vendimit që mund të ketë vendosur në favor të gjyqtarit; numri i ankimeve, që mund të tregojë deri ku është

60. *Ibid*, neni 62 dhe neni 160.

61. *Ibid*, neni 194.

62. Neni 39 i ligjit nr. 98/2016.

63. *Ibid*, ENCJ, Raporti - Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore V 2014-2015 [*Report - Development of minimum judicial standards V 2014-2015*] miratuar Hagë, 5 qershor 2015, fq.13, dhe ENCJ Deklarata mbi Vetëqeverisjen për Gjyqësorin: Balancimi i Pavarësisë dhe i Përgjegjshmërisë [*Declaration on Self Governance for the Judiciary: Balancing Independence and Accountability*], Budapest (2008).

niveli i llogaridhënies në gjyqësor; numri i sanksioneve; kohëzgjatja e këtyre ankimeve dhe qasja pro aktive e organeve kompetente disiplinore, iniciuese të procesit si dhe vendimmarrëse ndaj sjelljes së gjyqtarëve;

- Transparenca për penalizuese kodet etike, udhëzimet, si dhe aktivitetet e lidhura me proceset disiplinore ndaj gjyqtarëve, informim dhe akses i publikut dhe i medias.

### **2.1.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes për këtë tregues përfshin:

*Treguesit objektivë* lidhen me analizimin e legjislacionit parësor dhe dytësor dhe përputhshmërinë me standardet më të mira ndërkombëtare. Statistikat e prodhura nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë dhe KLGj (Komisioni Disiplinor), mund të nxjerrin konkluzione dhe përfundime mbi standardet e llogaridhënies dhe regjimit disiplinor. Po ashtu anketime me ekspertë dhe profesionistë të specializuar që njohin sistemin gjyqësor, lidhur me përthithjen e opinionit të tyre mbi llogaridhënien e gjyqësorit dhe të gjyqtarëve.

*Treguesit subjektivë* kërkojnë ekzistencën e sondazheve për përthithje opinionit mes grupeve të ndryshme në shoqëri mbi krijimin dhe funksionimin e kulturës së llogaridhënies nga gjyqtarët dhe gjyqësori.

## **Faktori 2.2 Parimet deontologjike që udhëheqin sjelljen gjyqësore të gjyqtarëve**

### **2.2.1 Standardet e performancës**

Etika e gjyqtarit, shkon përtej rregullave ligjore. Megjithatë, ka një unanimitet mbi thelbin e parimeve bazë të profesionit të gjyqtarit, pavarësisht diferencave, mbi të cilat ai duhet të veprojë: pavarësia, paanësia, integriteti, përshtatshmëria, barazia, kompetenca dhe kujdesi i duhur.<sup>64</sup> Pavarësisht se nuk ka norma morale dhe etike të kodifikuara dhe universale për gjyqtarët, ka një proces të vazhdueshëm globalisht që: afirmon të drejtën ndërkombëtare, sidomos mbi të drejtat e njeriut; harmonizon praktikën gjyqësore sidomos mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin; bën përpjekje për unifikim të edukimit ligjor të gjyqtarëve mbi zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare. Me rritjen e rëndësisë së rolit të gjyqtarit në shoqëri, po rritet edhe nevoja për kodifikim të deontologjisë së këtij profesioni.<sup>65</sup>

64. Profesionit të gjyqtarit, Rrjeti i Lisbonës, Këshilli i Europës.

[https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetwork/themis/Ethics/Paper2\\_en.asp](https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetwork/themis/Ethics/Paper2_en.asp)

65. Parimet Bangalore të sjelljes gjyqësore [*The Bangalore Principles of judicial conduct*], të konfirmuara përmes Rezolutës 2006/23, vendosin standarde etike të sjelljes gjyqësore dhe përpunojnë parimet e pavarësisë, paanshmërisë, dinjitetit, barazisë, kompetencës dhe rregullsisë së gjyqtarëve.

## **2.2.2 Treguesit e realizimit**

Treguesit e zbatimit të parimeve deontologjike janë:

- ekzistenca e Kodit të Etikës Gjyqësore;
- mundësia e trajnimit mbi etikën gjyqësore;
- ekzistenca e një organi përgjegjës për dhënien e këshillave mbi çështje dilematike mbi etikën gjyqësore dhe trajtimi i çështjeve me këtë objekt;<sup>66</sup>
- monitorimi i sjelljes gjyqësore në praktikë;
- raportimi mbi sjelljen gjyqësore të gjyqtarëve.

## **2.2.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes është ajo krahasimore mes normave etike të Kodit të Etikës Gjyqësore me standardet e kërkuara ndërkombëtare, sidomos parimet e Bangalores “Mbi sjelljen Gjyqësore”, 2012. Gjithashtu, shqyrtimi i ankesave dhe i kërkesave të shqyrtuara për shkelje të etikës gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

## **Faktori 2.3 Parashikueshmëria e vendimeve gjyqësore, siguria juridike dhe standardet e të gjykuarit**

### **2.3.1 Standardet e performancës**

Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës.<sup>67</sup> Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve publike, përfshirë vendimet gjyqësore, që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se arsyetimi nga ana e gjykatave, ka rëndësi edhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin. Siguria juridike nënkupton, që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim<sup>68</sup>.

GjEDNj ka vlerësuar se: *“... kundërshtit brenda të njëjtit vendim të Gjykatës së Lartë janë të papajtueshme me funksionin e saj gjyqësor. Roli i një Gjykate të Lartë në një Palë Kontraktuese është pikërisht të zgjidhë konfliktet, të shmangë divergjencat dhe të jetë e njëtrajtshme”*.{Në të vërtetë,

66. Neni 4 i Ligjit nr.96/2016 parashikon se: “3. Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. 4. Secili Këshill emëron magjistratin si këshilltarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

67. Omari L., Anastasi A., *E Drejta Kushtetuese*, Shtëpia Botuese “Dajti 2000”, 2017.

68. Vendimi nr.23/2007 i Gjykatës Kushtetuese. Shih në: [https://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php)

në çështjen aktuale, vetë Gjykata e Lartë është bërë burim i pasigurisë duke cenuar besimin publik në sistemin e drejtësisë dhe shtetin ligjor. Gjykata vëren që shtetet kontraktuese janë të detyruara të organizojnë sistemin e tyre ligjor në mënyrë që të lejojnë gjykatat të identifikojnë procedurat gjyqësore dhe, kur është e nevojshme, të shmangin miratimin e vendimeve të papajtueshme. Ajo vlerëson që problemi themelor në çështjen aktuale ka rezultuar nga shumëfishtësia e procedurave gjyqësore, të cilat duhet të ishin menaxhuar më mirë për të kontribuar në sqarimin e shpejtë të çështjes në fjalë. Për gjykatën, ekzistenca e procedurave gjyqësore paralele të shumta dhe të ndërlidhura, duke shtruar në thelb të njëjtën çështje ligjore nuk mund të konsiderohet në përputhje me shtetin e së drejtës. Autoritetet shqiptare, duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në disa nivele të juridiksionit të tyre kanë demonstruar mangësi në sistemin gjyqësor, fakt për të cilin ato janë përgjegjëse. Për më tepër, mënyra në të cilën autoritetet e tjera vendase kanë proceduar nuk ka qenë aspak në përputhje me detyrimin e Palës Shqiptare për të trajtuar situatën e ankuesve në mënyrën më të qartë dhe koherente të mundshme dhe me qëndrueshmëri të plotë”<sup>69</sup>.

Nga perspektiva e “court users”, cilësia e një vendimi gjyqësor nuk duhet parë *stricto sensu*, si cilësi juridike apo cilësi e arsytimit të vendimit, por edhe nga kohëzgjatja (eficenca), transparenca dhe mënyra e drejtimit të procedurave, komunikimi me palët, dhe cili është impakti i vendimit gjyqësor në shoqëri.

### **2.3.2 Treguesit e realizimit**

Aspekti i arsytimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet, duke u bazuar në tregues të tillë si, qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik<sup>70</sup>.

Ndërmjet efencës dhe drejtësisë mund të ketë një tension, por cilësia e vendimit gjyqësor nënkupton që gjyqtari duhet të arrijë në një rezultat korrekt, për aq sa e lejon materiali që i është vënë në dispozicion gjyqtarit, dhe korrektesa e vendimit përfundimtar nuk duhet sakrifikuar ose cenuar për shkak të efencës. Kriteret e vlerësimit të cilësisë së vendimeve gjyqësore do të jenë:<sup>71</sup>

- Sa të hapura dhe transparente, dhe në përputhje me parimet kryesore proceduriale (kontradiktoritetin, barazinë e armëve, të drejtat e mbrojtjes), ka qenë dëgjimi dhe vlerësimi që i ka bërë gjykata pretendimeve të palëve?
- Sa e kuptueshme, e qartë dhe e thjeshtë ka qenë gjuha, me të cilën është shkruar vendimi?
- Sa i pajtueshëm është vendimi me jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, dhe standardet dhe kriteret e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut?
- Sa merr në konsideratë vendimi gjyqësor, përveç koncepteve ligjore, edhe ato realitete të jashtme jo-ligjore, si p.sh konsideratat etike, ekonomike dhe shoqërore?

69. Vendimi i GjEDNj, *Mullahi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*.

70. Neni 72/3 i ligjit nr. 96/2016.

71. Opinioni nr.11/2008 i CCJE.

### **2.3.3 Metodatat e matjes**

Metodat e matjes përfshijnë:

- Kontrolli gjyqësor i vendimmarrjes brenda vetë sistemit kombëtar të së drejtës. Analiza e vendimmarrjeve gjyqësore nga gjykata më e lartë për më të ultën, sipas pretendimeve procedurale të palëve.
- Nxjerrja e vendimeve njehsuese të Gjykatës së Lartë, është tregues i interpretimit ligjor nga gjykatat/gjyqtarët në mënyrë të qartë dhe të parashikueshme.
- Të dhëna dhe statistika mbi shfuqizimin e vendimeve, nga gjykatat më të larta për ato më të ultat, mbi këtë standard performance, pra parashikueshmëria e vendimeve gjyqësore dhe siguria juridike. Mbikëqyrje dhe analiza mbi vendimet njehsuese të Gjykatës së Lartë dhe roli i tyre në kuadër të sigurisë juridike.
- Sondazhe dhe anketime me opinion publik, mbi vendimmarrjen gjyqësore dhe perceptimin publik, domethënë me pranimin e tyre si të drejta nga opinioni publik dhe shoqëria, e lidhur me besueshmërinë, ose legjitimitetin e vendimeve gjyqësore.<sup>72</sup>

Për metodatat e matjes për këtë faktor, shih edhe faktorin 3.4.

## **Faktori 2.4 Përgjegjësia ligjore (penale dhe civile) e gjyqtarëve**

### **2.4.1 Standardet e performancës**

“Përgjegjësia Disiplinore, Penale dhe Civile” përbëhet nga gjashtë kapituj dhe pesë prej tyre rregullojnë hetimin disiplinor, procedimin disiplinor, pezullimin e magjistratëve gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor, ekzekutimin dhe regjistrimin e masave disiplinore, parashikuar në ligjin nr.96/2016, Për statusin e Magjistratit<sup>73</sup>.

Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë:

- a) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë;
- b) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale nga pakujdesia;
- c) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat “a dhe “b”, më lart, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë;

72. Shih për anketimet orientimet e: [https://rm.coe.int/komisioni-evropian-per-efikasitetin-e-drejtises-cepej-matja-e-cilesis/16807477ca#\\_Toc473457927](https://rm.coe.int/komisioni-evropian-per-efikasitetin-e-drejtises-cepej-matja-e-cilesis/16807477ca#_Toc473457927)

73. Pjesa V e ligjit nr. 96/2016.



- ç) faktet e pranuar nga organi kompetent me vendim të formës së prerë, që për nga vetë natyra e tyre është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magistrati dhe organet e drejtësisë, të cilat përbëjnë vepër penale, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, është rehabilituar apo ka përfituar nga falja dhe amnistia.<sup>74</sup>

#### **2.4.2 Treguesit e realizimit**

Treguesit e realizimit janë të njëjtë si te regjimi disiplinor, 2.1.2.

#### **2.4.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes është njësoj si te regjimi disiplinor, 2.1.3.

### **Faktori 2.5 Integriteti në vendimmarrje dhe ndershmëria e drejtimit të procedurave**

#### **2.5.1 Standardet e performancës**

Integriteti i gjyqtarit është elementi më thelbësor i integritetit të gjyqësorit si një pushtet i vetëm<sup>75</sup>. Integriteti bëhet i matshëm përmes angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit, që janë sjellja gjyqësore e përshtatshme, kujdesi i duhur ndaj çështjes, respektimi i të drejtave procedurale të palëve, sensi i drejtësisë në vendimmarrje, si dhe paanësia.<sup>76</sup>

Profesioni i gjyqtarit kërkon standarde të larta gjykimi, konsequencë në qëndrime dhe çështje të njëjta, dhe menaxhimi të procesit gjyqësor, në mënyrë që palëve t'u rritet besimi te drejtësia.<sup>77</sup>

Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për miratimin e standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre. Në veçanti Këshilli:

- a) bën publike standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së gjyqtarëve;
- b) rishikon herë pas here rregullat dhe, kur është e nevojshme, i ndryshon ato;
- c) analizon shkallën e zbatimit/respektimit të rregullave të etikës dhe raporton publikisht për gjetjet.<sup>78</sup>

74. Neni 104 i ligjit nr. 96/2016.

75. ENCJ, Raporti “Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore V 2014-2015 miratuar në Hagë më 5 qershor Report” [Development of minimum judicial standards], V 2014-2015, Hagë 5 qershor 2015, fq.16.

76. CCJE, Opinioni nr. 3 në vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Parimet që Drejtojnë Sjelljen Profesionale të Gjyqtarëve, në veçanti Etika, Sjellja e Papajtueshme dhe Paanshmëria 2002 dhe Deklarata ENCJ Londër mbi Etikën Gjyqësore [Opinion no. 3 to the Attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Principles Governing Judges' Professional Conduct, in particular Ethics, Incompatible Behaviour and Impartiality 2002 and ENCJ London Declaration on Judicial Ethics].

77. Profesionit gjyqtarit, Rrjeti i Lisbonës, Këshilli i Europës, [https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetwork/themis/Ethics/Paper2\\_en.asp](https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetwork/themis/Ethics/Paper2_en.asp)

78. Neni 83 i ligjit nr.115/2016



Kryetari i Gjykatës mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, si dhe mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre<sup>79</sup>.

### **2.5.2 Treguesit e realizimit**

Njësoj si te treguesit e realizimit më lart, në 2.2.2., faktori 2.2. Integriteti në vendimmarrje dhe ndershmëria në drejtimin e procedurave duhet të orientohet nga:

- Sa e përshtatshme është sjellja gjyqësore e gjyqtarit ndaj palëve? Si kanë qenë veprimet e tij?
- Sa garantues dhe i baraslarguar ka qenë ai në proces?
- Sa etik ka qenë në gjuhën e përdorur gjatë procesit në komunikim?
- Sa bindje u krijon palëve në proces se ka qenë i parapërgatitur për çështjen dhe i fokusuar në thelbin e konfliktit mes palëve?
- Sa i pranueshëm është thelbi i vendimmarrjes?
- A ka pasur ankim për sjelljen e gjyqtarit dhe pretendime gjatë procesit për sjelljen e tij gjyqësore?
- A përbën fenomen sjellja jo e duhur gjyqësore? Sa ankesa ka në këtë drejtim?
- Çfarë trendi tregojnë anketimet për sjelljen e gjyqtarëve në tërësi?
- Po statistikat lidhur me ankimet ndaj tyre për sjellje të pandershme?

### **2.5.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes përfshin:

- Etika në punë e gjyqtarit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si; rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.
- Integriteti i gjyqtarit, në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë si; rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.
- Paanësia e gjyqtarit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi<sup>80</sup>.

79. Neni 39 i ligjit nr.98/2016

80. Neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

- Të dhënat dhe statistikat mbi ankesat ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit, mbi masat disiplinore ndaj tij, mendimet të kryetarit të gjykatës, etj.
- Referimi në studime, gjetje dhe raportime të ndryshme nga organizmat ndërkombëtarë, kombëtarë dhe media.
- Sondazhe dhe përthithje mendimesh, edhe mbi baza perceptimi nga grupe të ndryshme interesi, ose opinioni publik i gjerë.
- Anketime edhe nga vetë gjyqtarët mbi vlerësimin e integritetit gjyqësor<sup>81</sup>.

---

81. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të integritetit gjyqësor [*Judicial Integrity Self-Assessment Checklist*], zhvilluar nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, UNDP, 2018, fq. 5-10. Shih: <http://www.summitofhighcourts2018.com/docs/presentations/JUDICIAL%20INTEGRITY%20SELF-ASSESSMENT%20CHECKLIST.pdf>

## Pjesa 5

### TRANSPARENCA DHE PJESËMARRJA AKTIVE

#### **Pse duhet vlerësuar/matur:**

Transparenca administrative është:

- 1) çështje politike;
- 2) çështje ligjore.

Si çështje ligjore ajo i referohet “të drejtës të palëve dhe të publikut në përgjithësi për të njohur/ditur”, çfarë ndodh brenda procedurave gjyqësore, por edhe se si administrohet pushteti gjyqësor, se si ushtrohet pushteti gjyqësor, si një nga tri pushtetet publike kushtetuese.<sup>82</sup>

E drejta “për të njohur” dhe “pjesëmarrja efektive”, si standard kombëtar dhe ndërkombëtar u shërben tri qëllimeve:

- u mundëson qytetarëve të marrin pjesë dhe të mbikëqyrin procesin e vendimarrjes gjyqësore dhe administrimit të gjykatave, si një nga pushtetet publike kushtetuese;
- rrit efencën në dhënien e drejtësisë dhe forcon kontrollin e qytetarëve mbi pushtetin gjyqësor, duke i kontribuar administrimit të ndershëm të drejtësisë nga gjykatat, duke parandaluar korrupsionin dhe të tjera forma të keqadministrimit të drejtësisë nga pushteti gjyqësor;
- rrit transparencën dhe llogaridhënien e gjyqësorit, pra i kontribuon rritjes së besimit të publikut (legjitimitetit), të pushtetit gjyqësor.

#### **Faktori 3.1 Aksesi në një drejtësi cilësore, komunikimi me përdoruesit e gjykatave dhe publikun**

##### ***3.1.1 Standardet e performancës***

Standardet kushtetuese<sup>83</sup> dhe ligjore të aksesit të informacionit gjyqësor dhe administrativ<sup>84</sup>, praktikat kombëtare shqiptare institucionale dhe standardet ndërkombëtare të deklaruara,<sup>85</sup>

---

82. Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesimin e dokumentave zyrtare, 18/06/2009.

83. Neni 23, 1 dhe 2 të Kushtetutës.

84. Neni 339/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 26 i Kodit të Procedurës Civile; Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

85. Janë afirmuar nga Gjykatat, Kushtetuta, Traktatet ndërkombëtare (neni 10 i KEDNJ, neni 11 i Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore të BE-së, etj).

kërkojnë akses efektiv të palëve të interesuara, por edhe të publikut në informacion.

Garantimi i aksesit, kërkon të drejtën për të aksesuar dokumentacionin gjyqësor<sup>86</sup>, dhe të drejtën për të aksesuar (për të parë dhe marrë një kopje), të çdo lloj informacioni, rekordi, regjistri gjyqësor, përfshi edhe atë jodokumentar dhe që e tejkalon thjesht një “dosje gjyqësore”. Për aq sa është e mundur, gjykatat duhet t’i ofrojnë shërbimet e tyre ndaj palëve ndërgjyqëse, përmes përdorimit të teknologjive të reja.<sup>87</sup> Gjykatat duhet të intensifikojnë përdorimin e rrugëve elektronike të komunikimit me publikun.<sup>88</sup>

Çdo person duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim nga gjykatat. Çdo person ka akses të barabartë në gjykatë, si dhe ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij ligjore. Gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase<sup>89</sup>.

Ligji nr. 115/2016 ka parashikuar që Këshilli të caktojë një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, ashtu si dhe të caktojë të paktën një gjyqtar për mediet për çdo juridiksion apeli. Në ato raste kur komunikimi me publikun nuk mund të kryhet prej tij, shërbimi kryhet nga shërbimi i shtypit i Këshillit.

### **3.1.2 Treguesit e realizimit**

Mënyra e zbatimit të këtyre standardeve në nivel stafi administrativ të gjykatave dhe në nivel institucional nga gjykata.

Treguesit objektivë të transparencës së gjyqësorit:

- ekzistenca e mekanizmave transparentë për menaxhimin e çështjeve; përmbajtja e mekanizmave për menaxhimin e çështjeve;
- procedura e ankimit me mundësinë e pjesëmarrjes nga jashtë në këtë procedurë;
- qëllimi i procedurës së ankimit;
- apelimi i vendimit pas ankimit;
- numri i ankimeve.
- Raporte periodike të gjyqësorit me këta nëntregues:
  - o raporte vjetore;
  - o publikim i raporteve vjetore;
  - o qëllimi i raporteve vjetore;

---

86. Rregullorja nr.1049/ 30 maj 2001 e (KE) “Mbi aksesin e publikut në dokumentacionin e Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit Evropian”.

87. Rekomandimi No. R (2001) 3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi ofrimin e shërbimeve gjyqësore dhe të shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja.

88. Rekomandimi No. R (2001) 3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi ofrimin e shërbimeve gjyqësore dhe të shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja.

89. Neni 5 i ligjit nr. 98/2016.

- marrëdhënie me mediet me këta nëntregues:
  - o shpjegime të vendimeve gjyqësore në medie;
  - o udhëzime të disponueshme mbi marrëdhëniet me medien;
  - o raportim i çështjeve nga mediet;
  - o caktimi i gjyqtarit për medien pranë çdo gjykate apeli.

### **3.1.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes së standardit të transparencës përfshin:

- vlerësimin e kuadrit juridik shqiptar mbi transparencën;
- monitorimin e praktikës administrativo-gjyqësore shqiptare lidhur me aksesin në informacion dhe dokumentacion në krahasim me standardet e kërkuara ligjore;
- monitorime dhe matje sipas metodologjive të njohshme dhe të eksploruara tashmë, përmes një sërë indikatorësh, nga subjekte të ndryshme të shoqërisë civile, por edhe medie, dhe prodhim i analizave në drejtim të realizimit të këtij standardi;
- marrëveshje bashkëpunimi me institucionin e pavarur administrativ të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe krijim metodologjie shkencore për matjen e aksesit në informacion sipas standardeve të brendshme dhe ndërkombëtare.

## **Faktori 3.2 Aksesit i publikut dhe shtypit/medieve në procedurën gjyqësore dhe në sallat/ambientet gjyqësore**

### **3.2.1 Standardet e performancës**

Aksesi në drejtësi,<sup>90</sup> fillon me aksueshmërinë fillestare të gjykatave dhe orientimin e court-users (qytetarëve dhe bizneseve). Vendosja e kontaktit me gjykatat (go to court), është element i një sistemi drejtësie cilësore, dhe zë fill me disponueshmërinë dhe aksesimin e informacionit në fazën fillestare (duke inkurajuar përdorimin e IT (e-justice), në mënyrë që *nformacioni procedural të jetë i plotë, i saktë, dhe i përditësuar, duke përdorur IT*<sup>91</sup>, si një aspekt themelor i garantimit të respektimit të nenit 6 të KEDNJ.<sup>92</sup> Seanca gjyqësore është publike, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe<sup>93</sup>.

### **3.2.2 Treguesit e realizimit**

Efektiviteti dhe praktikiteti i ushtrimit të së drejtës për fillimin e procedurave gjyqësore do të ishte tregues i realizimit të këtij standardi. Lehtësia e përdoruesve të gjykatave dhe

90. Qasja në drejtësi “Gjykatat” [Access to Justice “The Courts”] UNODC.

91. Neni 47 “Shërbimi i teknologjisë së informacionit” i ligjit nr. 96/2016.

92. Opinioni nr.14, (2011) të CCJE.

93. Neni 5/3 i ligjit nr. 98/2016.

garancitë dhe ndihmesa e shtetit për aksesin në një drejtësi cilësore. Treguesit e realizimit, do të duhej të fokusoheshin në pyetje, si:

- A është i detyruar të shkojë në gjykatë individi i interesuar, apo ka ndonjë alternativë tjetër?
- A mund ta ndjekë rastin vetë, apo patjetër duhet një përfaqësues ligjor?
- A mund të marrë ndihmë ligjore falas, ai/ajo që e ka të nevojshme?
- Kur dhe si duhet t'i paguajë shpenzimet gjyqësore, dhe sa janë ato të vlerësuara paraprakisht?
- A ka formularë standardë (user-friendly) dhe udhëzime për hartimin dhe depozitimin e padisë, kundërpadisë, ankimin, rekursin etj, dhe ku duhet të paraqitet kërkuesi për t'i dorëzuar ato?
- A ka programe që i drejtohen publikut të gjerë (outreach) për ta edukuar për vendosjen e marrëdhënieve me gjykatën dhe rolin e tyre?
- A ka një kuadër politikash apo rregullator të verifikueshëm dhe që mbikëqyrret, në lidhje me sa më sipër?

### **3.2.3 Metoda e matjes**

Metodat e matjes është njësoj si tek 3.1.3.

## **Faktori 3.3 Aksesin në vendimet gjyqësore (arkivat, data-base) dhe informacione të tjera të lidhura me gjykatën**

### **3.3.1 Standardet e performancës**

Gjykatat duhet të krijojnë arkiva elektronike, që do të mundësojnë mbajtjen dhe përdorimin e dokumentacionit elektronik.<sup>94</sup> Aksesin në vendimet gjyqësore (shërbimi i arkivit gjyqësor<sup>95</sup>) dhe informacione të tjera të lidhura me gjykatën duhet të jetë substancial, efektiv dhe sipas mjeteve më të përshtatshme për kërkuesin. Qendra e dokumentacionit pranë Gjykatës së Lartë, siguron transparencën dhe aksesin on-line të vendimeve të kësaj gjykate<sup>96</sup>. Të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë të regjistruara dhe të publikuara, ndërkohë që duhet të jetë i inkurajuar publikimi në database elektronik.

---

94. Rekomandimi nr. R (2003) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi arkivimin e dokumenteve elektronike në sektorin e drejtësisë”.

95. Neni 48 i Ligjit nr.96/2016

96. Neni 35 i Ligjit nr.98/2016, sipas të cilit: 1.Qendra e dokumentacionit bën: a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale; b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë; c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave. 2. Qendra e dokumentacionit punon nën mbikëqyrjen e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

### 3.3.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit do të duhej të fokusoheshin në pyetje, si:

- A janë ligjërisht të gjitha dokumentet e një “dosjeje gjyqësore” të prezumuara si të aksesueshme nga publiku, me disa përjashtime të vogla dhe ngushtësisht të përkufizuara?
- A ekziston kërkesa/detyrimi ligjor për publikimin proaktiv të të gjitha vendimeve dhe opinioneve gjyqësore?
- A ekziston një “nëpunës civil” në gjykata, që u përgjigjet kërkesave nga publiku (“fishing for information”), për informacione, që nuk gjenden në database elektronike, dhe që ka detyrimin t’u përgjigjet atyre?

### 3.3.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes është njësoj si tek 3.1.3.

## Faktori 3.4 Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

### 3.4.1 Standardet e performancës

Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Gjykata e Lartë duhet t’i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës<sup>97</sup>. Gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat, që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.<sup>98</sup>

Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive.<sup>99</sup>

Qëllimi i një vendimi të arsyetuar **është** t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i

97. Neni 142 i Kushtetutës.

98. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 02.04.2008; nr.7, datë 09.03.2009; nr.23, datë 23.07.2009.

99. *Ibid.*

administrimit të drejtësisë<sup>100</sup>. Neni 6 i KEDNj-së detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për **çdo** argument.<sup>101</sup>

Aspekti i arsyetimit të vendimit gjyqësor vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë, si:

- qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit,
- struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit,
- cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.<sup>102</sup>

Një vendim gjyqësor që ka të qartë vetëm dispozitivin është një vendim, që jep vetëm qartësi dhe siguri juridike, vendimi duhet të demonstrojë se:

- a) gjyqtari ka “kuptuar dhe pasqyruar siç duhet rastin e veçantë para tij”,
- b) gjyqtari “ka bërë drejtësi ndërmjet palëve”, duke parandaluar konflikte të tjera, dhe kontribuar në harmoninë sociale.

### **3.4.2 Treguesit e realizimit**

Analiza e vendimmarrjeve gjyqësore nga gjykata më e lartë për më të ultën, sipas pretendimeve procedurale të palëve, është tregues i realizimit të këtij standardi, i cili do të duhej të fokusohet në këto pyetje:

- A është arsyetimi i qartë dhe i kuptueshëm<sup>103</sup>, dhe i plotë në lidhje me bazën ligjore, dhe analitik në lidhje me faktet dhe provat që e justifikojnë atë?
- A u është përgjigjur gjyqtari në arsyetimin e vendimit të gjitha pretendimeve të palëve, dhe a i ka specifikuar, duke i arsyetuar të gjitha pikat, që e justifikojnë marrjen e vendimit gjyqësor, dhe e bëjnë atë të ligjshëm?
- A reflekton vendimi përputhshmëri me parimet e jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, dhe GjEDNj-së?
- Sa ankesa dhe rekurse ka bazuar mbi cenimin e këtij standardi nga palët e interesuara?
- Sa shpesh vendimi gjyqësor i gjyqtarëve konkrete bëhet i ceneshëm nga gjykatat më të larta, pikërisht për mosplotësim të standardit të arsyetimit?

### **3.4.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes është njësoj si tek 2.3.3 më lart. Ajo përfshin:

- Të dhëna dhe statistika mbi shfuqizimin e vendimeve, nga gjykatat më të larta për ato më të ultat, mbi këtë standard performance, pra arsyetimi i vendimeve gjyqësore.
- Hulumtim dhe analizë statistikore e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës

100. Vendimi i GjEDNj-së në **çështjen** *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtator 2001, prg. 30.

101. Vendimi i GjEDNj-së në **çështjen** *Van de Hurk kundër Holandës*, 19 prill 1994, prg. 61.

102. Neni 72/3 i ligjit nr. 96/2016.

103. Opinioni nr. 7/2005 i CCJE.



Kushtetuese në drejtim të standardit të arsytimit gjyqësor.

- Kontrolli gjyqësor i vendimmarrjes brenda vetë sistemit kombëtar të së drejtës mbi këtë element është standard i realizimit, por edhe i matjes së nivelit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

### **Faktori 3.5 Gjenerimi i informacioneve dhe zgjidhja efektive e problemeve të pjesëmarrjes, për palët, publikun dhe shtypin**

Gjatë njëzet viteve të fundit teknologjia ka luajtur rol gjithnjë e në rritje në shoqërinë tonë e për rrjedhojë edhe në gjykata dhe në sistemin e drejtësisë. Praktika e gjykatave dhe puna e bazuar në letra, tekste ligjore, dosje të çështjeve, regjistra të gjykatave etj., po kërkohet gjithmonë e më shumë të përshtatet me teknologjitë e reja. Ndër të tjera transformimi digjital, teknologjia e informacionit dhe menaxhimi i të dhënave kanë qenë në agjendën e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës gjatë viteve të fundit. Kështu që më 2018 Bashkimi Evropian ka miratuar një sërë rregulloresh që u përgjigjen transformimeve digjitale e për rrjedhojë prekin dhe gjyqësorin. Kështu, u miratua Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)<sup>104</sup>. Më pas, Direktiva për Zbatimin e Ligjit<sup>105</sup>, Rregullorja për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e BE-së dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave<sup>106</sup>, dhe Vendimi Zbatues i Komisionit për përshtatshmërinë e mbrojtjen e ofruar nga BE-SHBA, Mburoja e Privatësisë<sup>107</sup>. Më tej, Komisioni Evropian hartoi Strategjinë “Inteligjenca Artificiale për Evropën” dhe miratoi Planin e Koordinuar për Inteligjencën Artificiale. Me objektivin për të mbështetur zbatimin e Strategjisë “Inteligjenca Artificiale për Evropën”, Komisioni nxori dokumentin e Udhëzimeve të Etikës për Inteligjencën e Besueshme Artificiale, i cili diskuton parimet etike dhe vlerat e ndërlidhura që duhet të respektohen në zhvillimin, vendosjen dhe përdorimin e sistemeve artificiale të inteligjencës. Po ashtu edhe Komisioni Evropian për Eficencën e Drejtësisë i Këshillit të Evropës (CEPEJ) miratoi Kartën Etike Evropiane për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Sistemet Gjyqësore dhe mjedisin e tyre.<sup>108</sup> Përdorimi i teknologjisë së informacionit konsiderohet si një element kyç për të përmirësuar në mënyrë të ndjeshme administrimin e drejtësisë. Vendet evropiane po synojnë të përmirësojnë mënyrat për të përdorur shërbimet e teknologjisë, si dhe për të përmirësuar

104. Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 [2019], OJ L 119/1.

105. Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 Prill 2016 [2016], OJ L 119/89.

106. Rregullorja (BE) 2018/1725 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2018 [2018], OJ L 295/39 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat e Bashkimit dhe agjencive dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla [*Regulation (EU) 2018/1725 of the European Parliament and of the Council of 23 October 2018 [2018], OJ L 295/39 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data by the Union institutions, bodies, offices and agencies and on the free movement of such data*].

107. Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2016/1250 i datës 12 korrik 2016 në përputhje me Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi përshtatshmërinë e mbrojtjes së ofruar nga BE-SHBA. Mburoja e privatësisë [*Commission Implementing Decision (EU) 2016/1250 of 12 July 2016 pursuant to Directive 95/46/EC of the European Parliament and of the Council on the adequacy of the protection provided by the EU-U.S. Privacy Shield*].

108. CEPEJ, Karta Etike Evropiane për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Sistemet Gjyqësore dhe mjedisin e tyre” [European Ethical Charter on the Use of Artificial Intelligence in Judicial Systems and their environment], miratuar në mbledhjen e 31-të plenare të CEPEJ, Strasburg, 3-4 dhjetor 2018.

legjislacionin që t'i përgjigjen inovacionit të teknologjisë. Teknologjia e informacionit mund të përdoret për të rritur eficientë, aksesin, për të shkurtuar afatet, për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke u bërë të mundur gjykatave të japin një shërbim më të mirë. Ndër të tjera përdorimi i teknologjisë së informacionit u ofron mundësinë gjykatave që të jenë më të hapura ndaj publikut duke dhënë informacion të përgjithshëm dhe specifik mbi punën e tyre dhe duke i bërë më të aksesueshme për qytetarët.

Modernizimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit është gjithashtu në përputhje me Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.<sup>109</sup>

Përdorimi i teknologjisë së informacionit është një mënyrë efektive për rritjen e eficientës të gjyqësorit<sup>110</sup>; Gjyqësori duhet të përdorë një sistem elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore që bën të mundur shqyrtimin e efektshëm të çështjeve.<sup>111</sup> Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve duhet të mundësojë edhe funksione të tilla si prodhimi i statistikave gjyqësore, kalendari i gjykimeve dhe shpërndarja e çështjeve<sup>112</sup>; Komunikimi i përdoruesve të sistemit gjyqësor me gjykatat dhe institucione të tjera të sistemit të drejtësisë duhet të zhvillohet sa më shumë përmes mjeteve elektronike të komunikimit<sup>113</sup>.

Këshilli i Ministrave vendosi që Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë të ngrihet dhe të funksionojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>114</sup>. KLGj-ja duhet të sigurojë ambientet e përshtatshme të punës për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit, si dhe të kryejë funksione mbështetëse horizontale administrative, financiare dhe logjistike. Gjatë vitit 2021, në kuadër të përpjekjeve për fuqizimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit u krijua Qendra e Teknologjisë së Informacionit. Qendra e Teknologjisë së Informacionit do të shërbejë si institucion rregullator dhe koordinues i teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë dhe ushtron funksionet e saj nëpërmjet dy organeve kryesore, Bordi Drejtues (organ kolegjal vendimmarrës) dhe Drejtori Ekzekutiv (organ administrativ). Qendra e Teknologjisë së Informacionit gëzon mbështetjen horizontale administrative e financiare nga KLGj-ja.

---

109. Rekomandimi CM/Rec (2010)12, nr. 44 “Sistemet gjyqësore dhe administrata gjyqësore duhet të modernizohen vazhdimisht. Teknologjitë moderne si sistemet elektronike të menaxhimit të çështjeve dhe teknologjitë e tjera të informacionit dhe komunikimit duhet të jenë të disponueshme. Teknologjitë moderne janë të rëndësishme për të mbështetur gjyqtarët në punën e tyre, por kurrë nuk duhet të zëvendësojnë vendimmarrjen e gjyqtarëve. Është thelbësore që i gjithë automatizimi i zyrës dhe përpunimi i të dhënave të jenë në dispozicion të gjyqtarëve, të cilët vetë kanë rol të rëndësishëm në promovimin e përdorimit të teknologjive të reja dhe moderne. Masat mbrojtëse që synojnë mbrojtjen e të dhënave personale (në përpunim, ruajtjen ose profilizimin) duhet të respektohen kur përdoren teknologji të tilla”.

110. Rekomandimi Nr. R (84) 5 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet e procedurës civile që përmirësojnë funksionimin e drejtësisë.

111. Indeksi i Reformës në Drejtësi – ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit [*Judicial Reform Index – ABA Rule of Law Initiative*] – Faktori 28.

112. Rekomandimi Nr. R (2001) 2 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi konceptimin dhe rikonceptimin e sistemeve gjyqësore dhe të informacionit ligjor.

113. Rekomandimi Nr. (2001) 3 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi lëvrimin e shërbimeve të gjykatave dhe shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja.

114. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 2.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.

### 3.5.1 Standardet e performancës

Garantimi i transparencës dhe aksesit në informacion gjyqësor si dhe informacion administrativ të prodhuara nga gjykatat. Garantimi i aksesit fizik në sallat e gjykatës për përdoruesit, duke përfshirë edhe ata me problematika të aftësisë së kufizuar fizike. Efektiviteti i zgjidhjes së kërkesave të palëve dhe publikut.

Standardet ligjore kërkojnë që **shërbimet për marrëdhëniet me publikun** të kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Qëllimi është që:

- a) t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;
- b) t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;
- c) të mbahen kontakte me medien për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik;
- ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit", në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore;
- d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin<sup>115</sup>.

Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit mbështet veprimtarinë e KLGj-së, në zbatim të kompetencave të saj, përmes dy drejtorive<sup>116</sup>.

Drejtoria e IT dhe Administrimit të **Çështjeve** ushtron kompetencat mbi:

- zhvillimin ose pjesëmarrjen në zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në gjykata;
- menaxhimin, koordinimin, monitorimin dhe mbikqyrjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në gjykata;
- përcaktimin e sistemit të zbatueshëm të sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit të çështjeve dhe kujdeset që sistemi të përdoret në çdo gjykatë;
- përcaktimin e rregullave për funksionimin dhe sigurinë e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi;
- mirëmbajtjen e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit të çështjeve, në përputhje me rregullat e parashikuara;
- sigurimin e saktësisë dhe sigurisë së të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- garantimin që sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit të të dhënave gjeneron informacione statistikore, të cilat janë të nevojshme për punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të organeve të tjera dhe që përputhen me standardet evropiane për

115. Neni 46 i ligjit nr.98/2016.

116. Ngritja e kësaj njësie është bazuar në nenet 79, 84, 85, 86, 87, 88, 89 dhe 92 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe në ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

treguesit e punës së gjyqësorit, të tilla si: **norma e evadimit të çështjeve, numri i çështjeve për gjyqtar, kohëzgjatja mesatare e çështjeve dhe kohëzgjatja e çështjeve në proces në raport me kohëzgjatjen mesatare, etj;**

- përcaktimin e rregullave për përdorimin e detyrueshëm të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, njësimin e futjes së të dhënave dhe për saktësinë e të dhënave.
- përgatit rregulla më të hollësishme **për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short**, të cilat në veçanti përcaktojnë:
  - o a) programin për organizimin e shortit, me qëllim që të disponojë karaktere dhe parametra të mjaftueshme, të cilat sigurojnë standardet më të larta të transparencës dhe të kapaciteteve të gjurmimit;
  - o b) mënyrën transparente të dokumentimit të përgatitjes së shortit;
  - o c) afatet e organizimit të shortit dhe mënyrën e njoftimit paraprak të tij;
  - o ç;) kriteret për sigurimin e ndarjes së drejtë të çështjeve ndërmjet gjyqtarëve;
  - o d) rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara;
  - o dh) kriteret transparente dhe objektive për procedurën e përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti për shkak të ngarkesës ose për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor;
  - o e) kriteret transparente dhe objektive për ndarjen e çështjeve në rast mosfunksionimi të sistemit elektronik të çështjeve.

### **3.5.2 Treguesit e realizimit**

Efektiviteti dhe praktikiteti i mundësimit të pjesëmarrjes në procedura gjyqësore do të ishte tregues i realizimit të këtij standardi. Lehtësia e përdoruesve të gjykatave dhe aksesit fizik i sallave gjyqësore, do të ishin tregues realizimi të standardit të aksesit fizik të gjykatave nga të interesuarit. Tregues të realizimit të zgjidhjeve efektive të aksesit fizik dhe virtual të gjykatave:

- Shpejtësia për të gjeneruar një informacion të caktuar;
- Cilësia e informacionit, nëse është i saktë, i rregullt, i përdorshëm, etj;
- Në trajtimin e kërkesave të palëve dhe të publikut, a ka një përjasje “për të zgjidhur problemet”, apo ka pengesa dhe barriera të pajustificueshme administrative?
- Sa i përgjigjet Qendra e Teknologjisë së Informacionit standardeve për ruajtjen e rregullt të statistikave gjyqësore?
- Si matet roli i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit në koordinimin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë?
- Sa e përfshirë është KLGj-janë administrimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit?

### ***3.5.3 Metoda e matjes***

Metodat e matjes 3.1.3. dhe 3.2.3.

- Matje bazuar mbi monitorime, analiza, statistika dhe të dhëna të gjeneruara nga sistemi si dhe mbi sondazhe nga përdoruesit e shërbimeve të drejtësisë, sipas standardeve të CEPEJ.
- Analizë dhe ballafaqim të kërkesave ligjore me situatën faktike të operimit dhe menaxhimit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.

## Pjesa 6

### EFICENCA NË DHËNIEN E DREJTËSISË

#### **Pse duhet vlerësuar/matur**

Eficenca e gjyqësorit kuptohet gjerësisht si një nga komponentët e integritetit të gjyqësorit. Disa nga treguesit e UNODC për korrupsionin gjyqësor janë çështje/problematika të lidhura me eficientën e gjyqësorit si; p.sh. vonesat në ekzekutimin e urdhrave/vendimeve të gjykatës, lëshimi i pajustificuar i fletëthirrjeve për gjyq dhe i nxjerrjes në liri me kusht, ndryshueshmëria e dhënies së dënimeve e pajustificuar, mossjellja e të burgosurve/atyre nën masa sigurie para gjykatës, vonesat në dhënie dhe në zbardhjen e vendimeve, treguesit e lartë të dhënies së dënimeve me pafajësi, konfliktet e interesave, qëndrimi i zgjatur si gjyqtar në një gjykatë të caktuar ose një karrierë jomeritore, shoqëria e tepruar me disa anëtarë të caktuar të gjyqësorit, punësimi para dhe pas humbjes së statusit të magistratit.

Matja e këtij faktori synon të:

- 1) gjurmohet masën ose ngarkesën e çështjeve që rrjedhin/kalojnë përmes sistemit gjyqësor nga depozitimi i padisë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar, si dhe
- 2) të masë arsyeshmërinë/oportunitetin e kohës (pa vonesa të pajutifikueshme ose ngjeshje/backlogs të çështjeve), brenda të cilës merret drejtësia pa e cenuar cilësinë e vendimit gjyqësor, referuar edhe mjaftueshmërisë së burimeve, që ka në dispozicion gjyqësori për arritjen e këtij objekti. Pra, nëse eficienta do të matet sipas një *metode sasimore*, hetimi i natyrës së vendimit gjyqësor, pra efektiviteti ose cilësia e zbatimit të tij do të kryhet sipas një *metode cilësore*.

#### **Faktori 4.1 Efektiviteti i ushtrimit të së drejtës për fillimin e procedurave gjyqësore dhe kohëzgjatja deri në vendimmarrje**

##### ***4.1.1 Standardet e performancës***

Garantimi i eficientës së shërbimeve gjyqësore, me qëllim aksesin e individëve në gjykatë nga perspektiva e plotësimit të nevojave të shoqërisë për të gjetur zgjidhje të drejtë, të duhur, të shpejtë para gjykatës.<sup>117</sup> Shih dhe faktorin 3.5, më lart.

---

117. The UN Rule of Law Indicators: Implementation Guide and Project Tools, First Edition, 2011, pg.10

### 4.1.2 Treguesit e realizimit

Aksesimi i shpejtë i informacionit dhe i gjykatës dhe efektiviteti i ushtrimit të të drejtave (p.sh. koha dhe facilitetet, që i duhet të pandehurit për të shqyrtuar materialet dhe dëshmitë ku bazohet akuza, për të përgatitur mbrojtjen, në lidhje me të drejtën për të dalë sa më parë para gjykatës, për hartimin e padisë, për vlerësimin e kostove, etj).

Aftësinë e gjykatës për të mbajtur ritmin e shpejtësisë dhe cilësisë, ndërmjet numrit të çështjeve të depozituara me vendimet e zgjidhura me vendim përfundimtar.

Norma (ratio) e pastrimit (clearance rate) është treguesi, që shpreh ose mat raportin ndërmjet numrit të çështjeve të regjistruara me ato të zgjidhura. Për këtë qëllim do të maten:

- Numri i çështjeve që depozitohen në seksionet civile, penale, tregtare, gjykatat administrative, çështjet e falimentimit, konkurrencës, financiare, të drejtat e konsumatorit, të fëmijëve, etj. (gjykata e shkallës së parë/për çdo 100 banorë).
- Eficenca në procedurën gjyqësore, ose koha (timeline) që i duhet një gjykate (sipas hierarkisë dhe sipas kompetencës lëndore), për të arritur në vendimin përfundimtar.
- Cilësia në dhënien e drejtësisë, që në thelbin e saj nënkupton “cilësinë e vendimeve gjyqësore”.<sup>118</sup>

6 indikatorët e performancës së eficientës së gjykatave janë:

1. Ngarkesa për çdo gjyqtar;
2. Produktiviteti, që do të thotë produkti që del, pra numri i vendimeve të ndahet mes të gjithë punonjësve dhe orëve të punuara për to<sup>119</sup>;
3. Kohëzgjatja e proceseve;
4. Kosto për një çështje, pra sa më e vogël kostoja për një çështje, aq më efiçente është gjykata;
5. Përqindja e çështjeve të hequra, që llogaritet mbi numrin e atyre që hyjnë dhe atyre që dalin. Çështjet që mbeten dhe hiqen vitin pasardhës, janë ato të mbeturat dhe sa më i vogël numri i të mbeturave, aq më efiçente është gjykata.
6. Buxheti i gjykatës, pra sa është i mjaftueshëm për punën që bën me ato kapacitete njerëzore, financiare dhe infrastrukturore në dispozicion<sup>120</sup>.

### 4.1.3 Metoda e matjes

Ky tregues mat kohëzgjatjen e proceseve (*timeline*), sipas një metode sasiore, duke krahasuar treguesit e performancës së gjyqësorit shqiptar me ato të vendeve të rajonit dhe të BE-së, kritereve të jurisprudencës së GjEDNj-së, etj. Kohëzgjatja që merr apo duhet të marrë një çështje gjyqësore, duhet bazuar në statistika dhe analiza mbi statistikat. Duhet të ketë

118. CEPEJ, Grupi i Punës për cilësinë e drejtësisë [*Working Group on quality of justice*] (CEPEJ-GT-QUAL)

119. Specialistë të fushës, zotërojnë metodologjinë dhe parametrat e matjes së produktivitetit, pra sa prodhon intelektualisht dhe fizikisht çdo punonjës i gjykatës, duke pasur parasysh orët e punës. Duke përlllogaritur produktivitetin e çdo personi, llogaritet dhe produktiviteti i çdo strukture dhe të të gjithë gjykatës.

120. Standardet e SATURN, CEPEJ, Eficenca dhe efikasiteti në sistemin gjyqësor, Këshilli i Europës.



informacion të mjaftueshëm se sa zgjat një çështje e caktuar dhe se sa zgjasin specifikisht të gjitha fazat e procesit nga paraqitja e kërkesës deri në shpalljen e vendimit. Vetëm pasi realizohet ky proces, vendosen dhe standardet e brendshme për kohëzgjatjen e një çështjeje, ose standardet e një gjykate të caktuar për çështjen dhe monitorohet zbatimi i standardeve, pra dhe përgjegjësia specifike e personit sipas kompetencës/rolit përkatës në proces, doemthënë e sekretarisë, e gjyqtarit, e ndihmësit ligjor, e të gjithë aktorëve dhe faktorëve që luajnë rol në kohëzgjatjen e arsyeshme<sup>121</sup>.

## **Faktori 4.2 Impakti i menaxhimit të çështjeve, si rrjedhojë e rolit të vetë gjyqtarit mbi kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore**

### **4.2.1 Standardet e performancës**

GJK ka theksuar se, arsyeja e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GjEDNj-së, sipas së cilës arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit<sup>122</sup>. Te sjellja e autoriteteve, si element ndikues analizohet dhe roli i gjyqtarit përkatës në çështjen gjyqësore, pra sa ai/ajo me mënyrën e menaxhimit ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor.

“Standardet minimale të afatit” janë afate orientuese, brenda të cilave një çështje duhet të përfundojë. Këshilli miraton dhe rishikon standardet minimale të afatit, në mënyrë të veçantë për lloje të ndryshme çështjesh, duke vlerësuar natyrën, kompleksitetin dhe sasinë e çështjeve të regjistruara në gjykatë, si dhe infrastrukturën e gjykatës<sup>123</sup>.

Sipas GjEDNj-së, shtetet duhet të kërkojnë mënyra për t’u siguruar që sistemet e tyre gjyqësore nuk krijojnë vonesa në procese gjyqësore. Shtetet duhet t’i organizojnë sistemet e tyre ligjore për t’u mundësuar gjykatave të tyre që të garantojnë të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme.<sup>124</sup> Megjithatë, përgjegjësia kryesore për përgatitjen e çështjes dhe për kryerjen e shpejtë të një gjykimi u takon gjyqtarëve<sup>125</sup>. GjEDNj-ja ka konstatuar se ndryshimet e përsëritura të gjyqtarëve “nuk mund ta zhveshin shtetin nga përgjegjësia, pasi ai është përgjegjës për të siguruar që administrimi i drejtësisë është organizuar siç duhet.<sup>126</sup> Ashtu sikurse “mbingarkesa kronike” e gjykatave me çështje

121. SATURN Udhëzime për menaxhimin e kohës gjyqësore [*Guidelines for judicial time management*], CEPEJ-SATURN, 2015. Janë 15 udhëzime të SATURN dhe standarde, që duhen ndjekur për orientim mbi menaxhimin e kohës të gjykatave.

122. Vendimi nr.59, datë 16.09.2016 i Gjykatës Kushtetuese.

123. Neni 2/m i ligjit nr. 96/2016.

124. Cocchiarella k. Italisë, Nr. 64886/01, 29 mars 2006, prg. 119; Dobbartin k. Francës, nr. 13089/87, 25 shkurt 1993, prg. 44.

125. Capuano k. Italisë, nr. 9381/81, 25 qershor 1987, prg. 30-31.

126. Lechner dhe Hess k. Austrisë, nr. 9316/81, 23 prill 1987, prg. 58.



nuk i justifikon proceset e tejzgjatura<sup>127</sup>.

Nga standardet e SATURN, rezulton që personat përgjegjës për administrimin e drejtësisë janë që nga kryetari i Gjykatës, gjyqtarët specifikë, këshilltarët dhe i gjithë stafi administrativ që është i përfshirë në procesin vendimmarrës sipas rolit të tij/saj. Kohëzgjatja që merr apo duhet të marrë një çështje gjyqësore duhet bazuar në statistika dhe analiza mbi statistikat. Duhet të ketë informacion të mjaftueshëm se sa zgjat një çështje e caktuar dhe se sa zgjasin specifikisht të gjitha fazat e procesit nga regjistrimi i kërkesës deri në shpalljen e vendimit. Vetëm pasi realizohet ky proces, vendosen dhe standardet e brendshme për kohëzgjatjen e një çështjeje, ose standardet e një gjykate të caktuar për çështjen dhe monitorohet zbatimi i standardeve, pra dhe përgjegjësia specifike e personit sipas kompetencës/rolit përkatës në proces<sup>128</sup>.

#### **4.2.2 Treguesit e realizimit**

Potenciali dhe/ose aftësitë e gjyqësorit për ta shfaqur këtë potencial (kapacitetin profesional të sistemit të drejtësisë/gjyqësor/në varësi të burimeve (njerëzore, financiare, etj.)<sup>129</sup> Impakti i organizimit dhe menaxhimit të brendshëm të gjykatave (procedurat e caktimit të çështjeve, disponueshmëria e informacionit dhe rekordeve gjyqësore për palët dhe publikun) etj, mbi shpejtësinë e gjykimit dhe arritjen në një vendim përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme.

Realizimi bëhet duke u bazuar në treguesit e mëposhtëm:

- Cilat janë kapacitetet profesionale të gjyqtarit për të dhënë vendime brenda një kohëzgjatjeje të arsyeshme dhe sa ndikojnë (impakti) ato në kohëzgjatjen e procedurave?
- Si varion ky tregues për kategori të ndryshme rastesh, p.sh. për çështje penale, civile, administrative, rastet e korrupsionit dhe të krimeve të rënda, të procedurave të falimentimit, të së drejtës së konsumatorit, të të miturve, etj.?
- Cili është ndikimi i menaxhimit administrativ të gjykatave në shpejtësinë e gjykimit të çështjeve?
- Si është mjaftueshmëria e burimeve njerëzore dhe financiare në raport me shpejtësinë e gjykimit të një çështjeje?

#### **4.2.3 Metoda e matjes**

Njësoj si tek 4.1.3.

127. Probstmeier k. Gjermanisë, nr. 20950/92, 1 korrik 1997, prg. 64.

128. SATURN, Udhëzime për menaxhimin e kohës gjyqësore [*Guidelines for judicial time management*], CEPEJ-SATURN, 2015.

129. EU Justice Scoreboard. Shih [http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/files/justice\\_scoreboard\\_2016\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/files/justice_scoreboard_2016_en.pdf)

## Faktori 4.3 Ngarkesa në punë e gjyqësorit

### 4.3.1 Standardet e performancës

Gjyqësori është trupa e gjyqtarëve me funksion gjykues, ndërsa gjykatat janë organizata, ndaj ndërveprimi ndërmjet gjyqtarit individual dhe gjykatës si organizatë, në organizimin e punës gjyqësore dhe jo thjesht në përmbushjen e funksionit gjykues ka një ndikim të caktuar mbi pavarësinë, efektivitetin dhe eficientësinë në dhënien e drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr vazhdimisht ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, me qëllim përmirësimin e eficientësisë së gjykatave ose zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës<sup>130</sup>. Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e eficientësisë së gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës<sup>131</sup>. Të paktën çdo pesë vjet Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Gjykatës<sup>132</sup>.

### 4.3.2 Treguesit e realizimit

Impakti që ka menaxhimi i çështjeve nga vetë gjyqtari (studimi i çështjes para fillimit të procedurës, veprimet përgatitore, komunikimi dhe orientimet për palët gjatë progresit të procedurës), si dhe menaxhimi i brendshëm i gjykatave (ndërveprimi i gjyqtarit individual të çështjes me Kancelarin dhe Kryetarin e Gjykatës), në eficientësinë e drejtësisë (dhënien e vendimit përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme).

- Angazhimi proaktiv i gjyqtarit për rrjedhjen dhe menaxhimin e procedurës deri në dhënien e vendimit brenda afateve të arsyeshme;
- Vendosija e kufijve kohorë (*time-frame*) brenda të cilave do të duhej të merrej vendimi përfundimtar;
- A ka një politikë në gjykata për të shmangur vonesat dhe shtyrjet për shkaqe me një justifikim jo të mirë dhe në keqbesim (*adjournments only for a good cause*) dhe si mbikëqyret ajo?
- Si mund të kontrollohet nga gjykata ritmi i zhvillimit të hetimit gjyqësor (faza kryesore e procedurës)?
- A ka një sistem për monitorimin e performancës?
- Cili është koordinimi ndër-institucional në fushën e Drejtësisë Penale, për vetë kompleksitetin e saj?

130. Neni 22/1 i ligjit nr. 98/2016.

131. Ibid, neni 22/2.

132. Ibid, neni 22/3.

- Si ndodh identifikimi i atyre çështjeve që janë të përshtashme për zgjidhje me pajtim, ndërmjetësim, etj?
- Cili është impakti që ka përdorimi i IT, audio dhe video, në eficientësi e procedurave gjyqësore?
- Cilat janë trajnimet që kanë për objektive përmirësimin e eficientësisë së performancës së gjyqësorit (trajnime për degë të specializuara të së drejtës, trajnime për procedurën, trajnime për menaxhimin e ngarkesës së çështjeve, trajnime administrative dhe për menaxhimin e ngarkesës së çështjeve për gjyqtarët, trajnimet për kancelarin dhe kryetarin e gjykatës, trajnime për personelin jogjyqësor)?

### **4.3.3 Metoda e matjes**

Njësoj si tek 4.1.3. dhe 4.2.3, matje të harmonizuara për të gjithë treguesit e performancës së menaxhimit të çështjes gjyqësore. Metodatat e matjes sipas metodologjisë së CEPEJ-së, duke e ndërthurur me problematikat konkrete, sipas specifikës së gjykatave përkatëse, ose sipas natyrës së çështjeve në gjykim.<sup>133</sup>

## **Faktori 4.4 Njohuritë profesionale dhe mbështetja për gjyqësorin në juridiksionin e specializuar, dhe në çështjet me elemente ndërkombëtare**

### **4.4.1 Standardet e performancës**

Standardet organizative - strukturale, kushtetuese dhe ligjore kërkojnë:

- Gjykata të posaçme: a) gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykatën Administrative të Apelit; b) Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjykata e Lartë gjykon çështje të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm<sup>134</sup>.
- Seksione brenda gjykatave, për të mundësuar specializimin, kur kjo është e nevojshme, bazuar në kriteret objektive, në veçanti në numrin e gjyqtarëve në gjykatë, llojin dhe numrin e çështjeve në të paktën tri vitet e fundit në atë gjykatë. Seksionet e gjykatave përbëhen nga së paku gjashtë gjyqtarë. Caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues bëhet duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit.<sup>135</sup>

Gjyqtarët performojnë në ushtrimin e funksionit të tyre, në nivel më të lartë ekspertize, nëse specializohen në fusha të caktuara dhe konkrete (tregtare, civile, familjare, administrative, krim i organizuar dhe antikorrupsion).

133. Mund të përdoren produktet e SEJ I dhe SEJ 2, projekt "Mbi rritjen dhe forcimin e eficientësisë dhe efikasitetit në gjykatat shqiptare".

134. Neni 3/3 i ligjit nr. 98/2016.

135. Ibid, neni 23.

#### **4.4.2 Treguesit e realizimit**

Treguesit e realizimit do të duhej të fokusoheshin në:

- Sa mbështetje kanë gjykatat e posaçme bazuar mbi specifikën e tyre, ndryshe nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm?
- Sa mbështetje kanë gjyqtarët sipas fushave të specializimit dhe natyrës së çështjeve që gjykojnë?
- Sa buxhet shpenzohet për nevojat e shfrytëzimit të kontakteve ndërkombëtare, në rastet kur është e nevojshme?
- Sa menaxhim dhe efikasitet kanë rastet kur kërkohet ekspertizë ndërkombëtare?
- Si realizohet ndihma juridike mes gjykatave të shteteve të huaja?
- Si facilitohet ndërveprimi mes disa institucioneve në raste konkrete dhe të ndërlikuara?

#### **4.4.3 Metoda e matjes**

Krahasim i situatës *de jure* me situatën *de facto* lidhur me kërkesat e ligjit për specializim të gjyqtarëve dhe përfshirjen e tyre në gjykim sipas përvojës profesionale. Ballafaqim i legjislacionit dhe praktikës shqiptare me standardet dhe praktikat më të mira të fushës. Sondazhe mbi vetëvlerësimin e vetë gjykatave dhe gjyqtarëve për mbështetjen që u duhet garantuar me qëllim gjykimin e çështjeve me elemente ndërkombëtare.

### **Faktori 4.5 Kostot e procesit, shpenzimet procedurale dhe mjaftueshmëria me personel e trupës gjyqësore, si dhe me personel mbështetës administrativ-jogjyqësor.**

#### **4.5.1 Standardet e performancës**

Përcaktimi i tarifave gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile, administrative, bëhet me qëllim përfitimin e shërbimeve efektive dhe cilësore të ofruara nga gjykata. Kuadri ligjor mbi kostot e procesit; KPC, Kreu IV, nent 102-110<sup>136</sup>, ligji nr.98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligji nr.111/2017, “Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti”, duket i plotë nga pikëpamja normative, dhe që mund të arrijë të garantojë akses efektiv të individëve në gjykatë, por edhe të sigurojë të ardhura për buxhetin e gjykatës, në favor të cilësisë së shërbimeve gjyqësore.

---

136. Neni 102/1: Shpenzimet gjyqësore përbëhen nga tarifatat dhe nga shpenzimet e tjera të nevojshme të gjykimin. Neni 105/1: “Shpenzimet për dëshmitarët, përmbaruesit, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, parapaguhet nga pala që i ka kërkuar në shumën që ka caktuar gjykata. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe gjendjen pasurore të palëve, me vendim, ia ngarkon njërit ose të dyja palëve shpenzimet, pavarësisht se cila prej tyre ka kërkuar pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimit, thirrjen e përkthyesit ose këqyrjen”. Neni 105/b: Personat që, sipas dispozitave për tarifën, përjashtohen nga pagimi i taksës, përjashtohen edhe nga pagimi i shpenzimeve të tjera gjyqësore. Në këto raste, shpenzimet përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit.

Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera kushtetuese dhe ligjore.

Aksesit në ndihmë juridike falas duhet konsideruar si pjesë e rëndësishme e nenit 6 të KEDNj-së, të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Është pikërisht e drejta për ndihmë juridike falas, që garanton akses cilësor në drejtësi, përmes përjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe përmes mbrojtjes me përfaqësues ligjor të garantuar nga shteti. GjEDNj-ja ka theksuar se për të shmangur arbitraritetin, shtetet duhet të parashikojnë një mekanizëm, që selekton çështjet, që mund të përfitojnë ndihmë juridike falas<sup>137</sup>. Varet nga shteti përkatës, që të krijojë një sistem të tillë ndihme juridike të garantuar nga shteti, që të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet e GjEDNj-së.<sup>138</sup>

Ligji nr.98/2017, ka për objekt përcaktimin e llojeve të tarifave gjyqësore, masën, mënyrën dhe afatin e pagesës dhe rastet e përjashtimit nga pagimi i tyre. Sipas këtij ligji, tarifat gjyqësore janë tri llojesh:

- a) **tarifa gjyqësore të përgjithshme**, për paraqitjen e çështjeve në gjykata;
- b) **tarifa gjyqësore të veçanta**, për kryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore;
- c) **tarifa gjyqësore shitesë**, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.

Sipas këtij ligji, tarifat e përgjithshme gjyqësore aplikohen përpara fillimit të çështjes dhe, mbi këtë bazë, nis gjykimi. Individit, në shumë raste, i drejtohet gjykatës për të kërkuar një të drejtë, të cilën pikërisht pushteti administrativ publik, nuk ia ka njohur, ia ka cenuar apo cunuar dhe, nga ana tjetër, individit vihet në pozitë të vështirë përballë gjykatës, pasi për t'iu drejtuar asaj dhe që ajo të ketë mundësinë për ta dëgjuar, do të duhet që ai të paguajë, paraprakisht, tarifën gjyqësore. Në jo pak raste, individë me të ardhura të pakta, që nuk plotësojnë as kushtet për të përfituar ndihmën juridike, apo për t'u përjashtuar nga tarifat, për të kërkuar një të drejtë, do të ndodheshin realisht në pamundësi që të fillonin një proces gjyqësor, pikërisht për shkak të detyrimit për të paguar tarifën. Krijimi i barrierave të tilla financiare, do të krijonte premisën që individit të frenohet për t'iu drejtuar një gjykate më të lartë, pasi pavarësisht vullnetit, ai do të ishte në pamundësi për t'iu përgjigjur kërkesave të ligjit për të realizuar pagesën e këtyre tarifave.

Tarifa duhet të synojë të përballojë koston e shërbimit dhe, në çdo rast kur parimi i financimit të pushtetit gjyqësor bie, ndesh me parimin e aksesit në gjykatë, është ky i fundit që duhet

137. Gnahoré kundër Francës, nr. 40031/98, 19 shtator 2000, prg. 41.

138. Siałkowska kundër Polonisë, nr. 8932/05, 22 mars 2007, prg.107.

të mbizotërojë. Gjithsesi, balanca e nevojshme midis respektimit të parimit të aksesit në gjykatë dhe nevojës për të përballuar kostot e sistemit në dhënien e së drejtës, duhet testuar.

#### **4.5.2 Treguesit e realizimit**

Realizimi i këtij standardi, duhet t'u përgjigjet pyetjeve:

- A ekziston i plotë kuadri nënligjor për pagimin e tarifave<sup>139</sup>?
- A është e mirëtrajnuar administrata gjyqësore si agjente e mbledhjes së tarifave?
- Si bashkëpunohet mes disa aktorëve përgjegjës si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, lidhur me rregullat dhe procedurat, që duhen ndjekur lidhur me tarifën gjyqësore?
- Si menaxhohet nga gjykata, pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?
- A janë rregullat dhe procedurat e qarta lidhur me tarifimin dhe përjashtimin nga tarifën?
- A dëmtohet aksesit efektiv nga pagimi i tarifave gjyqësore?
- A kanë dijeni grupet vulnerabël për lehtësitë në këtë drejtim?

#### **4.5.3 Metoda e matjes**

Studime dhe monitorime mbi nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor lehtësues për garantimin e aksesit në drejtësi, por edhe të kostove dhe shpenzimeve gjyqësore të proceseve. Studime dhe raporte monitoruese, si dhe plotësim i pyetësorëve nga përdoruesit e gjykatave mbi përballimin e tarifave dhe kostove gjyqësore, sipas metodologjive të CEPEJ<sup>140</sup>.

---

139. Neni 10-12 i ligjit nr. 98/2017.

140. CEPEJ, "Doracak për kryerjen e anketave të kënaqësisë që synojnë përdoruesit e gjykatave në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës [*Handbook for conducting satisfaction surveys aimed at court users in Council of Europe's member states*].

## Pjesa 7

### KOMPETENCA DHE PËRKUSHTIMI PROFESIONAL

#### **Pse duhet vlerësuar/matur**

Shteti i të drejtës nënkupton jo vetëm pavarësinë e gjyqësorit, por edhe gjykata kompetente që janë në gjendje të vënë në zbatim një drejtësi cilësore. Nëse kompetenca plotëson si vlerë pavarësinë, kjo e fundit plotësohet nga përkushtimi ose angazhimi për të përmbushur në mënyrë të ndershme detyrat gjyqësore, domethënë detyrën gjykimore dhe detyrën për administrimin e ndershëm të gjykatave (përkushtimi ndaj vlerave profesionale/deontologjia).

Përkushtimi individual i gjyqtarit ndaj detyrës dhe vlerave profesionale nënkupton se detyra si gjyqtar e një individi ka përparësi ndaj të gjitha aktiviteteve të tjera të tij, madje mund të sjellë kufizime në sjelljen dhe jetën individuale, ndryshe nga ato të qytetarëve të tjerë. Të tria së bashku, (pavarësia, kompetenca dhe përkushtimi ndaj vlerave profesionale), janë prerekuzita, që gjyqësori të performojë me standardet e duhura në përmbushjen e funksionit të tij gjyqësor, si mbrojtës i lirisë dhe vendosës i drejtësisë në një shoqëri demokratike.<sup>141</sup>

Zelli apo përkushtimi profesional nënkupton se gjyqtari jo vetëm duhet të jetë kompetent, por duhet t'i përmbushë të gjitha detyrat e tij në mënyrë sa më:

- a) eficiente
  - b) të ndershme, dhe
  - c) me gatishmëri të arsyeshme, në kohën e duhur dhe pa vonesa të pajustificuara.<sup>142</sup>
- Gjyqtari duhet të mbajë qëndrim kundërshtues ndaj "taktikave vonuese" të palëve, ndaj "fryrjes së paarsyeshme" të kostove gjyqësore për palët, duhet të japë vendime sa më të arsyetuara, si dhe të bëjë përpjekje personale për përmirësimin e kompetencës së tij profesionale, domethënë jo të mbështetet vetëm në trajnimet institucionale.

Kompetenca përfshin:

- a) kompetencën juridiko-gjyqësore,
- b) aftësitë ekstragjyqësore si administrator i çështjeve në gjykim apo si Kryetar Gjykate,
- c) aftësitë e komunikimit,

141. Parimi/Vlera 6 e Parimeve të Bangalore për Sjelljen e Gjyqësorit.

142. Paragrafi 6.5, I Vlera 6 të Parimeve të Bangalore për Sjelljen e Gjyqësorit.



ç) si dhe cilësitë personale që duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit gjyqësor.<sup>143</sup>

## **Faktori 5.1 Përshtatshmëria e arsimit juridik (kurrikulat) në fakultet dhe magjistraturë, me nevojat dhe stadin e zhvillimit të gjyqësorit**

### **5.1.1 Standardet e performancës**

Përshtatshmëria e edukimit dhe e trajnimit vazhdues, përbën standard të kërkuar ndërkombëtar dhe ligjor, që lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e drejtësisë. Mungesa e “specializimit”, “tret dhe hollon” cilësinë e drejtësisë së vendimeve gjyqësore.

Formimi fillestar i kandidatëve për gjyqtarë përfshin një periudhë trevjeçare që përbëhet nga:

- a) një vit program teorik që synon të rrisë njohuritë në lëndë të ndryshme të së drejtës;
- b) një vit program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë dhe prokurorë nën kujdesin e shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë;
- c) një vit praktikë profesionale që do të organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në ligjin nr.96/2016<sup>144</sup>.

### **5.1.2 Treguesit e realizimit**

Përshtatshmëria e arsimit juridik bazë (kurrikulat, formimi teorik, praktik dhe internship-et profesionale), (në Fakultet dhe Magjistraturë), me nevojat dhe stadin e zhvillimit të së drejtës, bazuar në:

- njohuritë themelore (në të drejtën materiale dhe procedurale),
- metodat e mësimdhënies,
- modeli profesional i formimit të magjistratëve,
- trajnimi fillestar, disponueshmëria dhe burimet.

### **5.1.3 Metoda e matjes**

Analizë dhe diagnozë e kurrikulave në përputhje me stadet e zhvillimit të së drejtës, në përputhje me nevojat e kandidatit për gjyqtar. Diagnoza vazhduese, të herëpashershme, periodike në ShM lidhur me vlerësimin e testeve hyrëse në ShM, lidhur me kurrikulat edukuese të formimit fillestar sipas nevojës, dhe sipas sfidave të zhvillimit ekonomik-social të vendit dhe përgjigjes dhe pritshmërive të përdoruesve, sipas këtyre zhvillimeve në nivel ligji dhe jurisprudence.

143. Neni 9, pika 1 shkronja “a”, neni 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016.

144. Neni 263 i ligjit nr.115/2016.



## Faktori 5.2 Procesi përzgjedhës dhe emërimi / promovimi

### 5.2.1 Standardet e performancës

Emërimi i magistratëve nuk është një proces formal. Ai realizohet vetëm pasi KLGj bën kontrollin e pasurisë dhe figurës së kandidatit për gjyqtar<sup>145</sup>. Procesi kërkohet të realizohet mbi kritere standarde dhe të barabarta për të gjithë kandidatët dhe të bëhet brenda një afati të shpejtë kohor, në mënyrë që të mos përbëjë pengesë për hyrjen sa më të shpejtë të gjyqtarëve të rinj në sistem, nevojë kjo e shtuar në situatën aktuale të gjyqësorit. Vendimet për secilin kandidat duhet të jenë të arsyetuara dhe të bazuara në dokumentacionin e paraqitur, veçanërisht nëse do të ketë raste që KLGj nuk lejon emërimin e kandidatëve<sup>146</sup>.

Në funksion të trajtimit të barabartë dhe në paanësi duhet menaxhuar nga KLGj edhe situata kur kandidatët për magistratë të një viti kërkojnë të emërohen në vitin pasardhës. Paanësia mund të vendoset në dyshim për shkak se momenti i emërimit lidhet edhe me momentin e caktimit në pozicion, pra caktimit se në cilat gjykata do të ushtrojnë funksionin gjyqtarët e rinj, çështje e cila është shumë e ndjeshme për kandidatët dhe përgjegjësia me të cilën KLGj duhet ta trajtojë këtë moment është me interes për publikun. Për këtë arsye, ligji kërkon që KLGj të ketë miratuar rregulla mbi bazën e të cilave do të vendoset për të lejuar ose jo kandidimin e kandidatëve për magistratë në vitin pasardhës.

Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligjin nr.115/2016<sup>147</sup>. Aplikantët i nënshtrohen konkursit, i cili zhvillohet nën monitorim. Testimi i dijeve gjatë konkursit të pranimit bëhet së paku me shkrim<sup>148</sup>.

Thirrja për aplikime, procesi i regjistrimit për konkurrim në Shkollën e Magjistraturës dhe vlerësimi paraprak për plotësimin e kriterëve kryhen sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr.96/2016<sup>149</sup>. Vlerësimi i formimit fillestar të kandidatit për gjyqtar bëhet sipas neneve 267-269 të ligjit nr.115/2016.

I diplomuari emërohet gjyqtar, nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme; b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar; c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga KLGj<sup>150</sup>.

145. Ligj nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 35.

146. Në rastin e kandidatit për gjyqtar, F.D, KLGj, me Vendimin nr. 253, datë 12.11.2019, vendosi mos ta emëronte me arsyetimin se kishte probleme me pasurinë e tij, por Gjykata Administrative e Apelit pranoi padinë e bërë nga F.D ndaj KLGj dhe vendosi detyrimin e KLGj për vijimin e procedurës së emërimit të paditësit.

147. Neni 136/a i Kushtetutës

148. Neni 266 i ligjit nr. 115/2016.

149. *Ibid*, neni 262.

150. Neni 35 i ligjit nr. 96/2016.

Rregullat ligjore për vlerësimin, ngritjen në detyrë duhet të njihen mirë ndërmjet gjyqtarëve. Këto rregulla duhet të trajtohen në arsimin ligjor fillestar të kandidatëve për gjyqtarë në Shkollën e Magjistraturës.

### **5.2.2 Treguesit e realizimit**

Kriteret dhe procesi përzgjedhës në emërimin për herë të parë në detyrë, janë të rëndësishme, jo vetëm për pavarësinë dhe paanësinë politike, por edhe për profesionalizimin e gjyqësorit<sup>151</sup>.

Tregues të realizimit të këtij faktori përfshijnë:

- KLGj përdor një metodologji të përshtatur për kontrollin që u bën kandidatëve për gjyqtarë në pritje të emërimit e cila ofron një mënyrë të shpejtë emërimi të tyre;
- KLGj jep vendime të arsyetuara në rastet e mosemërimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë;
- KLGj ka miratuar dhe zbaton rregulla të paracaktuara për rastet e emërimit të magjistratëve në vitin pasardhës nga viti i diplomimit të tyre.

Treguesit e realizimit duhet të orientohen nga përgjigjja për këto pyetje:

- Kriteret ligjore të përzgjedhjes dhe emërimit për herë të parë, janë apo jo objektive dhe të bazuara mbi meritën<sup>152</sup>?
- Konkurrenca për emërimin në detyrë, a është e bazuar mbi kritere objektive dhe meritokratike?
- A është procesi transparent, dhe nëse ekzistojnë garancitë *de facto* të qëndrimit në detyrë?
- Përputhshmëria e kriterëve ligjore me praktikën institucionale/ A janë procedurat profesionale të emërimit, transparente dhe objektive?
- Cilat janë kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në nivele më të larta, sipas kategorive që përcakton ligji?
- Nga juridiksioni i përgjithshëm në juridiksionin e posaçëm (antikorrupsion, të krimeve të rënda) të
  - o Apelit
  - o Gjykatës së Lartë
  - o Gjykatës Kushtetuese

### **5.2.3 Metoda e matjes**

Për treguesin e metodologjisë që përdor KLGj-ja dhe arsyetimin e vendimeve të saj bëhen pyetje si:

---

151. Neni 1, pika 1 shkronja 'b' e ligjit nr. 96/2016.

152. Neni 35 pika 1 i ligjit nr. 96/2016; Opinion nr.403/2006/, 16-17 mars 2007, i Komisionit të Venecias "Për emërimet gjyqësore".

- A ka miratuar KLGj-ja një metodologji të përshtatur për kontrollin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për magistratë që janë diplomuar nga ShM?
- A është publikuar kjo metodologji përpara kontrollit?
- A janë përcaktuar në mënyrë të plotë dhe shteruese burimet e mbledhjes së informacionit, rregullat dhe hapat proceduralë që do të ndiqen gjatë verifikimit dhe kriteret e përshtatshmërisë/papërshtatshmërisë?
- A ka pasur konflikte gjyqësore për rastet e mospërshtatshmërisë? Nëse po, sa është raporti mes vendimeve gjyqësore që kanë lënë në fuqi vendimmarrjen e KLGj-së me ato që e kanë ndryshuar/shfuqizuar këtë vendimmarrje?

Për treguesin e rregullave të paracaktuara për rastet e emërimit të magistratëve në vitin pasardhës nga viti i diplomimit të tyre, bëhen pyetje si:

- A ka hartuar KLGj-ja një grup rregullash mbi bazën e të cilave do t'i japë përgjigje kërkesës së kandidatit për t'u emëruar në vitin pasardhës?
- A krijojnë këto rregulla pabarazi mes kandidatëve?
- A parashikojnë ato të drejtën për emërimin në vitin pasardhës si një të drejtë të zbatueshme vetëm në raste përjashtimore?

Metoda gjithashtu përfshin:

- Analiza dhe monitorime mbi emërimin në detyrë të gjyqtarëve, sipas kriterëve ligjorë dhe standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.
- Sondazhe dhe anketime në kategorinë e të sapoemëruarve si gjyqtarë, për perceptimin e tyre mbi meritokracinë në emërim dhe zbatimin e procedurave dhe rregullave ligjore.

## **Faktori 5.3 Sistemi/et i/e vlerësimit të gjyqtarëve të emëruar në detyrë**

### **5.3.1 Standardet e performancës**

“Skema e vlerësimit” u referohet tërësisë së rregullave të vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarëve<sup>153</sup>. Sistemi i vlerësimit bazohet dhe zbatohet nëpërmjet këtyre parimeve:

- a) parimi i pavarësisë, sipas të cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e gjyqtarit;
- b) parimi i meritokracisë dhe i zhvillimit të karrierës, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarit kryhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale;
- c) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme për të siguruar të dhëna në kohën e duhur për karrierën e gjyqtarit;

<sup>153</sup>. Neni 2/II i ligjit nr. 96/2016.

- c) parimi i procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit në procedurën e vlerësimit respektohen standardet e procesit të rregullt ligjor për gjyqtarin, duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar dhe të drejtën për t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit;
- d) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të gjyqtarit që vlerësohet, si dhe të dhënat e tij personale, sipas legjislacionit në fuqi<sup>154</sup>.

Vlerësimi i gjyqtarëve dhe kryetarit parashikohet e detajuar si procedurë në nenet 89-97 të ligjit nr.96/2016. Vlerësimi kryhet sipas kritereve:

- a) aftësi profesionale të gjyqtarit;
- b) aftësi organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit;
- ç) aftësi personale dhe angazhimit profesional<sup>155</sup>.

Rregullat ligjore për vlerësimin duhet të njihen mirë ndërmjet gjyqtarëve. Këto rregulla mund të trajtohen në arsimin ligjor fillestar të gjyqtarëve në Shkollën e Magjistraturës.

### **5.3.2 Treguesit e realizimit**

- Ekzistenca e kuadrit ligjor parësor dhe dytësor për vlerësimin e gjyqtarëve.
- Ekzistenca e pikëzimit dhe ndërtimit të një sistemi objektiv të vlerësimit.
- Ekzistenca dhe zbatimi i një procesi të rregullt ligjor/administrativ për gjyqtarët nën vlerësim. Gjyqtarë të emëruar në detyrë dhe të vlerësuar sipas një sistemi objektiv të vlerësimit, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe ligjore.

Realizimi i vlerësimit, duhet të tregojë se:

- A ndërhyt procesi i vlerësimit në pavarësinë e gjyqtarit?
- A garanton sistemi i vlerësimit, meritokraci, bazuar në vlera profesionale dhe cilësisë në punë?
- A është sistemi i vlerësimit, efikas dhe i shpejtë?
- A garanton sistemi i vlerësimit të drejtat procedurale të gjyqtarit?
- A garanton sistemi i vlerësimit, shpejtësi, efikasitet, dhe domosdoshmëri, që t'i vlejë gjyqtarit për karrierë në gjyqësor?

154. Neni 69 i ligjit nr. 96/2016.

155. Neni 71 i ligjit nr. 96/2016.

### 5.3.3 Metoda e matjes

E njëjtë si tek 5.1.3. dhe 5.2.3. Ndërthurje e metodologjive të matjes, mes kritereve objektive dhe subjektive, sipas standardeve më të mira, rekomanduar nga CEPEJ dhe CCJE.

Vlerësimi individual i gjyqtarëve në Shqipëri përkundrejt standardeve ndërkombëtare, veçanërisht standardeve të hartuara nga CCJE-ja në Opinionin e saj nr.17, (2014) “Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësinë e drejtësisë dhe respektimin e pavarësisë së gjyqësorit”.

Raporti i ENCJ-së dhe Raporti 17 (2014) 4 i CCJE-së bëjnë dallimin ndërmjet sistemit formal dhe informal të vlerësimit individual të gjyqtarëve<sup>156</sup>. Nëse vlerësimi individual bëhet në mënyrë formale, përcaktohet qartësisht qëllimi i vlerësimit, kriteret e përdorura, përbërja dhe përgjegjësitë e organit vlerësues, si dhe pasojat e mundshme të vlerësimit, shpesh me anë të legjislacionit parësor. Në një sistem formal vlerësimi, zakonisht gjyqtari merr një vlerësim/klasifikim formal. Për më tepër, vlerësimi ka shpesh pasoja të drejtpërdrejta, të tilla si mundësi më të mira për ngritje në detyrë, rritje të pagës, madje dhe shkarkim nga detyra.

Sistemi i vlerësimit informal zakonisht nuk përdor as vlerësime/klasifikime dhe as kritere formale. Zakonisht vlerësimi informal nuk ka pasoja të drejtpërdrejta, por shërben për të dhënë informacion rreth gjyqtarit objekt vlerësimi. Megjithatë, edhe mbledhja informale e informacionit rreth një gjyqtari që është kandidat për ngritje në detyrë, mund të konsiderohet vlerësim informal. CCJE-ja e identifikon pajtimin e pavarësisë së gjyqësorit me vlerësimin individual të gjyqtarëve si çështje vendimtare.

## Faktori 5.4 Trajnimi dhe formimi i vazhdueshëm

### 5.4.1 Standardet e performancës

Gjyqtari ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdueshëm. Gjyqtari ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me KLGj-në, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit<sup>157</sup>.

Gjyqtari *duhet*:

- a) të ndjekë formimin vazhdueshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës<sup>158</sup>.

156. Raporti i periudhës 2012-2013 i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësore (ENCJ) për standardet minimale lidhur me vlerësimin e performancës profesionale dhe mosheqjen nga detyra të anëtarëve të gjyqësorit, kreu 2, fq. 10.

157. Neni 5/1 i ligjit nr. 96/2016

158. Ibid, neni 5/2.

Trajnimet jashtë karrierës nuk janë domosdoshmërisht të detyrueshme dhe ndahen në:

- a) trajnime të nevojshme për përmirësimin dhe përditësimin e kompetencës profesionale gjyqësore;
- b) trajnimet e lidhura me ndryshimin e detyrës, psh. kalimi nga juridiksioni civil në atë administrativ, apo të krimeve të rënda, apo emërimi si Kryetar Gjykatë.

Trajnimet jashtë detyrës gjyqësore të Magjistratit:

- a) për administrimin e gjykatave dhe si kryetar gjykatë;
- b) për komunikimin dhe etikën;
- c) për fusha shoqërore të ekspertizës jashtë gjyqësore.

Garantimi i pavarësisë së autoritetit, që mbikëqyr trajnimin e gjyqtarëve nga legjislativi dhe ekzekutivi dhe roli i vetë gjyqtarëve në parashikimin e nevojave për trajnim.<sup>159</sup>

#### **5.4.2. Treguesit e realizimit**

Formimi<sup>160</sup> fillestar dhe praktikat profesionale<sup>161</sup>, dhe formimi i vazhdueshëm pas emërimit fillestar (*in-service training*):<sup>162</sup>

- Sa të përshtatura janë trajnimet me nevojat, cila është metoda e vlerësimit të nevojës për trajnime?
- Sa të specializuara dhe të detajuara janë trajnimet?
- Sa të diversifikuara janë trajnimet e planifikuara dhe të përfituara?
- Thellësia e trajnimit?
- Metodatat e trajnimit?
- Sa i pavarur është autoriteti që mbikëqyr trajnimet?
- A vlerësohen programet dhe metodatat e trajnimit në vazhdimësi dhe periodikisht, në mënyrë që të sigurohet cilësia e trajnimit?
- A u referohen trajnimet veçanërisht praktikave të punës së përditshme të gjyqtarëve?
- A përfshijnë programet e trajnimit të drejtën evropiane, KEDNJ, dhe konventat e Këshillit të Evropës?<sup>163</sup>

#### **5.4.3 Metoda e matjes**

E njëjtë si tek 5.1.3, 5.2.3 si dhe 5.3.3. Ndërthurje e metodologjive të matjes, mes kriterëve objektive dhe subjektive, sipas standardeve më të mira, rekomanduar nga CEPEJ dhe CCJE.

159. Paragrafi 2.3 i Kartës Evropiane të Statutit të Gjyqtarëve parashikon se gjysma e autoritetit që mbikëqyr trajnimet e gjyqësorit duhet të jetë nga radhët e tij.

160. Opinion nr.4 /2003, CCJE -së.

161. Neni 263 i ligjit nr. 115/2016.

162. Neni 5 i ligjit nr. 96/2016.

163. Rekomandimet e Opinionit Nr.4 (2003) të CCJE, “Për trajnimin e gjyqtarëve”.

## **Faktori 5.5 Ndershmëria e procedurave dhe metodave përzgjedhëse për përparimin në karrierë/promovimi**

### **5.5.1 Standardet e performancës - të përbashkëta**

Vlerësimi individual i gjyqtarëve duhet të synojë përmirësimin e cilësisë të punës së gjyqësorit, pa cenuar pavarësinë. Procesi i vlerësimit individual të gjyqtarëve duhet të kryhet në interes të publikut në përgjithësi. Vlerësimi individual i gjyqtarëve nuk duhet të kompromentojë asnjëherë parimin e pavarësisë së gjyqësorit.<sup>164</sup> Në fund, duhet të mbizotërojë pavarësia e gjyqësorit<sup>165</sup>.

### **5.5.2 Treguesit e realizimit**

Vlerësimi dhe shqyrtimi i kuadrit ligjor, Kreu II, nenet 71 dhe në vijim të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e Magjistratëve”. Realizimi si tregues, duhet t’u përgjigjet pyetjeve si:

- A garanton sistemi i vlerësimit individual ruajtjen e respektit të plotë për pavarësinë e gjyqësorit?
- A ka vlerësimi pasoja mbi ngritjen në detyrë dhe karrierën e gjyqtarit, ose mbi “pagën e bazuar në performancën e tij”, mbi pensionin, ose në lidhje me largimin e tij nga detyra?
- A ekzistojnë papajtueshmëri në lidhje me autoritetin, që kryen vlerësimin me atë që merr vendimet mbi ngritjen në detyrë dhe karrierën e gjyqtarit<sup>166</sup>?
- A ekziston rreziku që gjyqtari nuk do të marrë vendime objektive në interpretim të ligjit dhe fakteve, pra do t’i mungojë kjo “liri e brendshme” nga frika e dizavantazheve dhe sanksioneve, që rrjedhin nga vlerësimi?
- A janë kriteret e vlerësimit formal objektive<sup>167</sup>, të paracaktuara me ligj, dhe a përdoren ato për qëllime legjitime?
- A janë kriteret dhe procedurat e vlerësimit në përputhje me detyrat kryesore të gjyqtarit në një demokraci, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës?
- A janë burimet<sup>168</sup> ku bazohet vlerësimi, të besueshme?
- A janë vlerësimet të thelluara dhe a përcaktohen tregues sasiore (analiza statistikore) dhe cilësore për matjen e performancës së gjyqtarit<sup>169</sup>?
- A përfshin vlerësimi: 1) kompetencën juridike; 2) kompetencën në praktikat administrative të menaxhimit të çështjeve gjyqësore; dhe 3) kompetencën sociale të gjyqtarit në marrëdhënie me palët, për komunikimin dinjitoz dhe me respekt për ta, etj.<sup>170</sup>

164. Opinion nr.179, (2014) i CCJE “Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësisë së drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë gjyqësore”, dhe neni 69 pika 1 i ligjit nr.96/2016

165. Opinioni 17 (2014), para. 46 i CCJE-së.

166. Neni 88, shkronja “c” të ligjit nr.96/2016.

167. Nenet 72, 73, 74, dhe 75 të ligjit nr.96/2016

168. Neni 77 i ligjit nr.96/2016

169. Neni 78 i ligjit nr.96/2016

170. Rekomandimet e Kiev-it, Rekomandime për Pavarësinë Gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore [*Recommendations on Judicial Independence in Eastern Europe, South Caucasus and Central Asia*], 23-25 qershor 2010.



- A është procedura e vlerësimit efektive, e ndershme, dhe ai i shërben interesit publik në tërësi, apo deformohet duke u përdorur në qëllime të tjera jolegjitime?
- Cili është impakti i procedurës së vlerësimit në cilësinë e punës së gjyqësorit? Po në karrierën e gjyqtarit? Sa realist është vlerësimi për avancimin në karrierë?

### **5.5.3 Metoda e matjes**

E njëjtë si tek 5.1.3., 5.2.3., 5.3.3., 5.3.4., 5.4.3.

Ndërthurje e metodologjive të matjes, mes kriterëve objektive dhe subjektive, sipas standardeve më të mira, rekomanduar nga CEPEJ dhe CCJE.

## **Faktori 5.5/1: Transferimi, komandimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve**

### **5.5/1.1 Standardet e performancës**

Transferimi i gjyqtarëve, komandimi, lëvizjet paralele dhe ngritja në detyrë janë procese që lidhen, nga njëra anë, me të drejtën e gjyqtarit për të përmirësuar pozicionin e tij të punës dhe, nga ana tjetër, me mundësinë dhe detyrën që ka KLGj-ja për të siguruar miradministrim të gjykatave, rritje të efikasitetit dhe cilësisë në dhënien e drejtësisë. Për këtë arsye, për këto procese është shumë e rëndësishme që të respektohen kriteret dhe standardet e njëjta<sup>171</sup> dhe të respektohet radha prioritare e përcaktuar në ligj.

Duke u konsideruar edhe si të drejta për të përmirësuar kushtet e punës apo statusin e gjyqtarëve në detyrë, KLGj-ja duhet të vendosë gjyqtarët në një pozicion të pëlqyeshëm për ta realizuar lehtësisht këtë të drejtë. Pra, parimi i aksesit të barabartë duhet të realizohet nga ana e KLGj-së në çdo formë që ai mund të manifestohet, si për shembull, publikimi i thirrjes, lënia e një afati të arsyeshëm dhe të mundshëm për subjektet në mënyrë që ato të kenë mundësi reale të realizojnë të drejtën e tyre, apo arsyetimi i vendimmarrjes në çdo rast. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që çdo vendimarrje që lidhet me karrierën e gjyqtarit të jetë e arsyetuar, të mos sjellë cenim të statusit të tij dhe të jetë e bazuar në aftësi dhe meritë, të matura në mënyrë objektive<sup>172</sup>. KLGj-ja duhet të ketë një vendimarrje të arsyetuar në çdo rast edhe për shkak se ajo përgjigjet njëherësh, si ndaj kërkesës së gjyqtarit ose kryetarit të një gjykate në rastin kur ai kërkon magjistratë, edhe ndaj kërkesës së sistemit për të pasur një përmirësim të punës së tij si rrjedhojë e kësaj vendimarrje.

KLGj-ja duhet të tregojë profesionalizëm dhe paanshmëri në këto raste. Kjo është e vetmja mënyrë që transferimet, komandimet dhe ngritja në detyrë të përmirësojnë punën e gjyqësorit, të motivojnë gjyqtarët në punën e tyre dhe të forcojnë besimin e publikut në këtë

171. Rekomandim (2010)12 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi gjyqtarët: pavarësia, eficaenca dhe përgjegjësitë, pika 44 dhe 45.

172. Opinion nr. 17 (2014) "Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësisë së drejtësisë dhe respektimin e pavarësisë gjyqësore" i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë;



institucion dhe në funksionimin e sistemit të drejtësisë<sup>173</sup>.

Në çdo rast, KLGj-ja detyrohet të shmangë konfliktin e interesit në çdo fazë të procesit<sup>174</sup>. Ligji parashikon që është anëtar i vet ai që duhet të shmangë konfliktin e interesit në rastet e vendimmarrjeve, relatimeve apo opinioneve lidhur me çështje të karrierës së personave të lidhur me të, siç e parashikon ligji. Megjithatë, edhe vet KLGj-ja duhet të marrë masa në mënyrë që të ketë një mekanizëm që e kërkon nga anëtarët shmangien e konfliktit të interesit, për shembull nëpërmjet deklaratave lidhur me konfliktin e interesit. Gjithashtu KLGj-ja duhet ta zgjidhë shpejt rastin e konfliktit të interesit duke parashikuar zëvendësim të anëtarit, kur është rasti, në mënyrë që të mos ketë vonesa në proces.

### **5.5/1.2 Treguesit e realizimit**

- KLGj-ja publikon vendet e lira (edhe vendet që priten të bëhen të lira brenda 3 muajve) në sistem dhe kërkesat që i kanë ardhur nga kryetarët e gjykatave për plotësim të gjykatave me gjyqtarë;
- KLGj-ja cakton një afat të arsyeshëm (afati dy javor i përcaktuar nga ligji duhet vlerësuar si standard minimal), brenda të cilit gjyqtarët e interesuar për lëvizje paralele, ngritje në detyrë, transferim, komandime, mund të shprehin interesin e tyre;
- KLGj-ja ka plotësuar të gjithë kuadrin nënligjor dhe metodologjik për vendimmarrjet dhe vlerësimin që bëhet në rastet e ndryshimeve në karrierën e magistratëve;
- KLGj-ja vlerëson përvojën profesionale të magistratëve bazuar në kriteret të paracaktuara dhe që shmangin pabarazinë që shkaktohet vetiu për shkak të kushteve të ndryshme ku ata mund të kenë punuar;
- KLGj-ja vendos mbi ndryshimet në karrierën e magistratit vetëm pasi ka bërë vlerësimin e tij;
- KLGj-ja merr një vendim të arsyetuar kur plotëson një pozicion të lirë dhe shpjegon përmbushjen e kriterëve dhe vlerësimin e pikëve për kandidatët;
- KLGj-ja kontrollon dhe shmang konfliktin e interesit në çdo vendimmarrje.

### **5.5/1.3 Metoda e matjes**

*Për treguesin e parë dhe të dytë: A ka bërë transparencë KLGj-ja për kërkesat që vijnë nga kryetarët e gjykatave për plotësime të vendeve të lira, përkohësisht apo në mënyrë të përhershme? A ka shpallur KLGj-ja një listë me vendet e lira apo që do të bëhen të lira brenda 3 muajve? A ka nisur KLGj-ja procedurën për shprehjen e interesit nga ana e gjyqtarëve? A i ka informuar gjyqtarët për procesin dhe dokumentacionin e nevojshëm? A është i mundshëm afati i caktuar nga KLGj-ja për të plotësuar aplikimet për këto pozicione? A ka pasur raste kur KLGj-ja ka shtyrë apo ka rihapur procesin e aplikimeve?*

*Për treguesin e tretë dhe të katërt: A ka nxjerrë KLGj-ja metodologjinë për vlerësimin e*

---

173. Duhet sjellë në vëmendje se mungesa e meritokracisë në procedurat e transferimeve dhe ngritjes në detyrë kanë qenë çështjet më të ndjeshme dhe më të akuzuara për anësi dhe korrupsion.

174. Ligj 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 72-76.

*gjqtarëve? A ofron sistemi i pikëzimit mundësi për evidentim të saktë të të gjitha arritjeve profesionale të kandidatëve? A janë zbërthyer në mënyrë objektive dhe të matshme kriteret e ligjit? A ka bërë KLGj-ja një vlerësim të rezultateve të dala nga procesi i vlerësimit për të parë nëse ai ofron mundësinë e krijimit të diferencimeve mes kandidatëve? A i ka marrë parasysh KLGj-ja dallimet që krijohen vetiu për shkak të kushteve të ndryshme ku magjistratët kanë punuar? A ka pasur ankesa nga magjistratët lidhur me metodologjinë e vlerësimit? Nëse po, si janë trajtuar ato nga KLGj-ja?*

*Për treguesin e pestë: A ka raste të gjyqtarëve që promovohen kur nuk ka një vlerësim profesional të tyre të bërë nga KLGj-ja? A ka një frekuencë të njëjtë në afatet kohore të vlerësimit të magjistratëve?*

*Për treguesin e gjashtë: A përmban vendimi i KLGj-së arsyetimin e përmbushjes së kriterëve, të rezultateve të pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve? Sa është përqindja e ankesave ndaj këtyre vendimeve krahasuar me vendimmarrjet që nuk janë ankimuar? A ka pasur ndryshim të pikëzimit pas ankesës së magjistratit (qoftë nga KLGj-ja apo me vendim gjykate)?*

*Për treguesin e shtatë: A garanton KLGj-ja se anëtarët kanë qenë tërësisht të pavarur në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre? A janë shprehur ata mbi mosekzistencën e asnjë shkakut që veson këtë vendimmarrje? A ka pasur kërkesa për përjashtim të anëtarëve? Nëse po, si është vepruar nga KLGj-ja? A ka pasur kontroll gjyqësor të këtyre rasteve?*

## **Faktori 5.5/2 Transferimet**

### **5.5/2.1 Standardet e performancës**

Transferimi, i përhershëm ose i përkohshëm, është kalimi nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori (edhe në rastet kur magjistrati ka qenë i komanduar) në një pozicion në një gjykatë ose prokurori tjetër të të njëjtit nivel.<sup>175</sup> Arsyeja kryesore e transferimeve lidhet me kërkesën e magjistratëve për të ndryshuar vendin e punës dhe për t'u afruar për shembull me vendbanimin apo me qytetin ku ata dëshirojnë të punojnë. Pra, transferimi shikohet si një e drejtë e gjyqtarit, i cili, pas qëndrimit të të paktën 5 viteve në gjykatën ku është caktuar pas diplomimit, kërkon të përmirësojë pozitën e vet duke u transferuar në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel. Transferimi i përhershëm realizohet me procedurën e lëvizjes paralele të parashikuar në ligj<sup>176</sup>.

Ndërsa lidhur me transferimin e përkohshëm, arsyeja e përdorimit nga KLGj-ja të kësaj mundësie lidhet me rastet kur skema e delegimit është jo efektive. Për shembull kur një gjykatë shfaq nevojë të herëpashershme për gjyqtarë, dhe sipas vlerësimit të KLGj-së është më efiçente të transferojë në mënyrë të përkohshme një magjistrat, se të procedojë me delegime të herëpashershme. Në dallim nga transferimi i përhershëm, transferimi i përkohshëm nuk konsiderohet si avantazhues për magjistratin dhe kjo është arsyeja pse ligji parashikon që KLGj-ja të përdorë magjistratët e rinj dhe magjistratët që janë në gjykata me volum të ulët pune.

175. Ligj 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 42;

176. Ligj 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, neni 43;

Një ndër parimet kryesore të transferimit është marrja e pëlqimit të magjistratit. Vetëm në raste përjashtimore mund të transferohet një gjyqtar në mënyrë të detyruar nga KLGj-ja dhe në këto raste ai ka të drejtën e ankimit në gjykatë të kësaj vendimmarrjeje.

Gjithashtu, në rastet e transferimeve të përkohshme kërkohet edhe një bashkëpunim mes KLGj-së dhe kryetarëve të gjykatave për të pasur dakordësi lidhur me nevojat që ka gjykata “pritëse” dhe gjykata nga e cila ikën magjistrati.

### **5.5/2.2 Treguesit e realizimit**

- ✓ KLGj-ja vlerëson kërkesat e magjistratëve për transferim vetëm pasi ka miratuar rregulla të detajuara, të cilat përcaktojnë: a) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magjistratëve me pikë të barabarta vlerësimi; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta;
- ✓ KLGj-ja zbaton rregulla të detajuara dhe të përshtatura për vlerësimin dhe vendimmarrjen në rastet e transferimeve të përkohshme, pa cenuar statusin dhe pozitën e magjistratit;
- ✓ KLGj-ja merr mendimin e kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionet magjistrati në rastet kur ka një kërkesë për transferim ose komandim të tij në një gjykatë tjetër ose në Këshill dhe arsyeton vendimmarrjen e saj në rast se vendos në mënyrë të ndryshme nga çfarë argumenton kryetari i gjykatës;
- ✓ KLGj-ja arsyeton vendimmarrjen në rastet e transferimit pa pëlqim të magjistratit.

### **5.5/2.3 Metoda e matjes**

*Për treguesin e parë dhe të dytë: A ka miratuar KLGj-ja rregulla të detajuara për vlerësimin e magjistratëve që kandidojnë sipas procedurës së lëvizjes paralele? A afrojnë këto rregulla mundësinë që të vlerësojnë kandidatët në mënyrë objektive dhe të arsyetuar edhe kur dalin me pikë të barabarta? Çfarë kriteresh parashikon KLGj-ja për vlerësimin e specializimit të gjyqtarit? Si janë përshtatur këto rregulla me rastet e transferimit të përkohshëm?*

*Për treguesin e tretë: A ka raste kur KLGj-ja vendos për transferim të magjistratit kur Kryetari i gjykatës ku ushtron funksionin gjyqtari nuk jep pëlqim për këtë transferim? A kërkon KLGj-ja arsyetim të mendimit të Kryetarit të gjykatës në këto raste?*

*Për treguesin e katërt: A ka përdorur KLGj-ja të gjitha mundësitë e tjera që i nje ligji përpara se të vendosë për transferimin pa pëlqim të magjistratit? A është njohur magjistrati me këtë arsyetim? A ka pasur konflikte gjyqësore për këtë shkak? Nëse po, si ka vendosur gjykata?*

## **Faktori 5.5/3 Përfshirja në skemën e delegimit dhe komandimi**

### **5.5/3.1 Standardet e performancës**

Delegimi dhe komandimi konsiderohen si momente kur magjistrati i shërben sistemit në

kushtet kur ka nevojë për magjistratë (delegimi brenda gjykatave të të njëjtit nivel, ndërsa komandimi brenda sistemit të drejtësisë, që përfshin edhe komandimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, komandimin në KLGj, KLP, PP, MD, etj). Për shkak të një pozite pune që konsiderohet jo shumë e favorshme për magjistratin, ligji iu njeh këtyre magjistratëve përparësi në momente të mëvonshme të lëvizjes në karrierë të tyre.

Delegimi duhet të përdoret si rast përjashtimor zgjidhjeje për vakanca të menjëhershme apo në kushte kur është e pamundur të procedohet me mënyrat e tjera të plotësimit të vendeve të lira në gjyqësor. Magjistratët e përfshirë në skemën e delegimit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë nga KLGj-ja. Në rastet e delegimeve KLGj-ja duhet të marrë parasysh edhe caktimin në mënyrë të barabartë të magjistratëve në skemën e delegimit, në gjykatat apo prokuroritë e largëta dhe disponueshmërinë e magjistratëve.

### **5.5/3.2 Treguesit e realizimit**

- ✓ KLGj-ja plotëson skemën e delegimit me magjistratë vetëm pasi ka hartuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve që kërkojnë të përfshihen në skemën e delegimit;
- ✓ KLGj-ja nxit përfshirjen e magjistratëve në skemën e delegimit duke orientuar magjistratët e rinj edhe për përfitimin që ata mund të marrin pasi kanë shërbyer në skemën e delegimit;
- ✓ KLGj-ja tregon barazi dhe paanësi në procesin e delegimeve;
- ✓ KLGj-ja komandon magjistratë në institucione të sistemit të drejtësisë bazuar në kriteret objektive me të cilat mat eksperiencën e tyre dhe vlerëson kontributin që mund të japë magjistrati në këtë institucion.

### **5.5/3.3 Metoda e matjes**

*Për treguesin e parë dhe të dytë: A është plotësuar skema e delegimit me gjyqtarë? A ka zbatuar KLGj-ja një procedurë paraprake bazuar në rregulla për përzgjedhjen e tyre? A ka nxitur KLGj-ja pjesëmarrjen e magjistratëve në këtë skemë nëpërmjet ndërgjegjësimit të rëndësisë së saj dhe përfitimeve që magjistratët mund të kenë kur dalin nga skema e delegimit? Sa kërkesa ka për t'u përfshirë në skemën e delegimit në një vit?*

*Për treguesin e tretë: A zbaton KLGj-ja kriteret objektive kur vendos për delegimet e magjistratëve? A ka ankesa nga magjistratët mbi mënyrën se si KLGj-ja përdor skemën e delegimit? A e arsyeton KLGj-ja vendimmarrjen në rastin e delegimeve?*

*Për treguesin e katërt: A bazohen komandimet në kërkesat specifike të institucioneve pritëse të magjistratëve të komanduar? A ndërmerr KLGj-ja një proces transparent dhe të aksesueshëm për këdo magjistrat të interesuar? A përdor KLGj-ja kriteret objektive vlerësimi për përshtatshmërinë e magjistratit me kërkesat e pozicionit ku do të komandohet? A bën KLGj-ja një vlerësim të mëpasshëm të efikasitetit dhe cilësisë së këtij "shërbimi", paralel me vlerësimin që bën institucioni për magjistratin e komanduar?*

## **Faktori 5.5/4 Ngritja në detyrë**

### ***5.5/4.1 Standardet e performancës***

Në rastin kur në sistem ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, KLGj-ja jep mundësi për magistratët që të ngrihen në detyrë. Ngritje në detyrë konsiderohet jo vetëm kalimi i një gjyqtari në një gjykatë më të lartë, por edhe kalimi në një gjykatë të specializuar, marrja e pozicionit të kryetarit të gjykatës apo kalimi nga magistrat i komanduar (ose në skemën e delegimit) në një pozicion të përheshëm në një gjykatë të një niveli më të lartë sesa gjykata ku ka emërimin gjyqtari.

Ngritja në detyrë në gjyqësor është moment shumë i rëndësishëm për karrierën e një gjyqtari për shkak se lidhet me ndryshime të rëndësishme në statusin e tij, por është moment shumë i rëndësishëm edhe për sistemin e drejtësisë për shkak se ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e drejtësisë. Njëkohësisht, krijimi i një klime “konkuruese” të drejtë ndërmjet magistratëve i shërben rritjen së performancës së tyre për shkak se ata besojnë se meritat dhe profesionalizmi i tyre do të vlerësohen.

Mundësitë për ngritje në detyrë nuk paraqiten shumë shpesh dhe pikërisht kjo vështirësi, për të arritur promovimin, bën që ky proces të jetë ndër më të vëzhguarit si brenda gjyqësorit, edhe për publikun.

KL Gj-ja është organi që vendos për ngritjen në detyrë dhe kërkesat ligjore e stanëdardet ndërkombëtare kërkojnë që KLGj-ja të jetë e pavarur, e paanshme, të bëjë një vlerësim të bazuar vetëm në meritë dhe të organizojë një proces transparent, të drejtë dhe të barabartë për magistratët që konkurojnë për të përfituar nga ngritja në detyrë. Pra, kujdesi i KLGj-së orientohet si në çështjet e thelbit (përcaktimi dhe vlerësimi i kriterëve, pikëzimi, renditja), edhe në çështje të procedurës (transparenca e procesit, arsyetimi i vendimmarrjes, respektimi i të drejtave procedurale të magistratëve konkurrues).

### ***5.5/4.2 Treguesit e realizimit***

- ✓ KLGj-ja vendos për ngritjen në detyrë pasi ka miratuar rregulla të detajuara, të cilat përcaktojnë kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi, kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë dhe procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta;
- ✓ KLGj-ja zbaton kërkesat ligjore për përvojën profesionale dhe specializimin;
- ✓ KLGj-ja organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.
- ✓ KLGj-ja sigurohet që anëtarët e KLGj-së përgjegjës për vlerësimin të mos bëjnë pjesë në komisionin që vendos për ngritjen në detyrë.

### **5.5/4.3 Metoda e matjes**

*Për treguesin e parë dhe të dytë: A krijon mundësi për diferencim mes aplikantëve metodologjia dhe sistemi i pikëzimit i miratuar nga KLGj-ja? Çfarë kriteresh parashikon KLGj-ja për vlerësimin e specializimit të gjyqtarit?*

*Për treguesin e tretë: A respektohen afatet ligjore për shpalljen dhe plotësimin e vendeve të lira me anë të procedurës së ngritjes në detyrë? Vërejmë se qëllimi i parashikimit të këtyre afateve lidhet jo vetëm me eficiencën, por edhe me krijimin e kushteve që vendimmarrja e KLGj-së të jetë e pavarur dhe e paanshme.*

*Për treguesin e katërt: Anëtarët e Komisionit të karrierës duhet të jenë të ndryshëm nga ata të Komisionit të vlerësimit etik dhe profesional dhe ky konflikt duhet të shmanget edhe nëse ka vlerësime të mëparshme, në të tjera struktura, që përfshijnë të njëjtët anëtarë me kandidatët për t'u promovuar. Në çdo rast vlejné rregullat për shmangien dhe kontrollin e konfliktit të interesit.*

## Pjesa 8

### MENAXHIMI I BRENDSHËM I GJYKATAVE DHE PERSONELI JOGJYQËSOR

#### **Pse duhet vlerësuar/matur:**

Menaxhimi i burimeve njerëzore në gjykata është një hallkë mjaft e rëndësishme në mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe në dhënien e drejtësisë. Duke filluar që nga KLGj-ja, Këshilli i Gjykatës, Kryetari i Gjykatës, Zëvendëskryetari, Kancelari të gjithë luajnë një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore në gjykata. Duhet të ketë një sistem që lejon rishikimin periodik të nevojave për personel gjyqësor dhe krijimin e pozicioneve të reja sipas nevojës<sup>177</sup>.

Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë: a) kancelari; b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë; c) ndihmësi ligjor në Gjykatën e Apelit; ç) kryesekretari; d) sekretari gjyqësor; dh) nëpunësi i financës dhe buxhetit; e) nëpunës të tjerë, që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me medien.<sup>178</sup>

KL Gj-ja është përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata.<sup>179</sup> Nga ana tjetër, gjykata ka nevojë për punonjës të aftë profesionalisht që demonstrojnë vlera etike, integritet dhe përkushtim në punë. Që një gjykatë të ketë performancë të lartë dhe të ofrojë shërbime sa më të mira për qytetarët përdorues të gjykatës, duhet të sigurojë një menaxhim të mirë të burimeve njerëzore dhe të dëshmojë vlerat dhe standardet më të larta të saj. Shërbimet që ofron një gjykatë duhet të jenë efikase, të japin drejtësi të barabartë për të gjithë, të realizojnë procese të rregullta ligjore, akses të barabartë si dhe të bëjnë të mundur që palët trajtohen në mënyrë të paanshme. Në mënyrë që një gjykatë të jetë e drejtë dhe objektive është e rëndësishme që të punësojë dhe të promovojë njerëzit e duhur. Ndaj dhe çështjet e burimeve njerëzore në gjykata janë sa të nevojshme aq edhe delikate, pasi gjyqësori duhet të jetë punëdhënësi model dhe gjithashtu të punojë për të rritur dhe përmirësuar perceptimin e qytetarëve për drejtësinë. Veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor rregullohet me ligj dhe bazohet mbi parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve eficiente dhe të aksesueshme për çdo person. Statusi i nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor mbështetet në parimin e garantimit të qëndrueshmërisë, bazuar në meritë dhe

177. Judicial Reform Index, ABA Rule of Law Initiative.

178. Neni 50 i ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

179. Neni 90, Ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”



zhvillimin transparent të karrierës.

Ligjet e reformës në drejtësi kanë përcaktuar rolet që luajnë gjithsecili në menaxhimin e burimeve njerëzore në gjykata.<sup>180</sup>

Shih kapitullin - **Pavarësia e gjyqësorit dhe - Eficenca në dhënien e drejtësisë**. Të njëjta argumente si për pavarësinë dhe eficientë e gjyqësorit, vlejnë edhe për këtë kapitull. Burimet njerëzore, menaxhimi i brendshëm i tyre passjellin standarde eficence dhe efikasiteti në gjykata, prandaj dhe duhen matur në nivelin e realizimit<sup>181</sup>.

## **Faktori 6.1 Burimet njerëzore në gjykata, mjaftueshmëria dhe cilësia e tyre**

### **6.1.1 Standardet e performancës**

Menaxhimi i burimeve njerëzore në gjykata kërkon identifikim sistematik dhe një analizë të nevojave të gjykatave në raport me madhësinë e tyre, si dhe cilësinë e stafit për të mbështetur misionin, qëllimet dhe objektivat e gjykatave. Kur gjykata planifikon burimet njerëzore duhet ta bëjë këtë duke menduar në nivel strategjik dhe nivel operacional dhe duhet të marrë në konsideratë vizionin e saj afatgjatë dhe funksionet operationale afatshkurtra. Ligjet e reformës në drejtësi dhe konkretisht Ligji nr. 98/2016 në nenin 38/c përcakton se organi që miraton strukturën organike të gjykatës është Këshilli i Gjykatës dhe e bën këtë duke u bazuar në një model të miratuar nga KLGj-ja, model që mund ta përshtatë me nevojat e gjykatës dhe aftësinë e personave në detyrë. Po ashtu, ligji<sup>182</sup> përcakton se strukturat përgjegjëse për qeverisjen e gjyqësorit administrojnë dhe mbikëqyrin funksionimin e gjykatave si në aspektin administrativ dhe në atë vendimmarrës të tyre. Për rrjedhojë, ligji i njeh KLGj-së kompetenca vendimmarrëse për të vendosur i vetëm për një sërë çështjesh dhe për çështje të tjera Këshilli i Gjykatës vendos i vetëm ose ka kompetenca kryesore vendimmarrëse.

KL Gj-ja është përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata. Specifikisht, Këshilli kryen detyrat e mëposhtme: a) hedh të dhënat dhe përditëson Regjistrin Qendror të Personelit për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit administrativë të gjykatave; b) publikon dhe shpall konkurrim të hapur për vendet e lira në shërbimin civil gjyqësor, si dhe fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele; c) emëron kancelarin e gjykatës dhe ndihmësit ligjorë, si dhe merr masa disiplinore ndaj tyre; ç) miraton dhe përditëson rregullat e procedurës që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë; d) cakton përfaqësuesin e tij në Këshillin e Gjykatës; e) miraton Kodin e Etikës për nëpunësit civilë gjyqësorë pas konsultimit me këshillat e gjykatave; f) kujdeset për miradministrimin e pasurive të paluajtshme të gjykatave në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe këshillin e gjykatës; g) ngre komisionin e ristrukturimit në rastet e mbylljes ose ristrukturimit të gjykatave; gj) kujdeset për krijimin dhe funksionimin e sistemit të arkivimit

180. Neni 90, Ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

181. Global Measures of Court Performance:

[http://www.courtexcellence.com/~media/microsites/files/icce/global%20measures\\_v3\\_11\\_2012.ashx](http://www.courtexcellence.com/~media/microsites/files/icce/global%20measures_v3_11_2012.ashx)

182. Nenet 89 dhe 90 të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”



gjyqësor, si dhe menaxhimin dhe administrimin e tij<sup>183</sup>.

KL Gj nxjerr rregulla standarde që duhet të përcaktojnë organigramën standarde për të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve, si dhe përshkrime standarde të detyrave dhe të përgjegjësiave për secilën kategori të punonjësve të gjykatave. Çështje të tilla duhet të gjejnë rregullim në aktet që nxjerr KL Gj-ja dhe janë të vlefshme për të gjitha gjykatat e vendit. Më pas Këshilli i Gjykatës miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të gjykatës, sipas modelit të miratuar nga KL Gj-ja, si dhe miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga KL Gj-ja.<sup>184</sup> Pra, në këtë mënyrë vëremë se, kuadri rregullator i përgjithshëm është miratuar nga KL Gj-ja, ndërsa vendimmarrja specifike për disa nga çështjet i mbetet organit vendimmarrës brenda gjykatës, Këshillit të Gjykatës.

**Kancelari i** çdo gjykate krijon dhe administron dosjen individuale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjës të administratës së gjykatës. Dosja individuale përmban të dhëna profesionale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjës të administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me shërbimin civil gjyqësor ose marrëdhënien e punës<sup>185</sup>. Kancelari i Gjykatës reflekton në Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat e përcaktuara nga ligji. Kancelari i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor, informacionin e kërkuar nga ligji.<sup>186</sup> Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme: a) shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë;

b) shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;

c) shërbime mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e përshtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës<sup>187</sup>.

### **6.1.2 Treguesit e realizimit**

Realizimi duhet të orientohet nga përgjigjet, bazuar në këto pyetje:

- ✓ Si rekrutohen, trajnohen dhe zhvillohet karriera e personelit jogjyqësor, Kancelarit dhe Kryetarit të Gjykatës, në mënyrë që të kemi personel cilësor dhe të motivuar në shërbim të qytetarëve dhe të drejtësisë?
- ✓ A ka kritere minimale për kualifikimet e personelit jogjyqësor, dhe cila është procedura për përzgjedhjen e tyre, a janë ato objektive dhe transparente?

183. Neni 90 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

184. Neni 38 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

185. Neni 63 i ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

186. Neni 88 i ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

187. Ibid, neni 49.

- ✓ A publikohen njoftimet për vendet e lira të punës?
- ✓ A ka një politikë të shanseve të barabarta dhe jo diskriminimit në punësim?
- ✓ A ka një proces intervistimi?
- ✓ A ka një politikë kundër konflikteve të interesit dhe nepotizmit?
- ✓ Cilat janë mënyrat e ndërhyrjes për të minimizuar kompleksitetet dhe dublimet/përsëritjet e panevojshme në personel dhe praktika të punës?
- ✓ Cilat janë linjat e autoritetit dhe ndërveprimi ndërmjet Kryetarit të Gjykatës dhe Kancelarit?
- ✓ Kur emërohet një Kryetar Gjykatë, a është një ndër kriteret e përzgjedhjes edhe vizioni i tij për drejtimin e gjykatës?
- ✓ Si kontrollohet nëse ky vizion përkthehet në masa dhe veprime konkrete, që i sjellin dobi punës në gjykatë?
- ✓ Cili është roli i Këshillit të Gjykatës?<sup>188</sup>
- ✓ Sa arrin ky këshill të përmbushë si vizionar leadershipin e gjykatës, që drejton së bashku me organet e tjera të qeverisjes së gjyqësorit?

### **6.1.3 Metoda e matjes**

Metodat e matjes për kapacitetet njerëzore, sipas standardeve të CEPEJ-së mbi efikasitetin dhe efikasitetin, që si element ka mjaftueshmërinë e stafit jogjyqësor, si dhe matje të nivelit të zbatimit të kërkesave për staf, sipas parametrave ligjorë të përcaktuar në ligj. Për shembull, ligji parashikon parametra orientues për numrin e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë dhe raportet numerike krahasuar me gjyqtarët e gjykatës përkatëse.

## **Faktori 6.2 Roli i vetë gjyqtarëve në administrimin e gjykatës**

### **6.2.1 Standardet e performancës**

**Administrimi gjyqësor** është tërësia e veprimtarive që synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të shërbimeve në mbështetje të sistemit gjyqësor.<sup>189</sup> Administrimi gjyqësor është detyrë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Gjykatës, kryetarit të gjykatës, kancelarit, kategorive të ndryshme të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe çdo institucioni tjetër të përcaktuar me ligj<sup>190</sup>.

**Gjyqtari** ka rol substancial në menaxhimin e çështjeve, por në vetvete është faktor ndikues edhe në administrimin e gjykatës si institucion, pasi sikundër u citua më lart, te faktori 4.2, përgjegjësia kryesore për përgatitjen e çështjes dhe për kryerjen e shpejtë të një gjykimi u takon gjyqtarëve<sup>191</sup>.

188. Nenet 26 dhe 27 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

189. Neni 2/a i ligjit nr.96/2016.

190. Neni 7 i ligjit nr.96/2016.

191. Capuano k. Italisë, nr. 9381/81, 25 qershor 1987, paragrafët 30-31.

Po ashtu, gjyqtari luan rol organizativ në menaxhimin e gjykatës, sipas standardeve ligjore për sa kohë që ai është anëtar i Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe jep mendim për çështje me rëndësi për gjykatën, si dhe diskuton dhe jep mendim për raportin vjetor të gjykatës, pra për realizimin e objektivave dhe për përmirësime të natyrës organizative, menaxheriale në vitin vazhdues<sup>192</sup>.

### **6.2.2 Treguesit e realizimit**

Realizimi duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve:

- Si është ngarkesa për çdo gjyqtar në raport me ngarkesën e gjykatës?
- Si matet roli i gjyqtarit në performacën e të gjithë gjykatës?
- Sa aktiv është gjyqtari për bashkëpunim dhe bashkëveprim me stafin jogjyqësor lidhur me çështjet e administrimit?
- Sa i përfshirë është gjyqtari në diskutime mbi çështjet e menaxhimit gjatë diskutimeve në Mbledhjen e Gjyqtarëve të Gjykatës?

### **6.2.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes është njësoj si te faktori 4.2. Ajo që kërkohet është harmonizim i metodave të matjes për të gjithë faktorët e kapitullit, në mënyrë të integruar.

## **Faktori 6.3 Menaxhimi i të dhënave gjyqësore**

### **6.3.1 Standardet e performancës**

**Shërbimet e teknologjisë** së informacionit sigurojnë:

- a) mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës<sup>193</sup>.

**Shërbimi i arkivit gjyqësor** mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë. Shërbimi i arkivit gjyqësor bashkëpunon me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit<sup>194</sup>.

192. Neni 40/b dhe 40/c i ligjit nr. 98/2016.

193. Neni 47 i ligjit nr.98/2016.

194. Ibid, neni 48.

Pranë Gjykatës së Lartë, funksionon **Qendra e dokumentacionit** që ushtron këto detyra:

- a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë;
- c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave<sup>195</sup>.

### **6.3.2 Treguesit e realizimit**

Ekzistenca e infrastrukturës njerëzore dhe teknologjike për administrimin e të dhënave. Krijimi dhe mirëmbajtja e arkivave gjyqësore. Realizimi duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve:

- Sa u përgjigjen standardeve të dokumentimit, kushtet buxhetore, infrastrukturore të gjykatës?
- Sa i plotëson standardet e ruajtjes dhe të sigurisë ky shërbim i arkivit?
- Sa i mjaftueshëm është personeli i arkivës dhe dokumentimit?

### **6.3.3 Metoda e matjes**

Metoda e matjes përfshin analizë dhe ballafaqim të kërkesave ligjore me situatën faktike në çdo gjykatë.

## **Faktori 6.3 Kultura menaxheriale e drejtimit administrativ të Gjykatës dhe standardet e performancës së personelit jogjyqësor**

### **6.3.1 Standardet e performancës**

Kryetari i Gjykatës, përfaqëson gjykatën dhe gjyqtarët kolegë, siguron funksionimin efektiv të gjykatës dhe, për rrjedhojë, edhe rritjen e shërbimeve ndaj shoqërisë, si dhe ushtron aktivitete gjyqësore si gjyqtar.<sup>196</sup>

Organet administrative dhe drejtimi administrativ i gjykatës ka disa nivele: 1. Kryetari i Gjykatës dhe zv/Kryetari;<sup>197</sup> 2. Këshilli i Gjykatës që ngrihet dhe funksionon pranë çdo gjykatë;<sup>198</sup> 3. Kancelari i Gjykatës; 4. Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës<sup>199</sup>.

195. Neni 35 i ligjit nr.98/2016.

196. **Consultative Council of European Judges (CCJE)**, Opinion n° 19 (2016), "The role of court presidents", pika II/6.

197. Ligji nr.98/2016, neni 28.

198. Ibid, neni 27, 38, dhe neni 23/4: Pas marrjes së mendimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, Këshilli i Gjykatës mund të krijojë një ose më shumë seksione në gjykatë. Këshilli i Gjykatës, pasi ka caktuar gjyqtarët në degë, nëse ka të tilla, krijon trupat gjykues dhe më pas cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues.

199. Neni 39 dhe 40 i ligjit nr.98/2016.

**Kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjykatës** për një periudhë 3-vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje<sup>200</sup>. Mandati i Kryetarit të gjykatave, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë<sup>201</sup>. Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një gjykate kryhet bazuar në këto kritere: a) aftësitë drejtuese dhe organizative; b) aftësitë e komunikimit<sup>202</sup>.

**Kryetari i çdo gjykate zgjidhet nga KLGj-ja** dhe ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra, lidhur me standardet e ndërveprimit, bashkëpunimit dhe koordinimit me stafin jogjyqësor:

- kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit;
- thërret, përgatit dhe drejton mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës;
- udhëzon dhe mbikëqyr kancelarin;
- verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit;
- kryen veprimet dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë;
- garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në veçanti në lidhje me masat që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore;
- garanton qasjen dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit dhe rregullave të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.<sup>203</sup>

**Zv/Kryetari i çdo gjykate zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve**, për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.<sup>204</sup> Në mungesë të kryetarit, ushtron kompetencat e tij.<sup>205</sup>

**Këshilli i Gjykatës**, përbëhet nga tre anëtarë:

- a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës;
- b) zëvendëskryetari i gjykatës;
- c) kancelari i gjykatës.

Këshilli ka këto kompetenca:

- a) miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës;

200. Neni 51 i ligjit nr.96/2016.

201. Ibid, neni 52.

202. Neni 79 i ligjit nr.96/2016.

203. Neni 37 i ligjit nr.98/2016.

204. Ibid, neni 26/2.

205. Ibid, neni 26/2.

- b) merr vendime në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç përcaktohet në këtë ligj;
- c) miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe, në raste të veçanta, i përshtat me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë;
- ç) miraton strukturën e gjykatës dhe cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, duke ndjekur rregullat e përgjithshme të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- d) shqyrton ankesa në lidhje me çështje të infrastrukturës së gjykatës, shërbimet ndihmëse në gjykatë dhe çështje të tjera që nuk lidhen me ushtrimin e detyrave të administratës gjyqësore dhe i raporton Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi ankesat dhe masat e marra në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- dh) vlerëson dhe shqyrton projektbuxhetin e përgatitur nga nëpunësi i financës, përpara 15 ditëve të paraqitjes në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- e) jep informacion, mendime ose raporte të kërkuara nga institucione shtetërore sipas ligjit;
- ë) bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor për çështje që lidhen me formimin fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë;
- f) organizon rregullisht takime me përdoruesit e gjykatës për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë;
- g) miraton rregulla të veçanta të gjykatës për çështje të ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë<sup>206</sup>.

**Kancelari** emërohet nga KLGj-ja<sup>207</sup> dhe është organ përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor me një sërë kompetencash të rëndësishme<sup>208</sup>.

**Administrata gjyqësore** realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme:

- a) shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga **këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë**;
- b) shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore; c) shërbime mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e

206. Neni 39

207. Ibid neni 59: Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

208. Ibid, kompetencat neni 39: Kancelari është përgjegjës për: a) funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit dhe mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave; b) dorëzimin e raporteve periodike për gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor; c) raportimin pa vonesë Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve; ç) udhëzimin dhe mbikëqyrjen e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës; d) i siguron Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë qasje në të dhënat statistikore për aq sa u nevojitet këtyre institucioneve në ushtrimin e kompetencave të tyre të caktuara me ligj; dh) kryen çdo detyrë, siç përcaktohet me ligj ose siç autorizohet nga kryetari.

përshtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës<sup>209</sup>.

Veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor bazohet mbi parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës, profesionalizmit, integritetit, përgjegjshmërisë dhe orientimit drejt shërbimeve eficientë dhe të aksesueshme për çdo person<sup>210</sup>.

### **6.3.2 Treguesit e realizimit**

Proceset dhe operacionet e punës<sup>211</sup> në gjykata duhet të mundësojnë që procedurat gjyqësore të avancojnë, duke respektuar afatet ligjore. Shpërndarja dhe menaxhimi i çështjeve/delegimi i përgjegjësive, duhet të lejojnë standarde performance, efikasiteti dhe eficence.

Tregues të realizimit: Ekzistenca dhe zgjedhja e zv/kryetarëve në gjykata; ekzistenca dhe krijimi i Këshillave të Gjykatave; realizimi i Mbledhjeve të Përgjithshme të Gjykatës, sipas përcaktimeve ligjore; ekzistenca e kancelarëve dhe stafit jogjyqësor, sipas përcaktimeve ligjore mbi numrin dhe kompetencën e tyre.

Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor **për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave** për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës<sup>212</sup>.

Realizimi si tregues, duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve:

- A vlerësohet impakti që ndryshimet legjislative kanë në ngarkesën e punës në gjykata, për të ndryshuar burimet njerëzore dhe kapacitete të tjera të tyre në përshtatje me ndryshimet?
- Cili është roli individual i çdo gjyqtari në menaxhimin e çështjes?
- A komunikojnë dhe shkëmbejnë gjyqtarët eksperiencat dhe praktikat e tyre më të mira në menaxhimin e çështjeve?
- A ka trajnime për këtë qëllim?
- A ka tregues të performancës, të matshëm dhe të monitorueshëm?
- A bëhet shpërndarja e çështjeve mbi bazën e kritereve objektive, të njohura dhe të bëra publike paraprakisht<sup>213</sup>?
- A ka një sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve të aksesueshme nga të gjitha gjykatat?
- Si është ngarkesa për çdo gjyqtar në raport me ngarkesën e gjykatës?

209. *ibid*, neni 41.

210. Neni 8 i ligjit nr.98/2016.

211. Lista kontrolluese për promovimin e cilësisë së drejtësisë dhe gjykatave, CEPEJ (2008)2.

212. Neni 22/2 i ligjit nr.98/2016.

213. Paragrafi 21 i Opinionit nr.19 (2006), CCJE, "Mbi rolin e Kryetarëve të Gjykatave"



- Si është ngarkesa në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve të gjykatës, që punojnë drejtpërdrejt në funksion të dhënies së drejtësisë nga gjyqtarët?
- Si zbatohet modeli menaxherial, duke u kaluar realizimi i detyrave në nivel gjykatë, krahasuar me realizimin e centralizuar nga KLGJ-ja<sup>214</sup>?

### 6.3.3 Metoda e matjes

Standardet e kulturës menaxheriale mund të maten përmes analizimit të detyrave të përcaktuara ligjore/administrative për çdo organ administrativ në cilësi dhe rol menaxherial, Kryetari i Gjykatës, zv/kryetari, Këshilli i Gjykatës, Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës.

Për kryetarin e gjykatës, sipas ligjit, kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:

- a) mirorganizimin e gjykatës në dhoma ose seksione;
- b) ndarjen e trupave gjykues;
- c) planifikimin e gjyqtarëve për çështje të natyrës urgjente;
- ç) ndarjen e çështjeve me short;
- d) zëvendësimin në kohë të gjyqtarëve që kanë pengesa në gjykim;
- dh) zhvillimin e mbledhjeve tematike;
- e) planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të gjykatës;
- ë) mbikëqyrjen, me qëllim përmirësimin e informacionit në faqen zyrtare të gjykatës;
- f) mbikëqyrjen për krijimin e ambienteve të përshtatshme në gjykatë, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut, përfshirë edhe shenjat orientuese në gjykatë;
- g) organizimin e trajnimeve për gjyqtarët ose punonjësit e gjykatës<sup>215</sup>.

Me anë të kriterit të aftësisë komunikuese vlerësohet aftësia e kryetarit për komunikim të qartë, në kohë dhe transparent. Ky kriter matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:

- a) bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrjeje ose auditi;
- b) komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme<sup>216</sup>.

Standardet e performancës së personelit jogjyqësor, mund të bëhen të matshme, përmes disa indikatorëve, si pyetësorë dhe anketime vetëvlerësuese brenda stafit jogjyqësor të gjykatës. Është e lidhur me sjelljen organizative dhe elementet strukturale të brendshme

214. Lista kontrolluese për promovimin e cilësisë së drejtësisë dhe gjykatave, CEPEJ (2008)2, C/24.

215. Neni 80 i ligjit nr. 96/2016.

216. Neni 81, Ibid.



dhe standardet e SATURN mund të përdoren si orientim për matjen e nivelit të menaxhimit të brendshëm<sup>217</sup>. Kultura menaxheriale e kryetarit të gjykatës matet përmes treguesve ligjorë dhe vlerësimit të punës menaxheriale si kryetar gjykate<sup>218</sup>.

## **Faktori 6.4 Efektiviteti i praktikave të punës së gjykatave, në raport me objektivat specifike të përmendur në faktorin 6.3**

### **6.4.1 Standardet e performancës**

Gjykatat si institucione, duhet të zbatojnë afatet kohore gjyqësore sipas standardeve më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me afatin e arsyeshëm të GjEDNj-së.

**Afatet kohore** mund të konsiderohen *instrumente operationale*, pasi janë synime konkrete për të matur në çfarë shkalle ndjekin gjykatat, dhe më në përgjithësi administrata e drejtësisë, shpejtësinë e gjykimit të çështjes, dhe më tej parimin e një gjykimi të drejtë, brenda një kohe të arsyeshme, siç kërkohet nga KEDNj-së.

*Afati kohor* - periudha e kohës brenda së cilës duhet të zgjidhen një numër apo përqindje e caktuar çështjesh, duke marrë parasysh vjetërsinë e çështjeve në gjykim. Afatet kohore për zhvillimin e proceseve gjyqësore nuk duhen ngatërruar me *afatet procedurale*, të cilat i referohen një çështjeje të vetme/individuale<sup>219</sup>.

Afatet kohore janë një instrument menaxhues dhe mund të përcaktohen nga autoritetet qendrore (p.sh. Këshilli Gjyqësor, Gjykata e Lartë, Ministria e Drejtësisë, Parlamenti) dhe/ose gjykatat. Ka tre hapa kryesorë për t'u ndjekur nga gjykatat:

- 1) Diagnostikimi i gjendjes aktuale,
- 2) Vendosja e Afateve Kohore për gjykatën,
- 3) Monitorimi i Afateve Kohore.

Më pas, mbështetur te Monitorimi, Gjykata mund të vendosë një Afat Kohor tjetër për të ardhmen (p.sh. për vitin e ardhshëm), duke u përpjekur vazhdimisht të përmirësojë punën drejt arritjes së afatit kohor të dëshirueshëm për të gjitha çështjet që gjykon<sup>220</sup>.

### **6.4.2 Treguesit e realizimit**

Njësoj si tek 6.3.2. realizimi si tregues, duhet t'u përgjigjet këtyre pyetjeve:

- A vlerësohet impakti që ndryshimet legjislative kanë në ngarkesën e punës në gjykata,

217. CEPEJ-SATURN(2015)2

218. Neni 52 i ligjit nr.98/2016, mbi kriteret e vlerësimit të kryetarëve të gjykatave.

219. Afatet procedurale zakonisht përcaktohen nga ligji procedural dhe kërkojnë që një veprim të kryhet brenda një kohe të specifikuar, përndryshe do të ketë pasoja ligjore.

220. CEPEJ, 2016, Udhëzues zbatimi “Drejt afateve europiane për proceset gjyqësore”.

për të ndryshuar burimet njerëzore dhe kapacitete të tjera të tyre në përshtatje me ndryshimet?

- A ka tregues të performancës, të matshëm dhe të monitorueshëm?
- A bëhet shpërndarja e çështjeve mbi bazën e kritereve objektive, të njohura dhe të bëra publike paraprakisht<sup>221</sup>?
- A ka një sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve të aksesueshme nga të gjitha gjykatat?
- Si është ngarkesa për çdo gjyqtar në raport me ngarkesën e gjykatës?
- Si është ngarkesa në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve të gjykatës, që punojnë drejtpërdrejt në funksion të dhënies së drejtësisë nga gjyqtarët?
- Si zbatohet modeli menaxherial, duke u kaluar realizimi i detyrave në nivel gjykatave, krahasuar me realizimin e centralizuar nga KLGj<sup>222</sup>?
- A ka tregues që vlerësojnë performancën e gjykatave, në lidhje me përmbushjen e objektivave?
- Si identifikohen nevojat për përmirësime të cilësisë së punës në menaxhimin e brendshëm të gjykatave?

### **6.4.3 Metoda e matjes**

Si më lart tek 6.3.3, efektiviteti i punës së gjykatave është i lidhur me sjelljen organizative dhe elementet strukturale të brendshme. Standardet e SATURN mund të përdoren si orientim për efektivitetin e menaxhimit të brendshëm<sup>223</sup>. Metoda përfshin monitorimin e procedurave gjyqësore, përmes statistikave, lidhur me informacion mbi një çështje të caktuar, mbi kohëzgjatjen e çështjeve mesatarisht në gjykatë, mbi faktorët ndikues në zgjatjen e çështjeve të lidhura me menaxhimin e brendshëm të gjykatës, me administrimin e çështjes nga gjyqtari përkatës, ose me faktorë të jashtëm (p.sh. avokatët, prokurorët, njoftimet, adresat).

## **Faktori 6.5 Arsimimi profesional, statusi, trajnimet dhe regjimi disiplinor për personelin jogjyqësor**

### **6.5.1 Standardet e performancës**

KL Gj bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, sipas përcaktimeve ligjore. Ajo kujdeset për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm ligjor të nëpunësve civilë gjyqësorë, me përjashtim të kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, sipas parashikimeve ligjore.<sup>224</sup>

221. Paragrafi 21 i Opinionit nr.19 (2006), CCJE, “Mbi rolin e Kryetarëve të Gjykatave”.

222. Checklist for promoting the quality of Justice and the Courts/CEPEJ (2008)2, C/24.

223. CEPEJ-SATURN (2015) 2, “SATURN guidelines for judicial time management”.

224. Neni 90 i ligjit nr. 115/2016.

Formimi profesional i nëpunësve civilë gjyqësorë garantohet nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet:

- a) **programin e formimit fillestar**, mbi bazën e të cilit nëpunësit civilë gjyqësorë, që pranohen në shërbimin civil gjyqësor trajnohen brenda periudhës së provës së tyre;
- b) **programin e formimit vazhdues**, i cili kryhet nga nëpunësit në detyrë të shërbimit civil gjyqësor<sup>225</sup>.

Regjimi disiplinor i nëpunësve civilë gjyqësorë parashikohet në kapitullin IV të ligjit nr.98/2016. Organi kompetent për **propozimin e masave disiplinore** është:

- a) kancelari i gjykatës për nëpunësit civilë gjyqësorë që ushtrojnë detyrën në gjykatën përkatëse, me përjashtim të këshilltarit dhe ndihmësit ligjor;
- b) kryetari i gjykatës për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor.

Organi kompetent **për të caktuar masat disiplinore** është:

- a) Këshilli i Lartë Gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor;
- b) Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë<sup>226</sup>.

### **6.5.2 Treguesit e realizimit**

Njësoj si tek 5.4.2., lidhur me treguesit e realizimit të trajnimeve të gjyqtarëve. Ekzistenca e kurrikulave, ekzistenca e monitorimit të performancës gjatë trajnimeve, ekzistenca e sistemit llogaridhënës ndaj shkeljeve nga stafi jogjyqësor.

Formimi fillestar dhe praktikat profesionale, dhe formimi i vazhdueshëm pas emërimit fillestar, (*in-service training*):

- Sa të përshtatura janë trajnimet me nevojat, cila është metoda e vlerësimit të nevojës për trajnime?
- Sa të specializuara dhe të detajuara janë trajnimet?
- Sa të diversifikuara janë trajnimet e planifikuara dhe të përfituara?
- Thellësia e trajnimit?
- Metodatat e trajnimit?
- Sa i pavarur është autoriteti që mbikëqyr trajnimet?
- A vlerësohen programet dhe metodatat e trajnimit në vazhdimësi dhe periodikisht, në mënyrë që të sigurohet cilësia e trajnimit?
- A u referohen trajnimet veçanërisht praktikave të punës së përditshme, të personelit jogjyqësor?

---

225. Neni 52 i ligjit nr. 98/2016.

226. Neni 69 i ligjit nr. 98/2016.

Lidhur me masat disiplinore, realizimi i llogaridhënies duhet t'u përgjigjet pyetjeve hulumtuese:

- Nëse konstatohen shkelje, a vazhdoen me procedim disiplinor ndaj nëpunësit?
- Sa të shpeshat dhe sa të rënda janë shkeljet?
- Sa seriozisht ekziston kultura e ndërshkimit pas konstatimit?
- Sa garantuese janë procedurat për të drejtat e nëpunësit që ka filluar procedimi disiplinor?
- Sa ndikon llogaridhënia e stafit jogjyqësor në efikasitet dhe efikasitet të dhënies së drejtësisë?
- A i garantohet e drejta për ankim efektiv nëpunësit?
- Sa janë të dokumentuara procedurat disiplinore dhe masat në regjistrat disiplinorë të personelit<sup>227</sup>?

### **6.5.3 Metoda e matjes**

Njësoj si tek 5.4.3.

Ekzistenca e kurrikulave dhe ballafaqimi i realizimit të tyre nga ana faktike sipas planifikimit përkatës të trajnimeve.

Lidhur me masat disiplinore:

- raportet dhe statistikave të monitorimit të shkeljeve,
- regjistrimi në regjistrin e personelit, dhe
- numri i penaliteteve,

tregojnë nivelin e llogaridhënies në nivel disiplinor.

---

227. Neni 79 i ligjit nr. 98/2016.

## Pjesa 9

# BURIMET FINANCIARE/NJERËZORE TË GJYQËSORIT DHE MENAXHIMI I TYRE

### **Pse duhet vlerësuar/matur:**

Shih faktorin - **Pavarësia financiare e gjyqësorit**. Të njëjtat argumente si për pavarësinë dhe për eficientë dhe efikasitetin e gjyqësorit, vlejné si racionale dhe për këtë kapitull. Buxheti i nevojshëm financiar, burimet njerëzore, infrastrukurore sjellin standarde pavarësie, eficientë dhe efikasiteti në sistemin gjyqësor (si pushtet dhe si gjykata), prandaj dhe duhen vlerësuar dhe matur.

### **Faktori 7.1 Buxheti dhe procedurat e caktimit të tij**

#### **7.1.1 Standardet e performancës**

**Këshilli i Lartë Gjyqësor** dhe sistemi gjyqësor financohen nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe i sistemit gjyqësor është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës.

**Këshilli i Lartë Gjyqësor** është përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të tij në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave.

Këshilli i Lartë Gjyqësor merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit, ku diskutohet projektbuxheti i sistemit gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë<sup>228</sup>.

**Për zbatimin e buxhetit**, Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen detyrat e mëposhtme: a) ndihmon gjykatat në hartimin e projektbuxheteve të tyre vjetore; b) mbledh dhe analizon të dhëna mbi zbatimin e buxhetit dhe të ardhurat e siguruara nga gjykatat; c) mbikëqyr dhe këshillon gjykatat mbi teknikat dhe procedurat e përshtatshme dhe eficiente që lidhen me menaxhimin financiar të tyre; ç) vendos standarde të praktikave më të mira dhe objektiva të performancës, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave; d) siguron trajnim për stafin gjyqësor mbi

228. Neni 95 i ligjit nr. 115/2016.

menaxhimin financiar të gjykatave; dh) ndërmerr projekte me synimin për të përmirësuar menaxhimin financiar të gjykatave; e) merr hapa të tjerë për të lehtësuar gjetjen e fondeve të mjaftueshme dhe të vazhdueshme për gjykatat; ë) bashkëpunon dhe kërkon fonde nga agjencitë e tjera vendase dhe ndërkombëtare në lidhje me funksionet e Këshillit.

**Njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor**, pranë KLGj-së ka këto kompetenca kryesore: a) studion dhe përcakton nevojat për buxhet të të gjitha hallkave të gjyqësorit në bashkëpunim me sektorët financiarë të gjykatave të të gjitha niveleve; b) përpunon treguesit financiarë që kanë lidhje me kërkesat dhe veprimtarinë e gjykatave; c) kontrollon përdorimin e fondeve që u janë dhënë gjykatave sipas destinacioneve.

Lidhur me veprimtarinë e njësisë së administrimit të buxhetit gjyqësor, Këshilli ushtron këto kompetenca:

- a) miraton projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm të propozuar nga njësia për çdo nivel të gjykatave dhe ia dërgon atë për shqyrtim organit kompetent për shqyrtim dhe miratim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit përkatës;
- b) auditon dhe monitoron përdorimin e fondeve të akorduara dhe analizon kërkesat e gjykatave për fonde që mund të lindin gjatë vitit buxhetor.

**Fondet në dispozicion të Këshillit dhe të gjykatave** përdoren për këto qëllime:

- a) për pagat dhe sigurimet shoqërore të anëtarëve dhe personelit të Këshillit, si dhe të gjyqtarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave;
- b) për plotësimin e nevojave për shpenzimet operative të Këshillit dhe të gjykatave, si dhe për veprimtari të tjera gjyqësore;
- c) për ndërtimin ose meremetimin e godinave, si dhe për investime të tjera;
- ç) për mbulimin e shpenzimeve të gjykatave, lidhur me dhënien e ndihmës së detyrueshme juridike, në rastet e parashikuara në dispozitat ligjore të veçanta<sup>229</sup>.

**Kryetari i Gjykatës** mban kontakt me grupet e kontrollit të institucioneve të tjera shtetërore, njihet me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijon atyre mundësi për ushtrimin e detyrës.

**Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në KLGj**, realizon auditimin e buxhetit gjyqësor. Kjo drejtori ushtron kompetencat e auditimit dhe monitorimit të përdorimit të fondeve të akorduara **për të gjitha gjykatat e vendit, duke filluar nga Gjykata e Lartë, e Apelit dhe të shkallëve të para**<sup>230</sup>.

229. Ibid, neni 96.

230. Neni 96, pika 4, të ligjit nr. 115/2016 “Per organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikës 25 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

### **7.1.2 Treguesit e realizimit**

Realizimi duhet të orientohet nga përgjigjet, bazuar në këto pyetje:

- Cilat janë parimet e financimit të gjykatave?
- Si bëhet shpërndarja e buxhetit nëpër gjykata? Si identifikohen nevojat?
- A ka një përlllogaritje se sa është kostoja e një çështjeje gjyqësore?
- A ka trajnime mbi mënyrën e menaxhimit të buxhetit për Kryetarin e Gjykatës?
- Si planifikohet fillimisht buxheti i Gjykatës, mbi bazën e cilave kriteret, procedurave, dhe cilat janë hallkat e përfshira (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, strukturat nga gjyqësori)?
- A merren parasysh pikëpamjet e gjyqtarëve në hartimin e buxhetit?
- Kush e ka kompetencën ligjore për menaxhimin e buxhetit?
- Pas alokimit të buxhetit për çdo gjykatë, si ndodh kontrolli financiar?
- Si ndodh llogaridhënia dhe kontrollohet transparenca për përdorimin e ligjshëm dhe eficient të buxhetit të gjykatës?
- A miraton KLGj-ja standarde të praktikave më të mira, si dhe objektiva të performancës, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave?
- A siguron KLGj-ja trajnim për stafin gjyqësor mbi menaxhimin financiar të gjykatave?
- A këshillon KLGj-ja gjykatat mbi teknikat dhe procedurat e përshtatshme dhe eficiente që lidhen me menaxhimin financiar?
- A auditon KLGj-ja përdorimin e fondeve të alokuara për Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallëve të para?
- A mbikëqyr KLGj-ja shpenzimet, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor?
- A përpunon KLGj-ja përgjatë vitit financiar kërkesa për fonde shtesë, apo transferim fondesh mes zërave buxhetore?
- A arsyeton KLGj-ja kërkesat për buxhet shtesë, apo rialokim fondesh të bëra gjatë vitit buxhetor?
- A ka miratuar KLGj-ja një plan strategjik, që mbulon me masa afatshkurtra dhe afatmesme veprimtarinë e KLGj-së, në momentin që kryhet monitorimi i veprimtarisë së saj?
- A është plani strategjik i hartuar nga KLGj-ja në përputhje me objektivat e ligjit për qeverisjen e gjyqësorit?
- A janë objektivat dhe masat e përcaktuara në planin strategjik të KLGj-së në përputhje me qëllimet e politikave dhe objektivat e vendosura në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë?
- A konsultohet dhe merr mendimin e hallkave të gjyqësorit, KLGj-ja për hartimin e planit strategjik të gjyqësorit?
- A bashkëpunon dhe koordinon KLGj-ja me Ministrinë e Drejtësisë, për procesin e hartimit dhe miratimit të Planit Strategjik për gjyqësorin?
- A konsulton KLGj-ja me institucione, palë të treta, sektorin e biznesit, publikun, partnerët ndërkombëtarë, planin strategjik të gjyqësorit?



- Plani strategjik i KLGj-së a është në përputhje me SKZHI, PKIE, si dhe rekomandimet e lëna nga Komisioni Evropian në Progres Raportet për Shqipërinë?
- A përmban plani strategjik i hartuar nga KLGj-ja, elementet e caktuara nga ligji?
- A ka evidentuar drejt KLGj-ja dhe në përputhje me nevojat e sistemit gjyqësor deklaratat e misioni, vizionit, vlerat dhe objektivat strategjike të gjyqësorit?
- A janë masat/aktivitetet e përzgjedhura nga KLGj-ja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të pasur një sistem të pavarur, eficient, transparent dhe të përgjegjshëm?
- A shoqërohet plani strategjik i gjyqësorit me planin e veprimit?
- A ka evidentuar saktë KLGj-ja burimet financiare, strukturat përgjegjëse dhe afatet kohore për realizimin e masave/aktiviteteve?
- A ka përpunuar KLGj-ja tregues/indikatore matës të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm, të cilët evidentojnë progresin e arritur në realizimin e objektivave të planit strategjik?
- A miraton KLGj-ja në mënyrë periodike, planin strategjik për gjyqësorin?
- Planet strategjike të KLGJ-së, a mundësojnë vijimësi dhe koherencë në përmbushjen e misionit dhe vizionit të caktuar për pushtetin gjyqësor?

### **7.1.3 Metoda e matjes**

Për matjen e treguesve të mësipërm vlerësohet veprimtaria e KLGj-së dhe gjyqësorit në raport me detyrimet që rezultojnë nga ligji nr.9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe aktet nënligjore që lidhen me procedurat standard të zbatimit, monitorimit dhe auditimit të buxhetit<sup>231</sup> Informacion mbi nivelin e zbatimit merret edhe nga analizimi i: (i) raporteve të auditimit të brendshëm (Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm) dhe të jashtëm të KLGJ-së (ii) raporteve të monitorimit periodik të KPSAB (iii) raporteve të KLSH-së (iv) raportimeve të MF mbi nivelin e zbatimit të buxhetit (v) kërkesave për shtesa buxhetore gjatë vitet (vi) kërkesave për transferim apo rialokim fondesh përgjatë vitit buxhetor. Verifikohet nëpërmjet faqes zyrtare dhe raporteve të KLGj-së, nëse KLGj-ja aplikon standardet e praktikave më të mira, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave. Gjithashtu verifikohet nga të dhënat e marra zyrtarisht nga KLGj-ja numri i trajnimeve për stafin gjyqësor rreth menaxhimit financiar të gjykatave.

Për matjen e treguesve të mësipërm të realizimit së pari, analizohen Planet Strategjike të KLGJ-së, Raportet e Monitorimit periodik të Planit Strategjik, si dhe Raportet Vjetore të KLGJ-së dhe Komisioneve të Përhershme të saj, të publikuara në faqen zyrtare të KLGj-së. Së dyti, mund të merret informacion në rrugë zyrtare nga KLGj-ja, mbi rregullat dhe procedurat e

231. Udhëzim i Ministrisë së Financave, Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.



ndjekura në hartimin, konsultimin dhe miratimin e planit strategjik të gjyqësorit. Gjithashtu verifikohen në rublikën dhe listën e aktiviteteve të KLGj-së, aktivitetet e ndërmarra për konsultimin e dokumentit strategjik. Së treti, merret informacion zyrtar nga Ministria e Drejtësisë mbi përfshirjen e saj në planifikimin strategjik të gjyqësorit, mbi përputhshmërinë dhe koherencën e objektivave dhe masave strategjike me ato të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Gjithashtu, mund të realizohen anketa apo pyetësorë me gjyqtarët, për të kuptuar përfshirjen e tyre në hartimin e dokumentit të planit strategjik, si dhe për të vlerësuar shkallën e përkthimit të nevojave të tyre në objektiva dhe masa strategjike.

Përdoren të njëjtat metodologji, sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare të menaxhimit të buxhetit publik. Monitorim nga auditim i brendshëm dhe i jashtëm, sipas standardeve të monitorimit. KLSH-ja me raportimet dhe standardet e kontrollit mbi mirëmenaxhimin buxhetor dhe zonat e riskut të mungesës së integritetit financiar. Praktikrat e denoncimit të korrupsionit sipas Ligjit për Sinjalizuesit. Statistika mbi nivelin e realizimit buxhetor, mungesës së realizimit dhe arsyeve dhe shkaqeve ligjore, ose të natyrave të tjera. Statistika mbi shpërdorimin e buxhetit, vënia para përgjegjësive sipas kompetencave të niveleve drejtuese dhe menaxhuese financiare. Tregues të llogaridhënies ligjore, në raport me zbatimin e buxhetit do të ishin dhe numri i procedimeve disiplinore dhe penale.

## **Faktori 7.2 Burimet njerëzore, mjaftueshmëria dhe cilësia e tyre**

### **7.2.1 Standardet e performancës**

**Këshilli i Lartë Gjyqësor** është përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata. Specifikisht, Këshilli kryen detyrat e mëposhtme:

- a) hedh të dhënat dhe përditëson Regjistrin Qendror të Personelit për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit administrativë të gjykatave;
- b) publikon dhe shpall konkurrim të hapur për vendet e lira në shërbimin civil gjyqësor, si dhe fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele;
- c) emëron kancelarin e gjykatës dhe ndihmësit ligjorë, si dhe merr masa disiplinore ndaj tyre;
- ç) miraton dhe përditëson rregullat e procedurës që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë;
- d) cakton përfaqësuesin e tij në Këshillin e Gjykatës;
- ë) miraton Kodin e Etikës për nëpunësit civilë gjyqësorë pas konsultimit me këshillat e gjykatave;
- e) kujdeset për miradministrimin e pasurive të paluajtshme të gjykatave në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe këshillin e gjykatës;
- f) ngre komisionin e ristrukturimit në rastet e mbylljes ose ristrukturimit të gjykatave;
- g) kujdeset për krijimin dhe funksionimin e sistemit të arkivimit gjyqësor, si dhe menaxhimin dhe administrimin e tij<sup>232</sup>.

232. Neni 90 i ligjit nr.115/2016

**Kancelari i çdo gjykate** krijon dhe administron dosjen individuale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjësi të administratës së gjykatës. Dosja individuale përmban të dhëna profesionale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjës të administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me shërbimin civil gjyqësor ose marrëdhënien e punës<sup>233</sup>. Kancelari i Gjykatës reflekton në Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat e përcaktuara nga ligji. Kancelari i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor, informacionin e kërkuar nga ligji.<sup>234</sup>

Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme:

- a) shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë;
- b) shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;
- c) shërbime mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e përshtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës<sup>235</sup>.

### **7.2.2 Treguesit e realizimit**

Realizimi duhet të orientohet nga përgjigjet, bazuar në këto pyetje:

- Si rekrutohen, trajnohen dhe zhvillohet karriera e personelit jogjyqësor, Kancelarit dhe Kryetarit të Gjykatës, në mënyrë që të kemi personel cilësor dhe të motivuar në shërbim të qytetarëve dhe të drejtësisë?
- A ka kritere minimale për kualifikimet e personelit jogjyqësor, dhe cila është procedura për përzgjedhjen e tyre, a janë ato objektive dhe transparente?
- A publikohen njoftimet për vendet e lira të punës?
- A ka një politikë të shanseve të barabarta dhe jodiskriminimit në punësim?
- A ka një proces intervistimi?
- A ka një politikë kundër konflikteve të interesit dhe nepotizmit?
- Cilat janë mënyrat e ndërhyrjes për të minimizuar kompleksitetet dhe dublimet/përsëritjet e panevojshme në personel dhe praktika të punës?
- Cilat janë linjat e autoritetit dhe ndërveprimi ndërmjet Kryetarit të Gjykatës dhe Kancelarit?
- Kur emërohet një Kryetar Gjykate, a është një ndër kriteret e përzgjedhjes edhe vizioni i tij për drejtimin e gjykatës?
- Si kontrollohet nëse ky vizion përkthehet në masa dhe veprime konkrete, që i sjellin dobi punës në gjykatë?

233. Neni 63 i ligjit nr. 98/2016

234. Neni 88 i ligjit nr. 98/2016

235. Ibid, neni 49.

- Cili është roli i Këshillit të Gjykatës?<sup>236</sup>
- Sa arrin ky këshill të përmbushë si vizionar leadershipin e gjykatës, që drejton së bashku me organet e tjera të qeverisjes së gjyqësorit?

### **7.2.3 Metoda e matjes**

Metodat e matjes për kapacitetet njerëzore, sipas standardeve të CEPEJ-së mbi efikasitetin dhe efikasitetin, që si element ka mjaftueshmërinë e stafit jogjyqësor, si dhe matje të nivelit të zbatimit të kërkesave për staf, sipas parametrave ligjorë të përcaktuar në ligj. P.sh. ligji parashikon parametra orientues për numrin e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, dhe raportet numerike krahasuar me gjyqtarët e gjykatës përkatëse.

## **Faktori 7.3 Trajnimet, sasia, cilësia dhe efektiviteti i tyre**

### **7.3.1 Standardet e performancës**

Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë: a) kancelari; b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë; c) ndihmësi ligjor në Gjykatën e Apelit; ç) kryesekretari; d) sekretari gjyqësor; dh) nëpunësi i financës dhe i buxhetit; e) nëpunës të tjerë, që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me medien.<sup>237</sup>

**Shkolla e Magjistraturës** ofron formim fillestar për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë dhe, të paktën çdo tre vjet, për kancelarët<sup>238</sup>. Formimi profesional i nëpunësve civilë gjyqësorë garantohej nëpërmjet përfshirjes së tyre në:

- programin e formimit fillestar**, mbi bazën e të cilit nëpunësit civilë gjyqësorë që pranohen në shërbimin civil gjyqësor trajnohen brenda periudhës së provës së tyre;
- programin e formimit vazhdues**, i cili kryhet nga nëpunësit në detyrë të shërbimit civil gjyqësor<sup>239</sup>.

### **7.3.2 Treguesit e realizimit**

Ekzistenca e kurrikulave sipas kategorive të nëpunësve jogjyqësorë. Fillimi i trajnimeve për këtë kategori si risi ligjore, dhe krijimi i database-s të të dhënave lidhur me llojin dhe masën e trajnimeve dhe performancës gjatë trajnimit. Realizimi duhet të orientohet nga përgjigjet, bazuar në këto pyetje:

236. Nenet 26 dhe 27 të Ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

237. Neni 50 i ligjit nr. 98/2016

238. Ibid, neni 53.

239. Ibid, neni 52.

- A janë përgatitur kurrikula për formimin fillestar për kancelarin dhe për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë?
- A janë të realizueshme këto kurrikula?
- A janë të matshme njohuritë e marra nga këto trajnime?
- A i përgjigjen nevojës së personelit jogjyqësor për trajnim?
- A bëhen në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe të mjaftueshme?
- A matet performanca dhe niveli i të nxëniet nga trajnimet? Sipas cilës metodologji?

### **7.3.3 Metoda e matjes**

Njësoj metodologjia si tek 5.4.2., dhe 6.5.2, lidhur me treguesit e realizimit dhe të matjes së trajnimeve të gjyqtarëve, dhe stafit jogjyqësor.

## **Faktori 7.4 Aksesit në Literaturë, zhvillimet e doktrinës dhe praktikës gjyqësore, si dhe botimet profesionale**

### **7.4.1 Standardet e performancës**

Me qëllim kryerjen e detyrave funksionale me kompetencë, leximi dhe përditësimi me njohuri të fushës teorike dhe praktike është domosdoshmëri për gjyqtarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, që kanë detyrim mbi ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare.

Abonimi në gazeta apo revista me natyrë juridike vendase ose të huaja është domosdoshmëri për nivelin e Gjykatës së Lartë, por me pritshmëri shtrirjeje edhe në gjykatat e apelit dhe të rrethit.

### **7.4.2 Treguesit e realizimit**

Zhvillim e pasurim të bibliotekave ekzistuese fizike dhe online për Gjykatën e Lartë, dhe krijim bibliotekash në gjykatat ku nuk ekzistojnë.

Akses efektiv të stafit jogjyqësor të gjykatave, sidomos për këshilltarët në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësit ligjorë në gjykatat e apelit, si bërthama shkencore të gjykatave.

### **7.4.3 Metoda e matjes**

Verifikim dhe ekzaminimin i krijimit, i përdorimit dhe i aksesit në literaturë, përmes evidentimit fizik të bibliotekave, përmes statistikave mbi përdorimin e këtyre bibliotekave nga stafi, përmes buxhetimit vjetor për akses në literaturë bashkëkohore, dhe anketimit mbi përshtatshmërinë e literaturës nga vetë përdoruesit e bibliotekës.

## **Faktori 7.5 Disponueshmëria e ekspertizës teknike dhe roli ndërveprues i gjyqësorit me aktorë dhe faktorë të tjerë të jashtëm, me ndikim në performancën e tij**

### **7.5.1 Standardet e performancës**

I gjithë ambienti institucional, shoqëror, ekonomik, social, përfshihet si ndërveprues i jashtëm me gjyqësorin, si edhe aktorët ndërkombëtarë, që ndihmojnë gjykatat me asistencë teknike dhe donacione. Përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në sistemin gjyqësor, janë të lidhura me qasjen:

- *e politikës dhe politikanëve*, që nuk duhet të bëhen pengesë me qëllim ndaj kërkesave të gjyqësorit për buxhet dhe infrastrukturë njerëzore;
- *nga shoqatat e gjyqtarëve*, që duhet të nxisin pavarësinë dhe integritetin e anëtarësisë së tyre;
- *nga avokatët dhe prokurorët*, si ndikues të drejtpërdrejtë në veprimtarinë gjyqësore me rolin dhe ekspertizën e tyre;
- *nga shoqatat apo grupimet ekonomike*, që mund të tentojnë të ndikojnë sipas interesit të grupimit të tyre, dhënien e drejtësisë;
- *nga media*, e cila nuk duhet të minojë me qëllim vendimmarrjen e gjyqësorit dhe ta deligjitimojë atë, por ta ndihmojë dhe të promovojë punën e mirë të gjyqësorit;
- *nga shoqëria civile*, e cila duhet të marrë pjesë dhe të kontribuojë në edukim ligjor, por edhe në shpjegimin e qëndrimeve të gjyqësorit ndaj çështjeve të caktuara me interes publik;
- *nga programe asistuese të gjyqësorit dhe donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë*, që promovojnë dhe ndihmojnë reformat në gjyqësor dhe ndajnë njohuritë më të mira mbi diagnostikimin, vlerësimin dhe performancën e gjyqësorit sa i përket efikasitetit dhe efikasitetit<sup>240</sup>.

### **7.5.2 Treguesit e realizimit**

Ekzistenca e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme me ekspertizë të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ekzistenca dhe organizimi i tryezave të bashkëbisedimit për çështje me qasje multidisiplinore (ligjore, ekonomike, sociale), mes disa aktorësh, bartës të interesave publikë dhe gjykatave. Ekzistenca e platformave bashkërenduese për komunikimin për çështje të lartë interesi publik, sipas një ligjërimi dhe formati të standardeve evropiane mes gjyqësorit dhe aktorëve të tjerë bashkëveprues me të. Realizimi do të duhej të orientohej nga pyetje si:

- A janë në nivelin e duhur të edukimit politikanët lidhur me mbështetjen ndaj gjyqësorit, si domosdoshmëri për interesin publik të dhënies së drejtësisë?
- Sa reagues mund të jetë gjyqësori në mbrojtje të veprimtarisë së tij nga sulmet e papërshtatshme të politikës?

240. Advocacy Toolkit, Lufta kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor [*Combating Corruption in Judicial System*], Transparency International, The global Coalition Against Corruption, ff. 22-32.

- Sa ndihmuese është media në raport me nevojat e Gjyqësorit? Sa e ndihmon ajo interesin publik në raport me raportimet ndaj gjyqësorit?
- Po programet e ndryshme të donatorëve sa ndihmë konkrete japin? A ka rezultate të prekshme në këtë drejtim? Si duhet të maten ato?
- Po aktorë si prokurorët dhe avokatët, si i qasen proceseve gjyqësore? Si ndikojnë ata në dhënien e drejtësisë nga gjykata?
- Po grupet e biznesit si i qasen gjyqësorit? Sa të mbrojtura janë gjykatat nga ndikimet e grupeve të forta ekonomike-financiare, kur qëllimet e tyre bien ndesh me interesin e gjerë publik? Si qëndron raporti dhe trendi i përgjithshëm në vend, mes lirisë ekonomike të bizneseve dhe interesit publik më të gjerë, që garantohet në gjykatë, se sa interesi ekonomik i grupeve financiare? A prodhohen studime në këtë drejtim?

### ***7.5.3 Metoda e matjes***

Monitorime, statistika dhe vlerësime mbi grupe të ndryshme interesi që me punën e tyre dhe rolin në shoqëri, ndikojnë mbi performancën e gjyqësorit. Informacione të kryqëzuara mes disa burimesh informacioni, lidhur me qasjen dhe ndikimin e agentëve të jashtëm në performancën e gjyqësorit.

## BIBLIOGRAFIA

### *Akte rregullatore të vendit dhe të huaja*

- Ligji Nr. 8417, Datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Kodi i Procedurës Penale
- Kodi i Procedurës Civile
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 2.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”
- Lista e Kontrollit të Integritetit Gjyqësor, UNDP
- Parimet e Bangladorit
- Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të integritetit gjyqësor [*Judicial Integrity Self-Assessment Checklist*], Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, UNDP, 2018
- Qasja në drejtësi “Gjykatat” [*Access to Justice “The Courts”*] UNODC.
- Treguesit e Shtetit të së Drejtës, OKB, Udhërrëfyes për zbatimin dhe mjetet projektuese, Edicion 1rë, 2011
- Rekomandimet e Kiev-it, Rekomandime për Pavarësinë Gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore [*Recommendations on Judicial Independence in Eastern Europe, South Caucasus and Central Asia*], 23-25 qershor 2010
- Judicial Reform Index, ABA Rule of Law Initiative
- Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesimin e dokumenteve zyrtare, 18/06/2009.
- Rregullorja nr.1049/ 30 maj 2001 e (KE) “Mbi aksesin e publikut në dokumentacionin e Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit Evropian”



- Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 [2019], OJ L 119/1.
- Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 Prill 2016 [2016], OJ L 119/89.
- Rregullorja (BE) 2018/1725 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2018 [2018], OJ L 295/39 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat e Bashkimit dhe agjencive dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla
- Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2016/1250 i datës 12 korrik 2016 në përputhje me Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi përshtatshmërinë e mbrojtjes së ofruar nga BE-SHBA
- Rekomandimi CM/Rec (2010)12, nr. 44
- Rekomandimi Nr. R (84) 5 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi parimet e procedurës civile që përmirësojnë funksionimin e drejtësisë”
- Indeksi i Reformës në Drejtësi – ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit
- Rekomandimi Nr. R (2001) 2 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi konceptimin dhe rikonceptimin e sistemeve gjyqësore dhe të informacionit ligjor.
- Rekomandimi Nr. (2001) 3 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi lëvrimin e shërbimeve të gjykatave dhe shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja.
- Rekomandimi No. R (2001) 3 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi ofrimin e shërbimeve gjyqësore dhe të shërbimeve të tjera ligjore përmes përdorimit të teknologjive të reja
- Rekomandimi nr. R (2003) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi arkivimin e dokumenteve elektronike në sektorin e drejtësisë».
- Rekomandimet e Opinionit Nr.4 (2003) të CCJE, “Për trajnimin e gjyqtarëve”.
- Rekomandim (2010)12 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi gjyqtarët: pavarësia, eficientia dhe përgjegjësitë
- Rekomandim (2010) 12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me gjyqtarët: pavarësia, eficientia dhe përgjegjësitë, Këshilli i Evropës, 2010
- Lista e Kontrollit për Shtetin e së Drejtës, Komisioni i Venecias
- CEPEJ, 2016 (12), “Matja e cilësisë së drejtësisë”, 7 dhjetor 2016
- Lista kontrolluese për promovimin e cilësisë së drejtësisë dhe gjykatave, CEPEJ (2008)2
- CEPEJ, 2016, Udhëzues zbatimi “Drejt afateve evropiane për proceset gjyqësore”
- Deklarata ENCJ Londër mbi Etikën Gjyqësore
- CEPEJ, Karta Etike Evropiane për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Sistemet Gjyqësore dhe mjedisin e tyre”, Strasburg, 3-4 dhjetor 2018.
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion nr. 19 (2016), “Roli i Kryetarëve të Gjykatave
- Opinion nr.19 (2006), CCJE, “Mbi rolin e Kryetarëve të Gjykatave”
- Opinion nr.403/2006/, 16-17 mars 2007, i Komisionit të Venecias “Për emërimet gjyqësore”



- Opinioni nr.11/2008 i CCJE.
- Opinioni nr.14, (2011) të CCJE.
- Opinioni nr. 7/2005 i CCJE.
- Opinioni nr. 3 në vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Parimet që Drejtojnë Sjelljen Profesionale të Gjyqtarëve, në veçanti Etika, Sjellja e Papajtueshme dhe Paanshmëria, CCJE, 2002
- Opinioni nr.19 (2006), “Mbi rolin e Kryetarëve të Gjykatave”, CCJE
- Standardet e SATURN, CEPEJ, Eficienca dhe efikasiteti në sistemin gjyqësor, Këshilli i Evropës
- SATURN, Udhëzime për menaxhimin e kohës gjyqësore, CEPEJ- SATURN, 2015
- Karta Evropiane të Statutit të Gjyqtarëve
- Opinion nr.179, (2014) i CCJE “Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësisë së drejtësisë, dhe respektimit të pavarësisë gjyqësore”
- Opinioni 17 (2014), para. 46 i CCJE-së.
- Opinion nr. 17 (2014) “Për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësisë së drejtësisë dhe respektimin e pavarësisë gjyqësore” i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian
- Global Measures of Court Performance

#### *Botime dhe analiza*

- Ina Xhepa , “*The vetting of judges and prosecutors: An Albanian experience*”, gusht 2018
- Maxhuni B., Cucchi U., Analizë e Procesit të Vettingut në Shqipëri, Analizë e Politikave [*An Analysis of the Vetting Process in Albania, Policy Analysis*], No. 01/2017
- Omari L. dhe Anastasi A., *E Drejta Kushtetuese*, Shtëpia Botuese ‘Dajti 2000’, 2017.
- Advocacy Toolkit, Lufta kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor [*Combating Corruption in Judicial System*], Transparency International, The global Coalition Against Corruption
- CEPEJ, “Doracak për kryerjen e anketave të kënaqësisë që synojnë përdoruesit e gjykatave në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës [*Handbook for conducting satisfaction surveys aimed at court users in Council of Europe’s member states*].

#### *Raporte*

- ENCJ, Raport për Pavarësinë, Përgjegjshmërinë dhe Cilësinë e Gjyqësorit – Treguesit e Performancës [*Report on Independence, Accountability and Quality of the Judiciary – performance indicators*], miratuar nga Asambleja e Përgjithshme Paris, 9 qershor 2017, 2017,
- Raporti i ENCJ, Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës, 2017
- Raporti i RREKGJ “Pavarësia, llogaridhënia dhe cilësia e Gjyqësorit, Indikatorët e Performancës”, 2017

- GRECO, Parandalimi i Korrupsionit, përfundime dhe tendenca, 4th Evaluation Round
- ENCJ, Raporti, Zhvillimi i standardeve minimale gjyqësore [*Development of minimum judicial standards*] V 2014-2015, miratuar në Hagë, më 5 qershor 2015
- Raport 2012-2013 i Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësore (ENCJ) për standardet minimale lidhur me vlerësimin e performancës profesionale dhe mosheqjen nga detyra të anëtarëve të gjyqësorit

#### *Vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe të GjEDNj-së*

- Vendimi nr. 23/2007
- Vendimi nr. 7, datë 11.03.2008
- Vendimi nr. 11, datë 02.04.2008
- Vendimi nr. 23, datë 04.11.2008
- Vendimi nr. 25, datë 05.12.2008
- Vendimi nr. 7, datë 09.03.2009
- Vendimi nr. 23, datë 23.07.2009
- Vendimi nr. 59, datë 16.09.2016
- Vendim nr. 41, datë 16.05.2017

#### *Vendime të GjEDNj-së*

- Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005
- Hirvisaari kundër Finlandës, 27 shtator 2001
- Van de Hurk kundër Hollandës, 19 prill 1994
- Cocchiarella kundër Italisë, nr. 64886/01, 29 mars 2006
- Dobbartin kundër Francës, nr. 13089/87, 25 shkurt 1993
- Capuano kundër Italisë, nr. 9381/81, 25 qershor 1987
- Lechner dhe Hess kundër Austrisë, nr. 9316/81, 23 prill 1987
- Probstmeier kundër Gjermanisë, nr. 20950/92, 1 korrik 1997
- Gnahoré kundër Francës, nr. 40031/98, 19 shtator 2000
- Siałkowska kundër Polonisë, nr. 8932/05, 22 mars 2007



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore

Integriteti gjyqësor : guidë monitorimi për shoqërinë civile / Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore . - Tiranë : Muza, 2023.

... f. ; ... cm.

Bibliogr.:

ISBN 9789928361387

1.Gjykata 2.E drejta dhe legjislacioni

3.Reforma 4.Shqipëri

34(496.5) "20"